



**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË**

**RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM**

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Kimi  
Industriale dhe Mjedisore”**

**i**

**Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti i Tiranës”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Dr. Magdalena Cara

2. Dr. Merita Stafasani

Dhjetor/ 2022



## TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Për programin e studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Kimi Industriale dhe Mjedisore”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Kimisë Industriale
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Kimi industriale dhe Mjedisore”
4	Urdhëri/ VKM i licencimit:	Urdhër MA Nr.31, datë 30.12.1994
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	VKM Nr. 638, datë 22.07.2015
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër MASH Nr. 297, dt. 20.07.2012
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	S’ka
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Kohë e plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
17	Stafi akademik PAE/ PAK për programin e studimit: (2020-2021)	39 PAE/ 17 PAK
18	Numri i studentëve: (2018- 2019; 2019-2020; 2020-2021)	(100; 98; 52) 205 student
19	Komente / të tjera:	



## **PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Programi i studimit i Ciklit të Parë Bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore” ofrohet në Universiteti i Tiranës (UT), Fakulteti i Shkencave të Natyrës (FSHN) nga Departamenti i Kimisë Industriale (DKI).

Ky program është në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor për IAL-të në Republikën e Shqipërisë.

Programi i studimit i Ciklit të Parë Bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore” kontribuon në zhvillimin e shoqërisë nëpërmjet kërkimit shkencor dhe edukimit në përputhje me qëllimet dhe misionin e UT si dhe fushën e veprimtarisë së tij. PS është i shtrirë në 3 vite akademike dhe përmban 180 kredite. Diploma Bachelor që lëshohet emërtohet: “Kimi Industriale dhe Mjedisore”.

Ky program studimi synon formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale dhe specialitetesh. Programi përgatit studentët me njohuri të përgjithshme dhe njohuri specifike në disiplina bazë dhe karakterizuese.

Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore” u ofron studentëve njohuritë bazë dhe specifike, që do të jenë të nevojshme për të nivelin e parë bachelor si edhe për të ndjekur në vazhdimësi cikle të tjera studimi dhe njëkohësisht u përgjigjet kërkesave për t’u perballur me tregun aktual të punës në vend. Të kuptuarit kritik i teorive dhe parimeve akademike të fushës së Kimisë industriale dhe asaj mjedisore, shihet i lidhur me kurrikulën e cila ka shtrirje të njohurive teorike dhe praktike.

Programi i studimit Bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore”, përmban të gjitha elementët që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore dhe nënligjore të Arsimit të Lartë 80/2015.

Në dispozicion të studentëve, si dhe për realizimin me sukses të këtij programi studimi është një infrastrukturë bashkëkohore didaktike duke përfshirë këtu jo vetëm auditorët, por edhe laboratorët mësimorë, bibliotekën, përdorimin e internetit, si dhe të gjitha fasilitetet e tjera që mundësojnë një mësimdhënie cilësore, jo vetëm në ecurinë e zakonshme, por edhe në kushtet vështira të pandemisë.

Institucioni bashkëpunon me institucione të ndryshme publike dhe private, ku mundëson jo vetëm formimin profesional të studentëve, por edhe ndihmon dhe mbështet studentët në rrugën e punësimit. Kjo mbështetet nga mjaft marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike apo private, si dhe me sektorin e biznesit.



## **Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm;**

Raporti i vlerësimit të brendshëm është përgatitur nga një ekip i FSHN, i cili përfshin anëtarë të stafit akademik si dhe përfaqësues të studentëve. Grupi i vlerësimit të brendshëm (GVB) i mbështet argumentat e shkruara në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB) në një sërë dokumenta të vëna në dispozicion të Grupit të Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) përmes sistemit AMS. GVB gjykon se në të pesë fusha e vlerësimit, standartet janë të përmbushura plotësisht.

GVJ përbëhet nga dy profesorë të Universitetit Bujqësor të Tiranës (UBT) dhe në gjithë procesin e vlerësimit të jashtëm janë mbështetur nga një Menaxher i Vlerësimit, përfaqësues i Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) e cila mbante gjithashtu dhe shënimet për takimet e zhvilluara gjatë vizitës në Institucion. GVJ shfrytëzoi RVB, si dhe evidenca të ndryshme, të cilat iu vunë në dispozicion mjaft kohë përpara zhvillimit të vizitës në institucion. Përmes leximit të dokumentacionit GVB u familjarizua me strukturën, politikat, menaxhimin, si dhe me natyrën e mësimdhënies dhe aktivitetet kërkimore të kryera nga IAL, si dhe konkretisht nga stafi i Departamentit të Kimisë Industriale.

GVJ realizoi një sërë takime gjatë vizitës në institucion, çka i mundësoi ekipit vlerësues të kuptojë më qartë këndvështrimet e stafit dhe studentëve. GVJ u takua me përfaqësues të ndryshëm, autoritete drejtuese, përfaqësues të studentëve, përfaqësues të zyrave mbështetëse të procesit mësimor, dhe aktivitetëve akademike e kërkimore të Departamentit. Gjithashtu GVJ realizoi dhe një vizitë në ambjente e brendshme të institucionit, që lidheshin kryesisht me programin studimit, vizitoi klasat, laboratorët mësimorë, sekretarinë mësimore, bibliotekën etj. Bazuar në evidencat e vëna në dispozicion, si dhe gjithë informacionin e mbledhur gjatë vizitës, GVJ arriti në konkluzionet të cilat janë dhënë në fushat përkatëse dhe në analizën SWOT.

Më datë 22/11/2022, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 52/142 Prot., datë 08/11/2022, dërgohet në Institucion Draft- Raporti i Vlerësimit të Jashtëm.  
UT kthehu përgjigje, përmes AMS, më datë 13/12/2022.

### **GVJ pasi u njoh me komentet e Institucionit mbi Draft- Raportin, sqaron si vijon:**

GVJ gjatë punës së tij për vlerësimin e plotësimin të Standardeve nga PS Bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore”, shqyrtoi me shumë vëmendje dhe vlerësim, të gjithë materialin e paraqitur nga GVB.

GVJ, vlerëson punën e bërë nga Departamenti i Kimisë Industriale për plotësimin e Standardeve Shtetërore në realizimin e PS Bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore”, dhe kjo evidentohet në vlerësimin **“Përmbushet plotësisht”** për të gjitha standartet.

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit, GVJ ka shprehur mendimin e tij në lidhje me problematika, të cilat nuk e zbehin aspak punën e bërë nga Departamenti, por evidentimi i tyre mendojmë që ndihmon në përmirësimin e saj. Këto problematika GVJ i ka vënë në dukje edhe në takimet që patëm gjatë vizitave në IAL.



## **Duke parë objeksionet e paraqitura nga GVB pas Draftit Raportit të GVJ sqarojmë:**

- a) **Standardi I.5, kriteri 4** thekson shprehimisht "Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të naryrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë". Ndërkohë vlerësimi i ekspertëve të GVJ është shprehimisht: Një nga mangësitë themelore që u vu re në PS Bachelor "Kimi Industriale dhe Mjedisore" ishte se praktikën e detyruar profesionale nuk e ka pjesë të kurrikulës së vet. Fakulteti dhe Universiteti kanë lidhur marrëveshje bashkëpunimi për zhvillimin e praktikave mësimore në Programet e Ciklit të Dytë të studimit (Evidencat 1.28, Evidenca 1.33, sipas evidencave të deklaruara por kjo nuk është pjesë e PS. Kjo duhet të konsiderohet sa më parë që të jetë e mundur.

**Refleksioni i GVB:** lidhur me këtë pikë është: PO, Institucioni vendos (i ka vendosur tashmë) marrëdhënie zyrtare bashkëpunimi me punëdhënësit në varësi të natyrës specifike të programeve të studimit që ofron. Evidenca 1.28 dhe 1.33 (të përmendura në RVJ nga ekspertët) dhe të referuara në RVB e vërtetojnë një gjë të tillë. Për këtë arsye gjykimin Përmbushet kryesisht bazuar në këtë fakt për Standardin L.5 e gjykojmë jo në përputhje me çfarë konkretisht kërkohet në nivel Institucional. Për më tepër mospërfshirja e po këtij elementi (praktikave profesionale) në programin e studimit, përbën bazën për vlerësimin Përmbushet kryesisht për Standardin IL.3.

### **Komenti i GVJ.**

Në RVB në standardin I.5 kriteri 4 thuhet: *"Programi Bachelor "Kimi Industriale dhe Mjedisore" nuk e ka pjesë të kurrikulës së vet praktikën e detyruar profesionale. Fakulteti dhe Universiteti kanë lidhur marrëveshje bashkëpunimi, për zhvillimin e praktikave mësimore në Programet e Ciklit të Dytë të studimit. (Evidencat 1.28, Evidenca 1.33)"*.

Vërtet në RVB në standardin I.3 kriteri 4 tregohet që shumica e studentëve që mbarojnë PS Bachelor në "Kimi Industriale dhe Mjedisore" vazhdojnë studimet në Master, por Sistemi Bachelor duhet t'i përgatisë të gjithë studentët për tregun e punës.

Nga ana tjetër natyra e diplomës, e cila përgatit Kimist Industrial dhe Mjedisor kërkon njohjen e studentëve me procese të ndryshme industriale.

GVJ i ka shfletuar të gjithë evidencat e paraqitura nga GVB për të gjetur ndonjë mundësi shfrytëzimi të kontratave të lidhura nga UT/FSHN nga PS Bachelor "Kimi Industriale dhe Mjedisore", për praktika profesionale, për vizita në kuadër të lëndëve të veçanta (syllabuset), apo për ndonjë internship të kryer nga studentët e këtij PS. Për më tepër problematika e mungesës së praktikës profesionale u evidentua dhe në takimet që patëm me studentët gjatë vizitës në IAL. E kuptojmë që shqetësimi i GVB ka të bëjë dhe me faktin që edhe degë të tjera në FSHN mund të mos e përfshijnë në program praktikën profesionale, por natyra e këtij programi është specifike. Përsa i përket vlerësimit "Përmbushet kryesisht" në standardin II.3, ky vlerësim lidhet drejtpërdrejt me zbatimin e ligjit, VKM 41. dt. 24.01.2018 në lidhje me raportet midis tipologjive të lëndëve, ku nga GVJ propozohet Praktika Profesionale si mundësi e plotësimit të raporteve.

***Mendojmë që vlerësimi për standardin I.5 të mbetet "Përmbushet kryesisht".***



- b) **Standardi V.2 kriteri 4** citon shprehimisht: "Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit" ndërkohë vlerësimi i ekspertëve për këtë kriter është shprehimisht: GVJ rekomandon të rishikohet rregullorja e PS Bachelor "Kimi Industriale dhe mjedisore" në përputhje të plotë me statutin e UT, dhe për tu dhënë mundësinë studentëve të ekselencës që të kenë mundësinë e punimit të temave të diplomës. Kjo kërkon të shoqërohet dhe me rregullimet e tjera përkatëse. Në takimet me stafin e IAL u diskutua dhe për mungesën e një punimit të diplomës për studentë me rezultate të larta, ku nga ana e tyre argumentojë me faktin e një kohe të reduktuar, meqë semestri i gjashtë është planifikuar i plotë në auditor.

**Refleksioni i GVB** lidhur me këtë pikë është që ky është rekomandim i vlefshëm për të gjithë programet Bachelor që kryejnë vlerësimin përfundimtar të studentëve në bazë të provimit të formimit dhe jo me diplomë. Kjo me të drejtë rekomandohet që mund të kryhet pas ndryshimeve dhe rregulloreve përkatëse Institucionale. Gjithsesi ky mbetet rekomandim dhe jo argument për të vlerësuar gjithë Standardin V.2 "Përmbushet kryesisht".

**Komenti i GVJ: Obieksioni i GVB e ka të shkëputur nga konteksti komentin e GVJ në RVJ.**

Në Standartin V.2, kriteri 4, GVJ është shprehur për mospërputhje të Statutit të UT me Rregulloren e Programit të Studimit Bachelor "Kimi Industriale dhe Mjedisore", në lidhje me punimin e diplomës. Statuti i UT është në përputhje me **Ligjin Nr. 80/ 2015** për "Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë".

Kjo është dhe arsyeja kryesore e vlerësimit **Përmbushet kryesisht** për këtë kriter.

Ky problem u diskutua dhe gjatë takimeve në IAL.

Për këtë standard (Standardi V. 2) GVJ mendon që vlerësimi të mbetet "**Përmbushet kryesisht**".

- c) **Standardi III.3 kriteri 3** citon "Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar të IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor" ndërkohë ekspertët e GVJ sugjerojnë përdorimin vetëm të adresave zyrtare të postës elektronike nga stafi në syllabuse dhe CV,

**Refleksioni i GVB:** Dhe pikërisht në faqen zyrtare të FSHN, Departamenti i Kimisë Industriale janë të shfaqura profilet akademike të të gjithë stafit me adresat zyrtare të tyre (emër.mbiemër@fshn.cdu.al), me të cilat studentët mund të komunikojnë me stafin. Në syllabuset e shfaqura gjithashtu në faqen zyrtare nuk paraqiten emrat e pedagogëve dhe si rrjedhim as adresat e tyre të postës elektronike zyrtare apo jo, duke mos shkaktuar asnjë rast vështirësie apo pamundësie në komunikim me studentet.

**Standardi III.3 kriteri 4** citon "Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit", ndërkohë ekspertët e



GVJ shprehen konkretisht- ritheksojmë përditësimin e literaturës në përdorim. recensimin e saj në mënyrë të rregull dhe të panashëm, përfshirë këtu edhe Leksionet e shkruara në përdorim.


**Refleksioni i GVB** lidhur me këtë pikë është që sigurisht e vlerësojmë sugjerimin e tyre dhe ky kriter është detyrë e vazhdueshme dhe e patundme për sa kohë zhvillimet në shkencë dhe literatura respektive kudo në bote është në përmirësim të vazhdueshëm dhe sigurisht kështu duhet të jetë. Por ritheksimi i mësipërm është thjesht pohim dhe jo bazë për vlerësim: përbushet kryesisht për Standardin III.3, kur nuk është argumentuar apo evidentuar konkretisht. Në këtë kontekst për sa më sipër të 2 rekomandim/sugjerimet për kriteret 3 dhe 4 të Standardit III.3 vlejën për tu patur parasysh sot e në vijimsi, por mendojmë që nuk përbëjnë një bazë për të vlerësuar Përbushet Kryesisht Standardi III.3

#### **Komenti i GVJ:**

Në evidencën 4.17 shembull raportimi për mësimin online fq.3 një pjesë e e-mail-ëve të stafit janë jashtë e-mail-it zyrtar (7 prill 2021).

Në evidencën 1.8.1. (Syllabuse), të paraqitur nga GVB, në një prej syllabuseve (Kimi e Përgjithshme) nuk janë vendosur vitet e literaturës dhe në tri prej tyre e-mail-et e hartuesve të syllabusit janë jo zyrtare (lëndët Fizikë, Vizatim Teknik dhe Anglisht).

Duke parë se kjo nuk është në masë dhe meqë pedagogët përkatës nuk janë pjesë e Departamentit të Kimisë Industriale, **GVJ merr parasysh komentet dhe ndryshon vlerësimin e “Përbushet kryesisht” në “Përbushet plotësisht”.**





## Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore”

### I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.</p>	<p>Nga shqyrtimi i hollësishëm i dokumentacionit të depozituar na rezulton se: Universiteti i Tiranës (UT) Fakulteti i Shkencave të Natyrës (FSHN) ofron Programin e studimit (PS) Ciklit të Parë Bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore” (KIM) i cili vlerësohet se synon përgatitjen e kimistëve industrialë me formim të përgjithshëm 3 (tre) vjeçar sipas shkresës së MASH Nr. 7897, datë 14.02.2005. Ky program i ofruar nga Departamenti i Kimisë Industriale (DKI) është në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor për IAL-të në Republikën e Shqipërisë, Statutit të UT (<b>Evidenca 1.1</b>) (<b>Neni 2</b>) dhe në përputhje me objektivat dhe misionin e UT. Ky program nuk bie ndesh me interesat kombëtare po ashtu është në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës 2018-2023 (hyrje, pika 2 &amp; 4) të UT (<b>Evidenca 1.2</b>). Ai synon plotësisht ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave kombëtare, si dhe është hartuar në përputhje me misionin dhe qëllimet e institucionit në këtë fushë.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p>	<p>Nga intervistat e realizuara gjatë ditëve të vizitës, por dhe nga informacioni i vënë në dispozicion, grupi i vlerësimit të jashtëm (GVJ) thekson se ky program kontribuon në zhvillimin e shoqërisë nëpërmjet kërkimit shkencor dhe edukimit në përputhje me qëllimet dhe misionin e UT, si dhe fushën e veprimtarisë së tij. Neni 8, pika 6 i Statutit të UT (<b>Evidenca 1.1</b>), pra ky program studimi synon plotësisht ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. Në Rregulloren e Departamentit të Kimisë Industriale theksohet shprehimisht që misioni i programit të studimit është promovimi i njohurive shkencore nëpërmjet mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. (<b>Evidenca 1.3</b>).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Ky PS është hartuar në përputhje me në përputhje me Misionin e UT (<a href="https://api.fshn.edu.al/uploads/Statuti_i_Ri_i_UT_5916d9f405.pdf">https://api.fshn.edu.al/uploads/Statuti_i_Ri_i_UT_5916d9f405.pdf</a>), si dhe me politikën udhëheqëse të tij dhe përkon me strategjitë e aplikuara për zhvillimin ekonomik të rajonit dhe të vendit. Sa më sipër është hartuar dhe ofrohet në përputhje me misionin dhe objektivat e Departamentit të Kimisë Industriale paraqitur shprehimisht në Rregulloren e Departamentit të Kimisë Industriale. (<b>Evidenca 1.3</b>). Nga i gjithë dokumentacioni në dispozicion si dhe intervistat u pa qartë se PS synon përgatitjen, formimin dhe diplomimin e studentëve në fushën e kimisë industriale.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje</p>	<p>Grupi i vlerësimit të jashtëm thekson veç të tjerash edhe faktin që, në nivel kombëtar, është i vetmi program studimi i këtij</p>



dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	profili që ka traditë dhe vazhdimësi shumëvjeçare dhe rrjedhimisht i vetmi që përgatit në mënyrë periodike dhe të konsoliduar specialistë në këtë fushë. Ky program studimi i hartuar me këtë drejtim është një kurrikul në përputhje me kapacitetet e brëndëshme, ekperiencat më të mira kombëtare si edhe duke patur parasysh zhvillimet dhe perspektivat ekonomike të vendit, sipas Planit Strategjik ( <b>Evidenca 1.4</b> ), në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit të UT.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet kryesisht	Përbushet pjesërisht
			X

Standardi I.2			
Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.			
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve		
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Programi i Studimit është së pari në përputhje me <b>Ligjin e Arsimit të Lartë Neni 71, pika 3</b> . Gjithashtu në statutin e UT-së ( <b>Evidenca 1.1</b> ) përcaktohen të gjitha programet e studimeve që ofrohen. Programi i studimit Bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore” është në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillimin e vetë institucionit e cila nga verifikimi i dokumentacioneve është e pasqyruar në Planin Strategjik të UT 2018-2023 ( <b>Evidenca 1.2</b> ), vizionin dhe misionin e UT-së ( <b>Evidenca 1.1</b> ), dhe Strategjinë e Zhvillimit të programit nga ana e Departamentit të Kimisë Industriale. ( <b>Evidenca 1.4</b> ).		
<b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Nga kontrolli i dokumentacionit bazë: Statuti dhe rregullorja e UT shihen qartë se ato përcaktojnë drejtimet prioritare akademike të PS si edhe demonstrojnë që PS hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të prioriteteve në lidhje me mësimdhënien dhe tregun e punës. Ky program studimi synon të ofrojë njohuri që t’i shërbejnë përmirësimit të qëndrueshmërisë sociale, industriale dhe ekonomike. ( <b>Evidenca 1.1</b> ), ( <b>Evidenca 1.5</b> )		
<b>Kriteri 3.</b> Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit.	Nga verifikimi i dokumentave është konstatuar se: emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e PS ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të UT. Ky PS është emërtuar sipas fushës së studimit të Shkencave Natyrore ( <b>Evidenca 1.1</b> ), ku 1 kredit ( <b>Evidenca 1.1</b> , <b>VKM_nr_41_date_24_1_2018</b> ) përfaqëson 25 orë, nga të cilat mbi 50% jashtë auditorit. Lëndët e programit ndahen në lëndë bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore/integruese, plotësuese dhe detyrime përmbyllëse në përputhje me <b>Udhëzimin e MASR nr.41, dt. 24. 01. 2018 dhe VKM Nr.879 datë 18.12.2019</b> . Ky program i përket nivelit 6 (bachelor) të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet kryesisht	Përbushet pjesërisht
			X



<b>Standardi I.3</b>	
<b>Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.</p>	<p>Programi i Studimit Bachelor në “Kimi Industriale dhe Mjedisore”, ka të përcaktuara qartë objektivat për formimin e studentëve, në Misionin e Departamentit të Kimisë Industriale (<b>Evidenca 1.3</b>). Këto objektiva përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit sipas Rregullores së Departamentit të Kimisë Industriale. Nga kontrolli i dokumentacionit u pa se edhe çdo syllabys i lëndëve të programit ka të përcaktuara: Objektivat e lëndës, Konceptet Themelore, si dhe aftësitë me të cilat do të pajiset studenti në përfundim të programit mësimor (<b>Evidenca 1.8.1, Evidenca 1.8.2</b>).</p> <p>Ky PS zhvillohet në 3 vite akademike dhe realizohet në 180 kredite.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>UT ka realizuar studimin e tregut të punës, në kuadër të akreditimit institucional (<b>Evidenca 1.9.1, Evidenca 1.9</b>) (<b>Evidenca 1.10</b>). Nga ky studim ka rezultuar se: 79% e të intervistuarve qëndrojnë në Tiranë meqë ka më shumë mundësi punësimi në profesion.</p> <p>Të diplomuarit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës kanë treg të konsiderueshëm pune mbi 50%, 55% dhe një pjesë punësohen që gjatë kohës që janë studentë. (<b>Evidenca 1.10</b>) Si edhe në shumë fusha të tjera, sektori privat mbetet më tërheqës (rreth 43%) për studentët që përfundojnë Fakultetin e Shkencave të Natyrës, por shifra prej 22% që i përket sektorit shtetëror tregon dhe për një treg atraktiv punësimi bazuar në meritokracinë dhe rezultatet e larta që sigurojnë studentët e PS Bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore”. Kjo përqindje qëndron e lartë në të gjithë vitet e diplomimit. (<b>Evidenca 1.10</b>).</p> <p>Ajo që vihet re gjatë intervistave është se Departamenti i Kimisë Industriale ka punësuar studentët e tij si staf akademik apo ndihmës akademik. (<b>Evidenca 1.16, Evidenca 1.18</b>).</p> <p>Ky Departament është i përbërë nga 19 anëtarë staf akademik të cilët janë diplomuar ndër vite në këtë fakultet dhe 6 staf ndihmës akademik nga të cilët aktualisht 2 prej tyre janë gjithashtu ish studentë të diplomuar në programin mësimor Bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore” dhe në vijim programet Master në Departamentin e Kimisë Industriale gjatë periudhës 2017-2021, dhe staf akademik 2 ish studentë të diplomuar gjatë të njëjtës periudhë. (<b>Evidenca 1.11.1</b>).</p> <p>Është realizuar edhe pyetësori, në nivel PS (<b>Evidenca 1.11</b>), mbi punësimin e studentëve për vite të ndryshme akademike. Nga rezultatet e pyetësorit, por edhe të dhënat nga Dekanati (<b>Evidenca 1.21.1</b>), ka rezultuar se rreth 70% e studentëve që kanë përfunduar studimet e programit Bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore” vazhdojnë studimet në nivelin e dytë (master) pranë Departamentit të</p>



	<p>Kimisë Industriale. (<b>Evidenca 1.11.1</b>). Pra, rreth 68% e tyre në vitin 2019 kanë vijuar studimet Master në të njëjtin Departament. Kjo sipas viteve: 70% në vitin 2020 dhe 60% në vitin 2021. Një pjesë e studentëve që kanë mbaruar studimet Bachelor, kanë vijuar studimet Master jashtë shtetit. (<b>Evidenca 1.40</b>).</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve, garantojnë përftimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>GVJ vlerëson se ky program studimi, ka një përvojë të gjatë në vite dhe ka krijuar një qëndrueshmëri, traditë dhe vazhdimësi. Objektivat e rëndësishme dhe formuese (<b>Evidenca 1.4</b>) janë të pasqyruara në kurrikulën e programit, struktura e së cilës është në funksion të formimit të specialistëve e teknologëve në fushën e kimisë industriale dhe mjedisore. Të tjerë objektiva të rëndësishëm në RVB përmenden: formim inxhinierësh të ardhshëm të industrisë kimike, formim specialistësh me background të plotësuar në të gjithë aspektet e përgatitjes profesionale dhe social kulturore, përmirësim të vazhdueshëm të programit për t'ju përgjigjur gjithnjë e më mirë ndryshimeve dhe tendencave në kërkesat që parashtron zhvillimi ekonomik i vendit dhe më gjerë, përmirësim të vazhdueshëm të standardit të mësimdhënies, etj.</p> <p>Sa më sipër PS ka në fokus formimin e studentëve dhe përshtatjen e tyre me kërkesat e tregut të punës.</p> <p>Sa më sipër rezulton se ky program garanton plotësisht formimin teorik dhe praktik të specialistëve me aftësi të larta në fushën përkatëse, si një domosdoshmëri themelore e tregut në ditët e sotme. GVJ mendon se ky kriter përgjithësisht përmbushet plotësisht.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p><b>Standardi I.4</b>  <b>Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.</p>	<p>Duke ju referuar dokumentave në dispozicion të paraqitura në ASCAL si edhe nga RVB rezulton se: FSHN-ja është një prej fakulteteve më të vjetër në UT. Ajo përbëhet prej 8 departamentesh dhe 1 qendër kërkimore. Departamentet e FSHN-së kanë në përbërjen e tyre të paktën 7 anëtarë, të punësuar me kohë të plotë si personel akademik, nga të cilët të paktën 3 me grada shkencore ose tituj akademikë. (<b>Evidenca 1.15</b>). PS Bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore” ofrohet nga një staf i kualifikuar (<b>Evidenca 1.16</b>), të cilët kanë eksperiencën e duhur për të mbuluar lëndët e programit të studimit. Nga dokumentat aktualisht Departamenti i Kimisë Industriale ka staf akademik me kohë të plotë <b>19 pedagogë</b>: 3 Profesorë, 4 Profesorë të Asociuar, 10 Doktorë Shkencash, 2 pedagogë me gradën Master i Shkencave (<b>Evidenca 1.17</b>).</p> <p>Infrastruktura për veprimtarinë mësimore – kërkimore të FSHN në të cilën zhvillohet edhe ky PS realizohet në 4 Godina A, B, C dhe D.</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 11



	<p>(<b>Evidenca 2.28</b>). Nga vizita e GVJ u pa se ky PS ka në dispozicion pranë Departamenti i Kimisë Industriale laboratore dhe mjedise pune (zyra) me sipërfaqe totale 630 m<sup>2</sup>, nga të cilat 349 m<sup>2</sup> janë mjedise laboratorike (<b>Evidenca 1.13</b>). Gjithashtu shfrytëzohen edhe mjediset laboratorike të Departamentit të Fizikës, të Kimisë, Kimisë Fizike, 2 laboratorë të Kimisë Industriale 1 dhe 2 dhe Kontrollit dhe parandalimit të ndotjes në industrinë kimikë dhe nje zyrë/klasë të pajisur me 24 kompjutera (për realizimin e lëndës Kontrolli Automatik në Inxhinierine Kimike). (<b>Evidenca 1.13.1</b>). Auditoret e leksioneve dhe seminareve janë të shpërndara në gjithë ndërtesat e fakultetit dhe janë në përdorim për të gjitha programet e studimit. Nga takimi me stafin akademik si edhe nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u pa se stafit akademik, si edhe stafi ndihmës akademik ka të gjitha aftësitë dhe kualifikimet e nevojshme për mbarëvajtjen e proceseve laboratorike. (<b>Evidenca 1.18</b>)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Nga kontrolli i dokumentacionit e programit të studimit Bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore”, GVJ konstatoi se ky program është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Fakultetit të Shkencave të Natyrës (<b>Evidenca 1.1, Evidenca 1.5</b>). Ky program studimi është i organizuar në përputhje me fushën akademike e kërkimore të FSHN-së, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane (<b>VKM 41, 2018</b>) si dhe standardet për sigurimin e cilësisë së programeve të ciklit 1, ASCAL dhe Evropiane. (<b>Evidenca 2.24</b>). Nga dokumentacioni rezulton se: Fusha akademike kërkimore dhe shkencore e stafit akademik mësimdhënës në këtë program studimi (<b>Evidenca 1.17</b>) është konform me disiplinat e lëndëve të programit të studimit “Bachelor në Kimi Industriale dhe Mjedisore”.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Fusha e përgjithshme dhe specifike e PS Bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore”, i cili mbulon sipas manualit të Frascatit, fushën e Shkencave Natyrore dhe është sipas nivelit 6 sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe zhvillohet në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Departamentit të Kimisë Industriale. PS Bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore” (<b>Evidenca 1.7</b>), struktura e saj formuese e realizon nëpërmjet veprimtarive të formimit bazë, veprimtarive karakterizuese, si edhe disiplinave ose nëndisiplinave dhe lëndëve me zgjedhje), veprimtarive plotësuese (për njohjen e gjuhës së huaj, informatike, vizatim teknik) dhe detyrimeve përmblyëse (provim formimi), në respektim të shpërndarjes në përqindje të secilit grup të disiplinave të formimit dhe përcaktimit të krediteve. Ky PS sipas (<b>Evidenca 1.40</b>) ka ngjashmëri me disa programe Kombëtare dhe Ndërkombetare, duke bërë të mundur edhe transferimin e krediteve të studentëve (<b>Evidenca 1.20</b>) si brenda FSHN ashtu edhe në institucione të tjera duke bërë ekuivalentimet përkatëse. PS është i shtrirë në 3 vite akademike dhe përmban 180</p>



	kredite ( <b>Evidenca 1.1</b> ). Diploma Bachelor që lëshohet emërtohet: “Kimi Industriale dhe Mjedisore”.		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

### Standardi I.5

**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Nga dokumentacioni në dispozicion vihet re se në Statutin dhe Rregulloren e UT-së, është dhënë e qartë ndarja e detyrave mes njësive e personelit, marrja e përgjegjësive respektive dhe analizës të punës së tyre. Sa më sipër janë rregulluar edhe marrëdhëniet e bashkëpunimit brenda FSHN, duhe synuar mbarëvajtjen e programit të studimit, nëpërmjet njësive akademike, ndihmës-akademike dhe administrative të shtrira në njësitë kryesore dhe strukturën e rektoratit ( <b>Evidenca 1.1</b> ). Oraret mësimore ( <b>Evidenca 1.39</b> ), ngarkesa e pedagogëve, komunikimi midis njësive bazë, propozimet e njësisë bazë për kuotat ( <b>Evidenca 1.21</b> ), kriteret e pranimit të studentëve në programet e studimit dhe cdo propozim tjetër, miratohen në dekanatin e FSHN dhe përcillen për miratim përfundimtar. ( <b>Evidenca 1.22</b> ) në Senatin Akademik.
<b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ ose të huaj.	UT ka nënshkruar 42 marrëveshje me 100 universitete homologe jashtë vendit, gjatë periudhës 2019-2023 në kuadër të programit Erasmus+KA107. Sa më sipër janë të listuara në faqen zyrtare të Universitetit të Tiranës. ( <a href="https://unitir.edu.al/marreveshjet-erasmus-ka1-te-nenshkruara-nga-universiteti-i-tiranes/">https://unitir.edu.al/marreveshjet-erasmus-ka1-te-nenshkruara-nga-universiteti-i-tiranes/</a> ) Disa anëtarë të Departamentit të Kimisë Industriale ( <b>Evidenca 1.28</b> ) janë angazhuar pranë njësisë Nanoshkencës dhe Nanoteknologjisë Shqiptare (Nanoalb) e krijuar në vitin 2019 në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave. Nga takimi me studentët u pa se ata kanë interes për trajnime ose internship ndaj Departamenti i Kimisë Industriale ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me disa kompani, e pasqyruar kjo edhe tek ( <b>Evidenca 1.28</b> ). Kjo realizohet nëpërmjet Dekanatit të FSHN ( <b>Evidenca 1.33</b> ) duke lidhur marrëveshje bashkëpunimi me disa kompani që ushtrojnë aktivitete brenda fushës që mbulon Departamenti i Kimisë Industriale si p.sh Kantina e Pijeve “Gjergj Kastrioti”, Lufra, Integrated Energy (Zona e Trajtimit të Mbetjeve, Sharrë), Fabrika Stela, etj.
<b>Kriteri 3.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në	Nga takimi me stafin e Departamentit të Kimisë Industriale (DKI) dhe nga dokumentacioni në dispozicioni u vërejt se me njoftim nga Përgjegjësi i Departamentit ( <b>Evidenca 1.34</b> , <b>Evidenca 1.28</b> ) përgatiten raportet vjetore mbi përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit të cilat janë pjesë e integruar e raportit të analizës vjetore të DKI ( <b>Evidenca 3.12</b> ), ato janë objekt i diskutimeve në mbledhje të departamentit, dhe



funkcion të realizimit të programeve të studimeve.	konsistojnë në vlerësimin e mobiliteteve të stafit akademik dalës dhe hyrës, në komunikimin e eksperiencës së fituar tek anëtarët e tjerë të personelit akademik, dhe nxitjen e mobiliteteve të stafit dhe studenteve. Vetë stafi pohon se marrëveshjet e bashkëpunimit kanë kontribuar në fitimin e eksperiencës në mësimdhënie, nga ana e personelit akademik dhe në bashkëpunim për kërkimin shkencor.			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.	<i>Një nga mangësitë themelore që u vu re në PS Bachelor "Kimi Industriale dhe Mjedisore" ishte se praktikën e detyruar profesionale nuk e ka pjesë të kurrikulës së vet. Fakulteti dhe Universiteti kanë lidhur marrëveshje bashkëpunimi, për zhvillimin e praktikave mësimore në Programet e Ciklit të Dytë të studimit (Evidencat 1.28, Evidenca 1.33, sipas evidencave të deklaruara por kjo nuk është pjesë e PS. Kjo duhet të konsiderohet sa më parë që të jetë e mundur.</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	FSHN organizon aktivitete të ndryshme sipas përkatësive të departamenteve si: seminare, workshop-e, trajnime, leksione të hapura simpoziume, konferenca kombëtare ose ndërkombëtare ku ftohen të marrin pjesë studentët ( <b>Evidenca 1.35</b> ). Vetë stafi pohon interesin e shtuar për organizimin e orëve të hapura me lektorë të ftuar të cilët mbajnë jo vetëm leksione por edhe bashkëbisedime mbi tema të ndryshme në interes të formimit të backgroundit profesional të studentëve si specialistë të ardhshëm ( <b>Evidenca 1.36</b> ). Projekti Erasmus+ NETCHEM ( <b>Evidenca 1.31</b> ) gjatë 3 viteve ka realizuar disa workshop-e me pjesëmarrjen edhe të studentëve. Nga bashkëpunimi me Njësinë Nanoalb pranë Akademisë së Shkencave u realizua workshop i parë i Nanoalb me pjesëmarrjen edhe të studentëve ( <b>Evidenca 1.38</b> ).			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				X



## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

<b>Standardi II.1</b>	
<b>Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Nga dokumentacioni në dispozicion vërehet se në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015, si dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe të grumbullimit të Krediteve (ECTS), PS Bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore”, është i organizuar në lëndë dhe module, ku vlerësimi i krediteve realizohet në përputhje me legjislacionin (<b>Evidenca 1.1</b>). Sa më sipër është në përputhje VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL”, ndryshuar me VKM Nr 879, Dt. 18.12.2019 “Disa ndryshime dhe shtesa ne VKM Nr. 41 dt. 24.01.2018” (<b>Evidenca 2.1</b>).</p> <p>Duke cituar RVB si edhe dokumentacionin e vënë në dispozicion, lëndët janë të ndara sipas veprimtarive formuese (<b>Evidenca 1.6, Evidenca 1.7</b>):</p> <p><b>A. LËNDË BAZË</b> – përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme <b>20.6% (37 kredite)</b></p> <p><b>B. LËNDË KARAKTERIZUESE</b> – përgatitje për disiplinën shkencore <b>55% (99 kredite)</b></p> <p><b>C. LËNDË NDËRDISIPLINORE/ INTE GRUESE</b> – nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje <b>15.5% (28 kredite)</b>.</p> <p><b>D. LËNDË PLOTËSUESE</b> – gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale <b>6.7% (12 kredite)</b> [me pak limitit te poshtem (10-15%) te vendosur nga VKM 41. dt. 24.01.2018]</p> <p><b>E. DETYRIME PËRMBYLLËSE 2.2% (4 kredite)</b> ( me pak limitit te poshtem (3-5%) te vendosur nga VKM 41. dt. 24.01.2018 )</p> <p>Totali i krediteve nga Veprimtaria Formuese A, B, C, D, E është 180. (<b>Evidenca 1.6; Evidenca 2.2</b>).</p> <p>Numri total i krediteve është 180 ECTS, nga të cilat 60 kredite gjatë një viti akademik duke ju referuar një studenti me kohë të plotë. Një krediti i korrespondojnë 25 orë mësimore (<b>Evidenca 1.6</b>), programi ka 4500 orë mësimore në total, nga të cilat 2062 janë brenda auditorit dhe 2438 janë jashtë auditorit (<b>Evidenca 1.7</b>).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>Nga takimet me stafin e departamentit, studentët si edhe nga dokumentacioni në dispozicion, vlerësohet se ky program studimi synon formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh. Programi përgatit studentët me njohuri të përgjithshme dhe njohuri specifike në disiplinat bazë dhe karakterizuese. Lëndët që japin njohuri të përgjithshme nga fushat e Matematikës, Fizikës, Vizatimit teknik, Kimisë së Përgjithshme e Inorganike, Kimisë Organike, Kimisë Fizike dhe Koloidale, Kimisë Analitike, etj. Ky program ofron edhe njohuri të tjera duke ju referuar lëndëve të profilit Bazat e Transportit të Impulsit, Nxehtësisë dhe Masës, Lëndët e djegshme dhe energjia, Kontrolli i proceseve në Inxhinerinë kimike, Kontrolli dhe parandalimi i Ndotjes në Industrinë Kimike, Inxhineria e</p>



	<p>Reaksioneve Kimike, Bazat e Industrisë Kimike, Kimia Industriale 1 dhe 2, ndihmojnë studentin për formimin e tij të mëtejshëm, si një Kimist Industrial. <b>(Evidenca 1.6).</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparura në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore” u ofron studentëve njohuritë bazë dhe specifike, që do të jenë të nevojshme për të nivelin e parë bachelor si edhe për të ndjekur në vazhdimësi cikle të tjera studimi dhe njëkohësisht u përgjigjet kërkesave për t’u përballur me tregun aktual të punës në vend.</p> <p>Të kuptuarit kritik i teorive dhe parimeve akademike të fushës së Kimisë industriale dhe asaj mjedisore, shihet i lidhur me kurrikulën e cila ka shtrirje të njohurive teorike dhe praktike. Studentët në këtë kriter kanë një reagim shumë pozitiv në lidhje seancat laboratorike.</p> <p>Periudha e pandemisë i ka penalizuar ata nga disa veprimtari dhe orë laboratorike. Studentët e vitit të fundit e vlerësojnë peshën e seancave laboratorike si edhe të mjedisoreve dhe pajisjeve në laboratore. Sa më sipër, pesha në PS është e pasqyruar në programin mësimor të studimit Bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore” <b>(Evidenca 2.3, Evidenca 2.3.1, Evidenca 1.7).</b> Nga vizitat në mjediset e Departamentit të Kimisë Industriale dhe dokumentat në dispozicion u pa që: në përbërje të infrastrukturës <b>(Evidenca 1.13.1)</b> departamenti ka në total 9 laboratore mësimore shkencor, ku 7 laboratorë mësimorë janë të pozicionuar në godinën A dhe 2 laboratorë mësimorë janë të pozicionuar në mjediset e jashtme të godinës A.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Nga takimi me studentët ata pohojnë se në përfundim të programit të studimit, zotërojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të nevojshme për të trajtuar problematikat teorike dhe praktike të thjeshta dhe komplekse në fushën e kimisë dhe mjedisit <b>(Evidenca 1.6, Evidenca 1.7).</b></p> <p>Dokumentacioni në dispozicion tregon që nëpërmjet njohurive teorike dhe laboratorike sigurohen kompetencat profesionale, kjo me anë të koncepteve që trajtohen në secilin modul dhe paraqiten qartë në syllabuset e moduleve. Këtu përmendim temat që zhvillohen dhe literaturën e përdorur bashkëkohore. <b>(Evidenca 1.8.1, Evidenca 2.25).</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Duke u nisur nga konsideratat teorike dhe praktike të dokumentacionit në dispozicion si edhe të intervistave me personelin e programit të studimit, gjykojmë me shumë vend emërtimin dhe strukturën e tij <b>(Evidenca 1.6).</b> Programi i studimit Bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore”, përmban të gjitha elementët që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore dhe nënligjore të Arsimit të <b>Lartë 80/2015</b>; Në mënyrë të përmbledhur tërësia e veprimtarive formuese jepet tek <b>(Evidenca 1.7).</b> Veprimtaritë formuese që përbëjnë programin e studimit, janë të grupuara në semestra. Çdo vit akademik ka dy semestra dhe semestri ka 15 javë. Vetëm semetri i katërt ka 14 javë <b>(Evidenca 1.6, Evidenca 1.8, Evidenca 2.35).</b> Çdo javë ka 20-25 orë mësimore leksione, seminare e laboratorë <b>(Evidenca 1.5).</b></p> <p><b>Evidenca 1.8.5</b> jep programin e provimit të formimit (atë të Provimit të Diplomimit). Në përputhje me Udhëzimin Nr.41 të MASR, dt. <b>24.01.2018</b> për “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 16



	<p>IAL”, ndryshuar me VKM Nr 879, Dt. 18.12.2019 “Disa ndryshime dhe shtesa në VKM Nr. 41 dt. 24.01.2018”. (Evidenca 2.1, Evidenca 1.8), Programi i studimit: Bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore” përmban të gjitha elementet e strukturës së kërkuar prej tij.</p> <p>Dosja e plotë PS (Evidenca 1.8), përmban: Programet e lëndëve/ Syllabuset (Evidenca 1.8.1), Kurrikulën (Evidenca 1.8.2), Rregulloren e Diplomimit (Evidenca 1.8.3), Modelin e Diplomës dhe Supplementin e Diplomës (Evidenca 1.8.4), Programin e Provimit të diplomimit (Evidenca 1.8.5), Rregulloren e programit të studimit (Evidenca 1.6), Planin Mësimor (Evidenca 1.7).</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore” i ka të grupuara lëndët sipas kategorive/ veprimtarive formuese si mëposhtë (Evidenca 1.7, Evidenca 2.2), sa më sipër i referohet VKM Nr. 41. Numri total i krediteve 180 është i shpërndarë sipas veprimtarive formuese, e cila shpreh qartë përqindjen që duhet të zërë specifikisht çdo veprimtari formuese.</p> <p>Struktura e PS të ciklit të parë përfshin: Disiplina të formimit të përgjithshëm, Disiplina të formimit karakterizues të programit, Disiplina formuese të ngjashme ose/ dhe integruese me disipinat karakterizuese, disiplina formuese të zgjedhura, Veprimtari formuese për njohje të gjuhës së huaj, aftësi informatike (Evidenca 2.1, Evidenca 1.5). Konkretisht;</p> <p><b>LËNDË BAZË</b> – përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme (A) 20.6% (37 kredite),</p> <p><b>LËNDË KARAKTERIZUESE</b> – përgatitje për disipinën shkencore (B) 55 % (99 kredite),</p> <p><b>LËNDË PLOTËSUESE</b> – gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale (C) <b>LËNDË NDËRDISIPLINORE/ INTE GRUESE</b> – nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje 15.5% (28 kredite). (D) 6.7% (12 kredite), [më pak limitit të poshtëm (10-15%) te vendosur nga VKM 41. dt. 24.01.2018]</p> <p><b>DETYRIME PËRMBYLLËSE (E) 2.2% (4 kredite)</b> në Total 180 kredite. [me pak limitit te poshtem (3-5%) te vendosur nga VKM 41. dt. 24.01.2018 ]</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
			X	

<p><b>Standardi II.2</b></p> <p><b>Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet</p>	<p>FSHN dhe departamenti i Kimisë Industriale janë përgjegjëse për programin e studimit Bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore” (Evidenca 2.10). Ky PS përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin. Në përputhje me Ligjin 80/2015, Univesiteti i Tiranës është akredituar në nivel institucional me <b>Vendim të Bordit të Akreditimit</b></p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 17



ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	<p><b>Nr.84 datë 27.10.2018. (Evidenca 1.9, Evidenca 1.9.1)</b> si edhe (<a href="https://www.ascal.al/sq/akreditimi/institucione-te-akredituara">https://www.ascal.al/sq/akreditimi/institucione-te-akredituara</a>).</p> <p>Gjithashtu Universiteti i Tiranës ka marrë konfirmimin nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit të Lartë për akreditimin e Programit të Studimit ciklin e parë Bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore”, si dhe ka kryer pagesën për këtë shërbim.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinator i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.</p>	<p>Në përputhje me kërkesat e Ligjit të Arsimit të Lartë, koordinatori i programit të studimit Bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore”, është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit në përputhje me objektivat e tij, mban titullin Prof. Dr dhe është përgjegjësi i departamentit.</p> <p>Koordinatori i programit sistematikisht harton raportet mbi ecurinë e programit të studimit ku janë të specifikuar veprimtaria, ecuritë dhe problematikat e shfaqura gjatë vitit akademik. Ai raporton për çdo përmirësim në programet dhe planet mësimore të programeve të studimit që janë kryer çdo vit, duke synuar një përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë. <b>(Evidenca 1.5, Evidenca 1.28, Evidenca 2.12, Evidenca 2.31, Evidenca 2.32).</b> Ai ka mbështetje të plotë në departament nga drejtuesit e Grupeve mësimorë-kërkimorë (GMK), <b>(Evidenca 2.13, Evidenca 1.5).</b> Këto grupe janë: GMK Kimi dhe Teknologji Ushqimore, GMK Teknologji Kimike, GMK Inxhinieria e Proceseve Kimike.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Në përputhje me kërkesat ligjore të <b>Ligjit Nr. 80/2015</b> për “Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, FSHN /DKI është i strukturuar <b>(Evidenca 1.1, Evidenca 1.6)</b>, në përputhje me to; përmbushja e detyrimeve ligjore dhe nënligjore për të punësuar personel akademik, personël ndihmës akademik dhe administrativ <b>(Evidenca 1.25)</b>, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike <b>(Evidenca 2.17)</b>, ofrimi i programe të ciklit të parë, të dytë dhe të tretë të studimeve: Bachelor, Master Shkencor/Profesional dhe Doktoratura.</p> <p>FSHN konsiderohet si një prej fakulteteve më të vjetër dhe më i madhi në Universitetin e Tiranës. Ka në përbërje 8 departamente dhe 1 qendër kërkimore <b>(Evidenca 1.15)</b>, me staf akademik me grada/tituj si Prof.Dr., Prof. Asoc. Dr., Dr. dhe Msc. <b>(Evidenca 2.11).</b></p> <p>Dekanati i FSHN përbëhet: Zv. Dekan për kurrikulat e Ciklit të Parë dhe Ciklit të Dytë të Studimeve, i cili mbikëqyr përgatitjen dhe zbatimin e planeve dhe programeve mësimore të ofruara nga Fakulteti i Shkencave të Natyrës <b>(evidenca 1.5)</b>. Zv. Dekani për Projektet Shkencore dhe Qendrat e Kërkim-Zhvillimit mbikëqyr dhe koordinon punën kërkimore-shkencore të gjithë njësisive bazë të Fakultetit të Shkencave të Natyrës <b>(evidenca 1.5).</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.</p>	<p>Nga dokumentacioni në dispozicion si edhe nga takimet me personelin akademik dhe ndihmës akademik i PS rezulton se: FSHN dhe Departamenti i Kimisë Industriale si përgjegjës për PS të ciklit të parë Bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore” përmbushin detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik. Na rezulton se rreth 90 % të të gjithë personelit akademik efektiv të njësisë bazë ka tituj akademikë dhe grada shkencore. Ndërsa 10 % e personelit akademik</p>



	<p>nuk kanë filluar ende procesin e kualifikimit, pasi pritet hapja e studimeve të Ciklit të Tretë pranë IAL.</p> <p>Departamenti i Kimisë Industriale ka në përbërjen e tij <b>19 personel akademik me kohë të plotë, prej të cilëve 3 mbajnë titullin akademik “Profesor Doktor”; 4 “Prof Asoc”; 10 kanë gradën shkencore “Doktor i Shkencave” dhe 2 asistentë lektorë kanë gradën “MSc”.</b> Gjithashtu, Departamenti i Kimisë Industriale ka në përbërje dhe 6 (gjashtë) anëtarë personel ndihmës akademik (<b>Evidenca 2.11, Evidenca 1.16, Evidenca 2.7</b>).</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Nga dokumentacioni na rezultojnë se: Fakulteti i Shkencave të Natyrës/ Departamenti i Kimisë Industriale është i strukturuar sipas përcaktimeve ligjore të <b>Ligjit Nr. 80/2015</b> për “Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike. (<b>Evidenca 2.17</b>).</p> <p>Gjithashtu, Departamenti i Kimisë Industriale plotëson standardin (mbi 7 personel akademik) për të qenë njësi bazë, pasi ka në përbërje të tij 19 lektorë me kohë të plotë, si Personel Akademik, nga të cilët 3 “Profesor Doktor”, 4 “Prof Asoc”; 10 “Doktor i Shkencave” dhe 2 kanë gradën “Master i Shkencave”.</p> <p>Departamenti i Kimisë Industriale ka në përbërje dhe 6 (gjashtë) anëtarë personel ndihmës akademik (<b>Evidenca 2.11, Evidenca 1.16, Evidenca 2.7</b>).</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Në përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Standardi II.3</b>  <b>Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/ bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Njësia kryesore FSHN dhe njësia bazë përgjegjëse për organizimin e programit të studimit Bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore”, Departamenti i Kimisë Industriale disponon të gjitha informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e tij. Nga dokumentat e vëna në dispozicion shihet se në tërësinë e tyre këto kritere përgjithësisht përmbushen dhe ndër të tjera përmbahen: Rregullorja e Univesitetit të Tiranës (<b>Evidenca 1.5</b>), Rregullorja e Departamentit (<b>Evidenca 1.3</b>), Rregullorja e programit të studimit (<b>Evidenca 1.6</b>), Plani mësimor i programit të studimit Bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore” (<b>Evidenca 1.7, Evidenca 2.19</b>). Në të përfshihen edhe informacioni mbi disiplinat të grupuara në kategoritë përkatëse: lëndë bazë (6 disiplina), lëndë karakterizuese (14 disiplina), lëndë ndërdisiplinore integruese (5 disiplina), gruplëndë me zgjedhje (3 disiplina) dhe lëndë plotësuese (4 disiplina).</p> <p><i>Përmbajtjen e programit të studimit dhe cilësinë e saj do ta trajtonim edhe në lidhje me literaturën e cila mendojmë se ka nevojë për</i></p>



	<p><i>përditësime si edhe specifikime konkrete se me cilin program është përafruar duke specifikuar edhe kur ka përafrime të pjeshme.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>VKM Nr. 41 të MASR, dt. 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL”, ndryshuar me VKM Nr 879, Dt. 18.12.2019 “Disa ndryshime dhe shtesa ne VKM Nr. 41 dt. 24.01.2018” (<b>Evidenca 2.1</b>) është baza ligjore e Programi i studimit Bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore”. Në planin mësimor të programit të studimit Bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore”, përmban veprimtaritë formuese (studim në auditor dhe individual) përcaktohen: lëndët e programit të studimit, të ndara sipas kategorive të veprimtarive formuese, si dhe në vite e semestra me kreditet përkatëse.</p> <p>Ndarja e orëve mësimore në auditor në orë për leksione, seminare, ushtrime e laboratorë për çdo disiplinë, përcaktohet në planin mësimor të programit të studimit, në bazë të krediteve, që ka secila disiplinë. Veprimtaritë formuese janë në përputhje me rregulloren e Departamentit të Kimisë Industriale. (<b>Evidenca 1.8, Evidenca 1.7, Evidenca 1.6</b>). Raportet ndërmjet veprimtarive formuese të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor janë në përputhje me specifikimet në VKM nr 41. (<b>Evidenca 2.1, Evidenc.6</b>).</p> <p>Tek tipologjia e <b>LËNDËVE PLOTËSUESE</b> përmbahen gjuhë të huaja, vizatim teknik, njohuri informatike dhe Edukim fizik, 4 module që përbëjnë 6.7% (12 kredite). <i>Theksojmë që në këtë PS mungojë praktikat profesionale pavarësisht që në VKM ato janë të përcaktuara të jenë pjesë e lëndëve të tipologjisë E. Edhe vetë stafi akademik dhe studentët janë pro zhvillimit të kësaj lënde.</i></p> <p><i>Pavarësisht se ruhen tipologjitë e lëndëve, nga shqyrtimi i evidencës 1.6 dhe tabelën 9 ASCAL vërehet që pesha në % kundrejt totalit 180 të krediteve për kategoritë nuk janë në përshtatshmëri me limitet e përcaktuara nga VKM Nr. 41. Dt. 24.01.2018.</i></p> <p><i>Kështu kreditet për lëndët e tipit A zënë 20.6%, të tipit B 55%; të tipit C 15.55%; të tipit D 6.7% të tipit E vetëm 2.2%.</i></p> <p><i>Siç shihet lëndët e tipit A e tejkalojnë pak limitin 20 % që përcakton VKM 41 (15-20) dhe së bashku me ato të tipit B venë 75 % (limiti jo më pak se 70 %). Edhe lëndët e Tipit C e tejkalojnë limitin (12-15%) . Këto tejkalime (jo të larta) çojnë në raportet e ulëta për lëndët e tipit D (vetëm 6.7% nga 10-15% sipas VKM 41. dt. 24.01.2018 (Përfshirja e Praktikës Profesionale mund të ishte një mundësi për realizimin e këtij kriteri ). Edhe kreditet e vendosura për provimin e diplomës janë të ulëta dhe mendojmë që duhet të jenë jo më pak se 6 kredite.</i></p> <p><i>Mendojmë që ky kriter nuk plotësohet plotësisht ndaj duhen rishikuar vlerësimet në kredite për tipologjitë e lëndëve deri në përmbushjen e kërkesave të VKM 41. dt. 24.01.2018.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të</p>	<p>Nga dokumentat e depozituara rezulton që: PS të ciklit të parë Bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore” është i organizuar në</p>



<p>vlerësuar me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>gjashtë semestra, secili vit ka 2 semestra, përkatësisht me 15 javë mësimore semestri, semestri VI ka 14 javë mësimore (<b>Evidenca 1.6, Evidenca 1.8, Evidenca 2.35</b>). Për studentët e vitit të tretë organizohet një javë konsultimesh me pedagogët respektive të lëndëve të përfshira në provimin e diplomës. Kjo zakonisht parashikohet javën paraprirëse të provimit të diplomës. Studentët njihen me planifikimin e detajuar për sallat, orarin dhe pedagogët titullarë të lëndëve. Çdo semestër ka afërsisht 30 kredite në lëndë module (29 module të detyruara, 6 module me zgjedhje dhe provimi diplome) të cilat janë të vlerësuar në total me 180 kredite ECTS. Në semestrin e gjashtë përgatitet Provimi Formimi që vlerësohet me 4 kredite. Numri total i krediteve në programin e studimit Bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore” është i shpërndarë sipas veprimtarive formuese. Për programin e studimit të ciklit të parë, lëndët janë të ndara sipas veprimtarive formuese (<b>Evidenca 2.20</b>).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/ jashtë auditorit, frekuentimin/ ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Nga kontrolli i dokumentacionit dhe nga RVB na rezulton që PS përmban planin mësimor (<b>Evidenca 1.7</b>), në të cilin përfshihen informacionet e nevojshme për modulet e zhvilluara si: ngarkesën mësimore (leksione, seminare, laboratore), orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve. Ngarkesa mësimore totale në auditor e programit të studimit është 2062 orë, kurse jashtë auditorit 2438 orë. Ngarkesa mësimore në javë është afërsisht 20 – 25 orë në javë. (<b>Evidenca 1.7</b>). Mësimi në auditor (<b>Evidenca 2.21, Evidenca 2.22</b>) përfshin leksionet, seminarët, seancat laboratorike, si dhe format e kontrollit të vazhdueshëm (<b>Evidenca 1.6</b>). Ngarkesa jashtë auditorit përfshin përgatitjen për provime, të detyrave lëndore, detyrave të kursit, si dhe përgatitjen e provimit të diplomës (<b>Evidenca 1.6</b>). Rregullat për ndjekjen, frekuentimin e programit dhe vlerësimin e dijeve janë të pasqyruara në syllabuset (<b>Evidenca 1.8.1</b>). Studenti vlerësohet 5% deri në 10 % gjatë vitit për frekuentim, aktivizim, sipas veprimtarive formuese të specifikuar në planin mësimor dhe syllabus. Mënyra e vlerësimit përfundimtar të dijeve është provim me shkrim.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Nga takimi me studentët rezultoi se ata janë të informuar në lidhje me programin e studimit dhe kurrikulën përkatëse. Për të tërhequr sa më shumë studentët në këtë PS janë organizuar aktiviteteve orientuese si edhe këshillime dhe informacione me nxënësit në shkollat e mesme; shpërndarje informacioni mbi programet e studimit; takimin e studentëve të vitit të parë me personelin akademik të programit të studimit, informimin e studentëve nga pedagogu i lëndës, dhe takimet me kujdestarët në vazhdimësi të formimit të tyre, si dhe informim i studentëve në lidhje me përfshirjen e tyre në tregun e punës (<b>Evidenca 2.23</b>). UT dhe FSHN ofron mundësi për njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve, midis programeve të të njëjtit cikël studimi, brenda të njëjtit institucion apo institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë. (<b>Evidenca 1.6, Evidenca 1.1, Evidenca 1.20</b>).</p>



<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Nga kontrolli i dokumentacionit vihet re se PS të ciklit të parë Bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore”, përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për seminarët apo orët e laboratorit. Informacioni për praktikat mungon për faktin që ato nuk zhvillohen. Nga takimet me personelin akademik të PS pohohet se ata duhet të dorëzojnë çdo fillim viti akademik, programin lëndor (syllabus-in) (<b>Evidencë 1.8.1</b>) për modulën që mbulojnë, në formatin e përcaktuar në <b>VKM 41/2018, Pika 2.8.</b></p>		
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Nga takimi me stafin akademik të PS për këtë kriter u pohua se përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm. Në çdo fillim viti propozohen ndryshimet nga departamenti në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale. Merren vendimet përkatëse në Dekanat deri në miratimin përfundimtar nga Senati Akademik i UT-së, në rastin kur masa e ndryshimit të kërkuar nuk e kalon nivelin 20% (<b>Evidenca 1.8, Evidenca 2.29, Evidenca 2.30, Evidenca 2.31, Evidenca 2.32</b>). Në rregulloren e UT (<b>Evidenca 1.5</b>) përcaktohen ndryshime të rëndësishme të planit mësimor dhe vendimi merret nga dekani, pasi shqyrton me kujdes Analizën Mësimore të Departamentit, Raportin e Analizës Mësimore të FSHN dhe të Raportit vjetor të Komisionit të Sigurimit të Cilësisë dhe Kurrikulave.</p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
		X	

<p><b>Standardi II.4</b></p>	
<p><b>Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxëniet dhe vazhdimet të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>Në dokumentacionin që kemi në dispozicion vërehet se Programi i studimit Bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore” është i strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi; Studimet e programit ofrohen me kohë të plotë dhe i përkasin nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (<b>LIGJI Nr.10 247, dt 4. 3. 2010, për kornizën shqiptare të kualifikimeve</b>).</p> <p>Ngarkesa në programin e studimit të ciklit të parë Bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore”, është i organizuar në tre vite akademike. Sasia e krediteve të grumbulluara gjatë tre viteve është 180, për një vit është 60 kredite.</p> <p>Ngarkesa mësimore javore e studentëve në auditor, për leksione, seminare dhe labore është gjithashtu në përputhje me parashikimet nënligjore në fuqi: 1 kredit është 25 orë mësimore, Viti akademik përmban 1500 orë pune të studentit (orë në auditor dhe orë pune të pavarur). Orët e studentit për punë të pavarur zenë jo më pak se 50% të orëve të përgjithshme të 1500 orëve mësimore vjetore.</p>



	<p>Programi i studimit të ciklit të parë tre vjecar Bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore” është i organizuar në gjashtë semestra, secili vit ka 2 semestra, përkatësisht me 15 javë mësimore semestri, semestri VI ka 14 javë mësimore (<b>Evidenca 1.6, Evidenca 1.8, Evidenca 2.35</b>). Për studentët e vitit të tretë organizohet një javë konsultimesh me pedagogët respektive të lëndëve të përfshira në provimin e diplomës.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.</p>	<p>Emërtimi i Programit të studimit të ciklit të parë Bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore”, është i bërë në përputhje me <b>Ligjin e Arsimit të Lartë 80/ 2015</b>, e reflektuar kjo edhe në strukturën e programit sipas Statutit (<b>Evidenca 1.1</b>) dhe Rregullores së UT (<b>Evidenca 1.5</b>). Përmbajtja e veprimtarive dhe shpërndarja e lëndëve u ofron studentëve njohuritë bazë që janë të nevojshme për të ndjekur ciklet e tjera të studimit, dhe aftësi për t’u përballur gjatë ushtrimit të profesionit të tyre. Në dokumentat në dispozicion si edhe nga RVB vërehet se: Planet mësimore të programit (<b>Evidenca 1.7</b>) të studimit përfshijnë lëndë të formimit bazë, lëndë karakterizuese të cilat synojnë në një formim të përgjithshëm të studentit, si kimist industrial. Veç këtyre lëndëve studentët kanë mundësinë të fitojnë njohuri integruese, plotësuese dhe përmblylëse të tij (<b>Evidenca 2.2</b>). Këto njohuri mundësojnë përfitimin e dijeve që i përgjigjen kërkesave të tregut të punës të paraqitur në Strategjinë e zhvillimit të programit (<b>Evidenca 1.4</b>). Nga të dhënat e RVB citojmë: Në kuadër të akreditimit institucional (<b>Evidenca 1.9, Evidenca 1.9.1</b>), UT ka realizuar studimin e tregut të punës (<b>Evidenca 1.10</b>), ku shihet që 79% e të intervistuarve qëndrojnë në Tiranë meqë ka më shumë mundësi punësimi në profesion. Tendencat e tregut tregojnë që studentët që përfundojnë Fakultetin e Shkencave të Natyrës kanë treg të konsiderueshëm pune mbi 50% 55% punësohen që gjatë kohës që janë student <b>Evidenca 1.10</b>). Sektori privat mbetet më tërheqës (43%) për studentët që përfundojnë Fakultetin e Shkencave të Natyrës, por një përqindje të ndjeshme ka edhe sektori shtetëror 22%. Kjo përqindje qëndron e lartë në të gjithë vitet e diplomimit (<b>Evidenca 1.10</b>). Departamenti i Kimisë Industriale ka punësuar studentët e tij si staf akademik apo si personel ndihmës akademik (<b>Evidenca 1.11.1</b>).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Lëndët/ modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimi profesional.</p>	<p>Duke u bazuar në legjislacionin në fuqi, eksperiencën në vite të Programit të studimit Bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore” vërehet se organizimi i këtij PS mundëson arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimi profesional, gjatë tre viteve akademike (180 kredite), gjashtë semestrave (nga 60 kredite secili) dhe në fund të vitit të tretë provimi i formimit 4 kredite. Studentët gjatë kësaj periudhe marrin njohuri të formimit bazë (Matematika I, II dhe Matematika e zbatuar, Fizika I dhe II, Kimi e Përgjithshme); njohuri formimi karakterizues përgatitje për disiplinën shkencore (Kimi Inorganike, Kimia Organike, Kimia Fizike dhe Koloidale, Kimia Analitike, Bazat e Transportit të Impulsit, Nxehtësisë dhe Masës, Bazat e Industrisë Kimike, Procese dhe Impiante në Inxhinierinë Kimike, Kimi Industriale I dhe II, Kontrolli dhe parandalimi i ndotjes në Industrinë Kimike, Kontrolli i proceseve në</p>



	Inxhinierinë Kimike); njohuri në lëndë ndërdisiplinore/integruese (Projektim dhe ekonomi procesesh I dhe II, Inxhinieria e reaksioneve kimike, Lënda e djegshme dhe energjia, Polimerët dhe materialet plastike, Lëndë me zgjedhje I,II,III), si dhe lëndët plotësuese (Informatikë, Gjuhë e Huaj, vizatim teknik dhe edukim fizik ( <b>Evidenca 1.7</b> ). Nga 20 lëndë bazë + karakterizuese që përmban programi i studimit Bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore” ( <b>Evidenca 1.7</b> ), 14 prej tyre, pra mbi 50% e lëndëve kanë orë laboratorike, të cilat synojnë rritjen e nivelit të të nxëniet dhe aftësimin profesional të studentëve.
<b>Kriteri 4.</b> Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Nga dokumentat e vëna në dispozicion rezultojnë se struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe gjithashtu duke qënë një program bazal ka përafrime me programe të ngjashme ndërkombëtare ( <b>Evidenca 1.40</b> ) dhe në sistemin Evropian të Transferimit dhe Mbledhjes së Krediteve (ECTS). Referuar lëndëve që përfshijnë leksione, seminare dhe laboratore në programet e tyre, raporti është ( <b>Evidenca 1.7</b> ). Struktura e programit në lidhje me lëndët, veprimtaritë mësimore dhe kreditet është e ngjashme me programe të tjera të Kimisë Industriale dhe Mjedisore në institucione të tjera homologe dhe kjo ka mundësuar procesin e ekuivalentimeve të lëndëve për transferimet dhe për studime në degë të dyta ( <b>Evidenca 1.20, Evidenca 1.27</b> ).
<b>Kriteri 5.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Në lidhje me këtë kriter vërehet se ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik në Fakultetin e Shkencave Natyrore, Departamentin e Kimisë Industriale, mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve. Mësim në auditor, si: leksione, seminare, ushtrime, orë laboratorike, forma të kontrollit të vazhdueshëm të zhvilluara në auditor. Studim individual, si: studim dhe punim relacionesh, detyrash apo projektesh dhe përgatitje për provimin e diplomës.
<b>Kriteri 6.</b> Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.	Nga takimi me personelin akademik të PS, drejtuesin e departamentit dhe dekanin e FSHN, pohohet se politikat e përditësimit në mënyrë të vazhdueshme të Syllabuseve ( <b>Evidenca 1.8.1</b> ) realizohen duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit, sidomos kjo për modulet që e lejojnë këtë. Personeli akademik pohon se mënyra e përzgjedhjes dhe përdorimit të literaturës është një aspekt shumë i rëndësishëm dhe synimi i punës së tyre kërkimore – shkencore. Ky program studimi mbështetet me tekste bazë të botuara nga personeli akademik që sigurojnë transmetimin e njohurive bashkëkohore tek studentët. Vërehet se afërsisht 82% e moduleve mbulohen me tekste mësimore bazë në shqip.
<b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.	Takimet me studentët dhe personelin akademik të Programit të studimit të ciklit të parë Bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore”, pohohet përmbajtja e këtij programi garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave duke zhvilluar dhe përmirësuar në vite përmbajtjen e saj. Organizimi i programit garanton cilësi dhe plotësimin e kërkesave të tyre. Vetë objektivat, njohuritë dhe aftësitë me të cilat pajiset studenti



	<p>në këtë program studimi gjenden në formatin e plotë të programit mësimor i cili shërben, si bazë për formimin e studentëve kimistë industriale, për studime më të thelluara në ciklet pasardhëse të studimit dhe në faqen web të Departamentit të Kimisë Industriale (<a href="https://fshn.edu.al/Departments/departamenti-i-kimise-industriale/Programmes/kimi-industriale-bsc">https://fshn.edu.al/Departments/departamenti-i-kimise-industriale/Programmes/kimi-industriale-bsc</a>).</p>			
<p><b>Kriteri 8.</b> Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Nga dokumentacioni i PS vërehet se përmbajtja e tij e mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve pasi studentët janë të pajisur me njohuritë bazë të nevojshme për të ndjekur ciklet e tjera të studimit dhe u përgjigjet kërkesave me të cilat ata mund të përballen me kërkesat e tregut të punës. Nga takimet me studentët ata pohojnë se gjatë viteve të studimeve ata marrin njohuritë bazë dhe specifike të hollësishme në lidhje me shumë aspekte të Kimisë Industriale dhe Mjedisore. Pas përfundimit të ciklit të parë, studentët anketohen në lidhje me vijimin e studimeve apo punësimin e tyre. Në nivel programi studimi është realizuar pyetësori (<b>Evidenca 1.11</b>) mbi punësimin e studentëve për vite të ndryshme akademike.</p>			
<p><b>Kriteri 9.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Personeli akademik dhe dekani i FSHN-së pohojnë se ata bashkëpunojnë në mënyrë të vazhduar me biznesin, për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës. UT, FSHN organizojnë Panairat e Karrierës, për të ndihmuar studentët në një përfaqje më të mirë ndaj tregut të punës, si dhe për mundësi punësimi dhe internshipi. Në këto panairë marrin pjesë subjekte publike dhe private, ku diskutohen mundësitë për marrëveshje bashkëpunimi (<b>Evidenca 1.33</b>), si dhe konsultime për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe përshtatjen e tyre me kërkesat e tregut e punës.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p><b>Standardi II.5</b>  <b>Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>Nga takimet me personat e ngarkuar në FSHN për rekrutimin e personelit akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, nga dokumentat që u panë direkt në zyrën përkatëse të FSHN u pa që ky proces kryhet në përputhje me <b>Ligjin e Arsimit të Lartë 2015 neni 59, pika 6</b>, si dhe në përputhje me Statutin e UT. Kategorizimi i personelit në Profesor/ Lektor/ Asistent Lektor është gjithashtu në përputhje me nenin e sipërcituara (<b>Evidencë 2.26</b>).</p> <p>Nga dosjet dhe CV u pa që: Personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie në Programin e Studimit Bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore” me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, pasi gjithë personeli akademik ka së paku kualifikim të ciklit pasardhës (<b>Evidenca 2.10, Evidenca 1.17</b>).</p>



<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesëshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Nga dokumentacioni në dispozicion si edhe nga RVB rezulton që: Departamenti i Kimisë Industriale ka në përbërjen e tij 19 personel akademik me kohe të plotë, prej të cilëve 3 mbajnë titullin akademik “Profesor Doktor”; 4 “Prof Asoc”; 10 kanë gradën shkencore “Doktor i Shkencave” dhe 2 asistentë lektorë kanë gradën “MSc”. Gjithashtu, Departamenti i Kimisë Industriale ka në përbërje dhe 6 (gjashtë) anëtarë personel ndihmës akademik (<b>Evidenca 2.11, Evidenca 1.16, Evidenca 2.7</b>). Vetë personeli thekson që bëhen përpjekje të vazhdueshme për kualifikimin e tyre, si nga ana e mësimdhënies dhe shkencore, duke marrë pjesë në trajnime, projekte e konferenca të ndryshme shkencore dhe botojnë artikuj (<b>Evidenca 2.27, Evidenca 1.28</b>).</p> <p>Për realizimin e programit mësimor DKI shfrytëzon të gjithë burimet njerëzore, jo vetëm të departamentit të kimisë industriale por edhe ato të departamentit të kimisë dhe departamenteve të tjera të FSHN, si dhe të departamenteve përkatëse të vetë UT (përfshirë dhe personel të Institutit të Fizikës Bërthamore të Zbatuar).</p> <p>Konkretisht për realizimin e programit mësimor për PS Bachelor në “Kimi Industriale dhe Mjedisore” janë angazhuar gjatë viteve:</p> <p><b>2018-2019</b> janë për angazhuar 39 PAE dhe 16 PAK (<b>aneks ASCAL Tab 6.1</b>)</p> <p><b>2019-2020</b> janë për angazhuar 40 PAE dhe 13 PAK (<b>aneks ASCAL Tab 6.2</b>)</p> <p><b>2020-2021</b> janë për angazhuar 39 PAE dhe 17 PAK (<b>aneks ASCAL Tab 6.3</b>)</p> <p>Kjo gjë vihet re dhe gjatë shqyrtimit të tabelave 12 sipas ASCAL për ngarkesën e orëve në auditor për PS Bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore”.</p> <p>Për vitet e fundit kemi respektivisht këto raporte:</p> <p><b>Për 20-21:</b> 76.12% PAE dhe 23.8% PAK,</p> <p><b>Për 19-20:</b> 74.6% PAE dhe 25.4% PAK,</p> <p><b>Për 18-19:</b> 75.6 % PAE dhe 24.4% PAK.</p> <p>Nuk ka të dhëna për vitin 2021-2022 dhe kjo mendohet me qenë se RVB është dorëzuar pa u mbyllur viti akademik.</p> <p>Raporti midis orëve të zhvilluara nga PAE dhe PAK janë brenda kërkesave të ligjit (Jo më pak se 70 % nga PAE; <i>VKM 41. dt. 24.01.2018</i>)</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Referuar jetëshkrimeve të personelit akademik dhe lëndëve që ata mbulojnë në këtë program studimi GVJ konstaton se niveli i kualifikimit dhe fusha ekspertizës së stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi përputhet me lëndët që ata mbulojnë. Titujt akademikë janë përmendur në Kriterin 2. Fakulteti i Shkencave të Natyrës ka kushtuar rëndësi të veçantë cilësisë së personelit akademik dhe ndihmës akademik, duke garantuar shërbimi cilësor bashkëkohor ndaj studentëve.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e</p>	<p>Dekanati i FSHN (<b>Evidenca 1.33</b>) ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me disa kompani që ushtrojnë aktivitete brenda fushës që mbulon Departamenti i Kimisë Industriale, si për shembull Integrated Energy (Zona e Trajtimit të Mbetjeve, Sharrë), Kantina e Pijeve “Gjergj</p>



<p>kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Kastrioti”, Lufra, Fabrika Stela etj. Për periudhën 2019-20023 UT ka nënshkruar 42 marrëveshje, në kuadër të programit Erasmus+KA107, të listuara në faqen zyrtare të Universitetit të Tiranës. Nëpërmjet këtyre marrëveshjeve UT ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me 100 universitete homologe jashtë vendit (<a href="https://unitir.edu.al/arkiva-marreveshjet-erasmus-ka107-te-nenshkruara-nga-universiteti-i-tiranes/Programi_i_studimit_Bachelor_“Kimi_Industriale_dhe_Mjedisore”_nuk_e_ka_përfshirë_praktikën_e_detyruar_profesionale_në_studimet_3_vjeçare.">https://unitir.edu.al/arkiva-marreveshjet-erasmus-ka107-te-nenshkruara-nga-universiteti-i-tiranes/Programi_i_studimit_Bachelor_“Kimi_Industriale_dhe_Mjedisore”_nuk_e_ka_përfshirë_praktikën_e_detyruar_profesionale_në_studimet_3_vjeçare.</a> Sygjerimet për internshipe mbeten në fokus pasi studentët edhe nga takimet me ta e shprehin këtë magësi.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjedisve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Personeli ndihmës akademik i angazhuar është i specializuar në fushën përkatëse dhe me përvojë. Personeli ndihmës akademik me karakter mësimor (laborante, teknike) ndihmon në realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive të mësimdhënies dhe/ ose të kërkimit shkencor. Pranë departamentit ka 6 personel ndihmës akademik, 5 janë ndihmës akademik mësimor dhe 1 ndihmës akademik administrativ. Gjithashtu, në mbështetje të programit të studimit angazhohet edhe personeli ndihmës akademik i departamenteve të tjera të disiplinave të formimit bazë në programin e studimit (<b>Evidenca 1.18</b>).</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>		<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>
---	------------------------------	-------------------------------------	------------------------------------	---



### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.</p>	<p>Nga takimet me drejtuesit e FSHN pohohet se Universiteti i Tiranës, ka të miratuar udhëzuesin për përdorimin e sistemit të mësimin në distancë (<b>Evidenca 3.3</b>). Ky sistem sipas intervistave dhe takimeve me stafin e departamentit është përdorur gjatë viteve të pandemisë 2019-2021, në mbështetje të mësimdhënies për të gjitha lëndët e programit Bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore”. Ata pohojnë se udhëzuesi ka mundësuar përdorimin e një sistemi dixhital të avancuar, si një metodë inovative e mësimdhënies. Në dokumentat e dorëzuara rezultojnë se ky Udhëzues është i shoqëruar nga rregullorja e posaçme e UT mbi mënyrën e zhvillimit të provimeve “online” (<b>Evidenca 3.4</b>) si dhe nga udhëzuesi për përdorimin e platformës dixhitale (<b>Evidenca 3.5</b>).</p> <p>Nga vizitat në mjediset e FSHN u pa se pranë Departamentit të Kimisë Industriale është ngritur Laboratori i Inxhinierisë së Proceseve Kimike (Godina A, kati I, salla 113A) në kuadër të “Projekteve të Infrastruktursë së Kërkimit Shkencor në kuadër të Paktit për Universitetin”, Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, e miratuar më Qershor 2019. (<b>Evidenca 1.13, Evidenca 2.27</b>), kjo është edhe në mbështetje të metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>Përmirësimi i cilësisë të mësimdhënies nëpërmjet kualifikimit të vazhdueshëm të burimeve njerëzore (<b>Evidenca 1.2</b>), duket të jetë në fokus të strukturave përgjegjëse në UT dhe FSHN. Gjithashtu, në nivel Fakulteti nga Dekanati dhe Komisioni i Përherëshëm i Sigurimit të Standardeve të Cilësisë pranë UT (KPSSC), (<b>Evidenca 1.1</b>), kryhet monitorimi për mësimdhënien në bashkëpunim me njësitë e sigurimit të brendshëm të cilësisë në nivel njësie kryesore (<b>Evidenca 1.1</b>). Sa më sipër duke u mbështetur në udhëzimet përkatëse të ASCAL (<b>Evidenca 1.1</b>), kryet edhe vlerësimi i brendshëm.</p> <p>Nga dokumentacioni në dispozicion vërehet se vlerësimi i cilësisë të veprimtarisë mësimore zhvillohet nëpërmjet mekanizmave të ndryshme si: Pyetësorët e studentëve (<b>Evidenca 3.9</b>), Kontrollat e vazhdueshme nga Dekanati (<b>Evidenca 3.10</b>) dhe Vlerësimi nga përgjegjësi i departamentit (<b>Evidenca 3.11</b>).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimin të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Nga dokumentacioni në dispozicion dhe nga intervistat e studentëve pohohet se: vlerësimi periodik i formave të mësimdhënies dhe vlerësimi i dijeve nga ana e studentëve tregohet në statutin e Universitetit të Tiranës (<b>Evidenca 1.1, Evidenca 3.6</b>) dhe rregulloren e programit të studimit Bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore” (<b>Evidenca 1.6</b>). Zhvillimi dhe cilësia e mësimdhënies çdo vit akademik vlerësohet me anën e pyetësorëve për studentët (në fund të semestrit), të cilët realizohen për çdo lëndë të programit të studimit nga Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës, pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës (<b>Evidenca 1.1, Evidenca 1.15</b>). Rezultatet e anketimeve</p>



	përpunohen nga Zëvendës Dekani për mësimdhënien dhe hartohen raportet e vlerësimeve, të cilat përdoren, si burim për vlerësimin e jashtëm dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor ( <b>Evidenca 6.10, Evidenca 6.11, Evidenca 6.12, Evidenca 6.13, Evidenca 6.14, Evidenca 6.15, Evidenca 6.16</b> ).			
<b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Nga kontrolli i dokumentacionit në dispozicion konkretisht ( <b>Evidenca 3.9, Evidenca 6.8</b> ), rezulton se; Struktura përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK), në FSHN, në respektim të ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012 për mbrojtjen e të dhënave personale, publikon në mënyrë periodike, rezultatet e vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi .			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.	Bashkëpunimet dhe shkëmbimi i eksperiencave, sidomos në programet e mobilitetit Erasmus+ për trajnime në mësimdhënie ( <b>Evidenca 2.27</b> ), është një indikator që stafi akademik e argumenton në rastin e për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies. FSHN për këtë kriter na jep rastin e promovimit të praktikave të mira nga përfshirja në projektin NETCHEM, nëpërmjet së cilit stafi akademik është trajnuar në mënyrë të vazhdueshme për metodat inovative të mësimdhënies në përputhje me profilin e programit të studimit.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.2</b>	
<b>Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Nga takimet me personelin akademik të PS na rezulton se format kryesore të mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit të detajuara në programin e lëndëve të programit të studimit bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore” ( <b>Evidenca 1.7, Evidenca 1.8.1</b> ). Forma të tjera të mësimdhënies me qëllim promovimin e stafit të ri akademik si dhe të stafit me përvojë janë orët e hapura. Ato janë të organizuara edhe me profesorë të mirënjohur të fushës që mbajnë leksione dhe bashkëbisedime mbi tema të ndryshme në interes të formimit profesional të studentëve, si specialistë të ardhshëm ( <b>Evidencë 1.36</b> ).
<b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t’u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies,	Nga takimet me personelin akademik evidentohet përfshirja e një numri të konsiderueshëm të lëndëve e moduleve në planin mësimor, kjo tregon diversitetin e formave të ndryshme të mësimdhënies dhe mësimnxënies; të gjitha lëndët e modulet përfshijnë leksione, seminare, ushtrime, laboratorë, detyra dhe projekte kursi. Personeli akademik përshtatet dhe i përgjigjet plotësisht nevojave të studentëve, bazuar në prurjet periodike të çdo viti dhe prirjet individuale



<p>në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p>	<p>të tyre. PS siguron një raport të drejtë mes formimit teorik dhe formimit praktik (<b>Evidenca 1.6, Evidenca 1.7</b>). Evidentohet se një pjesë e veprimtarive formuese realizohet nën asistencën e pedagogut, siç janë ushtrimet apo laboratorët, ndërsa një pjesë tjetër zhvillohen, si punime të pavarura të studentit nën konsulencën e pedagogut, siç janë detyrat, projekte. Për këto aktivitete formuese studenti arrin të sigurojë sipas performancës deri në 30% të vlerësimit total.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxëniet, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Në politikat e FSHN duket qartë mbështetja e stafin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe jo vetëm. Në RVB pohohet se: Në nivel insitucional, Universiteti i Tiranës ka hartuar Udhëzuesin për Programin “UT-Kërkim, Ekselencë dhe Inovacion, ku përcaktohen objektivat e zhvillimit të kërkimit shkencor, teknologjisë dhe inovacionit (<b>Evidenca 3.1, Evidenca 3.1.1</b>).</p> <p>Nga takimi me Dekanin e FSHN evidentohet me fakte mbështetja e stafit të ri pedagogjik. Në fokus shihen mobilitetet e stafit akademik për qëllime specializimi për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies, në kuadër të marrveshjeve me institucione arsimore, qendra kërkimi jashë vendit dhe ri-integrimi i tyre në rradhët e personelit akademik është një formë për rritjen e kapaciteteve akademike dhe nivelit të profesionalizmit (<b>Evidenca 1.33, Evidenca 2.27</b>).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Nga takimet me personelin akademik të Departamentit të Kimisë Industriale, pjesë e programit të studimit Bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore”, nga CV e tyre vihet re një kopetencë dhe profesionalizëm në disiplinat që ata mbulojnë.</p> <p>Personeli akademik (<b>Evidencat 1.17, Evidenca 1.16</b>) dhe ndihmës akademik i përfshirë (<b>Evidenca 1.18</b>) në mësimdhënie është i specializuar, sipas lëndëve ku japin mësim.</p> <p>Leksionet, seminarët dhe diskutimi interaktiv përbëjnë pjesën kryesore të metodave teorike të mësimdhënies. Po kështu laboratorët janë një element i rëndësishëm dhe shumë atraktiv siç e pohojnë edhe vetë studentët (<b>Evidenca 2.3</b>).</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Përfshirja e studentëve, bisedat për metodat e mësimdhënies dhe përmirësimin e kurrikulës është parë së pari nga personeli akademik si kërkesë ligjore; në bazë të Ligjit të Arsimit të Lartë dhe Statutit të Universitetit të Tiranës (<b>Evidenca 1.1</b>).</p> <p>Nga ana administrative, senati akademik i UT miraton Komisionin e Përhershëm të Kurrikulës, ku në përbërjen e tij për përmirësimin e kurrikulës përfshihen edhe studentë nga njësitë kryesore të UT (<b>Evidenca 3.8</b>).</p> <p>Por krahas kësaj vlerësohet nga ana e dekanatit dhe e njëjësive bazë si formë e përmirësimit të metodave të mësimdhënies dhe të elementëve të procesit mësimor, procesi i anketimeve. Studentët përfshihen në këtë proces duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre, nëpërmjet plotësimit të pyetsorëve, në fund të çdo semestri për lëndët. Institucioni vlerëson dhe përpiqet të adresojë kërkesat dhe sugjerimet e studentëve për rritjen e cilësisë së mësimdhënies (<b>Evidencat 1.1, Evidenca 1.5, Evidenca 1.6</b>).</p>



	Siç edhe theksohet në RVB: Rezultatet e anketimit përfshihen në Raportin Vjetor të Fakultetit të Shkencave të Natyrës, dhe diskutohet për përmirësimet e mundëshme ( <b>Evidenca 1.28, Evidenca 6.10, Evidenca 6.11, Evidenca 6.12, Evidenca 6.13, Evidenca 6.14, Evidenca 6.15, Evidenca 6.16</b> ).			
<b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.	Vetë drejtuesit e FSHN (dekani) jep përvojat dhe rastet kur suporton personelin akademik jo vetëm për rritjen e kualifikimeve të tyre nëpërmjet trajnimeve por edhe shkëmbimeve të përvojave të mësimit me metoda interaktive duke aplikuar eksperiencat bashkëkohore të mësimit brenda dhe jashtë vendit ( <b>Evidenca 2.27</b> ). Personeli akademik dhe studentët e programit Bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore” pohojnë se një rëndësi të veçantë kanë orët e leksioneve dhe seminareve të kombinuara me orët e seancave laboratorike ( <b>Evidenca 1.7</b> ). Kjo e bën më të kuptueshme teorinë dhe ju zhvillon aftësitë praktike.			
<b>Kriteri 7.</b> Format dhe metodat e mësimit inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësuesit dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Studentët e PS Bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore” pohojnë se ata i parapëlqejnë metodat interaktive të mësimit, ku ata aktivizohen duke shprehur idetë dhe mendimet e tyre. Nga personeli akademik kjo supozohet që inkurajojnë sensin e autonomisë së veprimit tek studentit dhe ndikon në përfshirjen e më shumë studentëve në kërkimet shkencore dhe në vendimarrje ( <b>Evidenca 1.29</b> ). Vetë personeli akademik jep shembuj pozitivë në rastet kur kombinohen metodat tradicionale dhe ato bashkëkohore, me qëllim interaktivitetin dhe bashkëveprimin me studentët.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Niveli i përmbushjes</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi III.3</b>	
Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimit, mësuesit dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	Sipas dokumentacionit në dispozicion na rezulton se: Departamenti i Kimisë Industriale disponon mjedise laboratorike dhe mjedise pune (zyra) me sipërfaqe totale 630 m <sup>2</sup> , nga të cilat mjedise laboratorike janë 349 m <sup>2</sup> ( <b>Evidenca 1.13</b> ). Gjithashtu, për realizimin e programit mësimor Bachelor Kimi Industriale dhe Mjedisore janë disponibël edhe mjediset laboratorike të Departamentit të Fizikës, të Kimisë, Kimisë Fizike, 2 laboratorë të Kimisë Industriale 1 dhe 2 dhe Kontrollit dhe parandalimit të ndotjes në industrinë kimikë dhe nje zyrë/ klasë të pajisur me 24 kompjutera (për realizimin e lëndës Procese dhe Impiante të Inxhinierise Kimike) ( <b>Evidenca 1.13.1</b> ). Në nivel fakulteti, bazuar në numrin aktual të studentëve ( <b>Evidenca 1.28</b> ) në të gjitha vitet dhe sipërfaqen e përgjithshme të Fakulteti i Shkencave të Natyrës, rezulton se janë në dispozicion 5.3 m <sup>2</sup> /student. ( <b>Evidenca 1.21.1</b> ). Standardi i vendosur në VKM Nr. 418, datë 10.5.2017 është 1 student/2.5 m <sup>2</sup> . Këto normativa plotësohen edhe në bashkërendim



	<p>me ambientet e programeve të tjera të studimit apo edhe fakulteteve të tjera. Sallat e leksioneve, seminareve dhe ambienteve laboratorike janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht nga personeli sanitar i Degës të Shërbimeve (<b>Evidenca 1.15</b>). Nga vizitat në terren u pa një mirëmbajtje shumë e mirë e mjediseve. Kjo realizohej nga stafi i shërbimeve në Fakultetin e Shkencave të Natyrës (<b>Evidenca 2.35</b>). <i>Nga procesi i anketimit ka rezultuar se studentët e kanë në fokus përmirësimin e hapësirave.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.</p>	<p>Nga dokumentacionet në dispozicion na rezulton se mjediset (<b>Evidenca 2.28</b>) në të cilat zhvillohet procesi mësimor (sallat e leksioneve dhe seminareve) janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor. Nga RVB: Sallat e leksioneve dhe seminareve kanë një kapacitet që varion nga 48 në 150 vende për studentë. Po kështu mjediset laboratorike kanë hapësira rreth 15-16 poste studenti. Nga vizitat në mjediset e departamentit rezulton se sallat e leksioneve dhe seminareve janë të pajisura me tavolina dhe karrige me kapacitet në përputhje me numrin e studentëve që nga viti i parë deri viti i tretë, dërrasë të zezë, dërrasë e bardhë me shkumësa ose lapustil, priza elektrike për përdorimin të laptopit dhe videoprojektorit, perde videoprojektimi, etj.</p> <p>PS ka në dispozicion rreth 24 mjedise laboratorike (sipërfaqe totale 1184.8 m<sup>2</sup>) të pozicionuara kryesisht në godinën A, me një sipërfaqe 1084.2m<sup>2</sup>, në godinën B, me sipërfaqe 50.6 m<sup>2</sup> dhe godinën C me sipërfaqe 50m<sup>2</sup>. (<b>Evidenca 1.13.2</b>). Në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, organizohet me detaje realizimi i programit sipas moduleve. Pajisja e laboratorëve ka një ndërthurje midis pajisjeve të vjetra bazale të teknologjive të cilat janë në gjendje funksionale, sipas specifikës së secilit laborator, po kështu vihet re që ka edhe shumë pajisje të reja të blera në kuadrin e projekteve të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare (<b>Evidenca 1.13, Evidenca 1.13.1</b>).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.</p>	<p>Nga dokumentacioni në dispozicion si edhe nga takimet me personelin akademik, ndihmës akademik, administrativ, studentë dhe të gjithë bashkëpunëtorëve të Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe Universitetit të Tiranës, për realizimin e procesit mësimor, shfrytëzojnë infrastrukturën e konsoliduar të IT-së (<b>Evidenca 3.18, Evidenca 3.19, Evidenca 1.15</b>). Microsoft Teams është sistemi i përdorur nga stafi akademik dhe studentët e FSHN gjatë periudhës së zhvillimit të mësimi "online" dhe vazhdon të përdoret (<b>Evidenca 3.3, Evidenca 3.4, Evidenca 3.5</b>).</p> <p>Nga vizitat në mjediset e departamentit dhe pohimet e personelit akademik rezulton që ai është i pajisur me kompjutera dhe printera të cilat janë të lidhura me internetin. (<b>Evidenca 1.13.1</b>). Personeli akademik, ndihmës akademik dhe studentët janë të pajisur me adresa email-i në nivel fakulteti dhe universiteti, me anë të cilëve komunikojnë me njëri-tjetrin (<b>Evidenca 3.20</b>).</p> <p><i>U vu re se në disa raste personeli akademik përdor adresat private të emailit të cilat i ka të vendosura edhe në dokumentacionin e dorëzuar si CV, syllabuse, etj.</i></p> <p>Duke parë se kjo nuk është në masë dhe meqë pedagogët përkatës nuk janë pjesë e Departamentit të Kimisë Industriale, <b>GVJ merr</b></p>



	<p><b>parasysh komentet dhe ndryshon vlerësimin e “Përmbushet kryesisht” në “Përmbushet plotësisht”.</b></p> <p>FSHN ka personelin më të kualifikuar për Teknologjinë e Informacionit (<b>Evidenca 1.1, Evidenca 1.15</b>).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Sipas RVB për të gjitha programet e lëndëve (syllabuset), përmbajnë informacionin e nevojshëm në lidhje me literaturën e detyruar, leksione të shkruara dhe literaturë të rekomanduar (<b>Evidenca 1.8.1, Evidenca 3.21</b>).</p> <p>Nga takimet me stafin pohohet se: literatura përfshin materiale të botuara apo dispenca të përgatitura, si edhe tekste ose leksione të shkruara nga secili pedagog përgjegjës.</p> <p><i>GVJ rithekson përditësimin e literaturës në përdorim, recensimin e saj në mënyrë të rregull dhe të paanshëm, përfshirë këtu edhe Leksionet e shkruara në përdorim.</i></p> <p>GVJ nga vizita në Librarianë e FSHN vëren se aty ka një larmi publikimesh që shërbejnë dhe plotësojnë nevojat bazë për tekstet e domosdoshëm mësimorë të botuara nga shtëpi botuese në vend.</p> <p>Në RVB theksohet se: Universiteti i Tiranës u ofron studentëve bibliotekën “Online”, <a href="https://unitir.edu.al/biblioteka-online/">https://unitir.edu.al/biblioteka-online/</a>. Ndërsa, faja web e FSHN ofron burimet “Online”: JSTOR, EDGAR, IOP, ASTM, MSP, si dhe librarinë Cobiss.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>GVJ bëri vizitën monitoruese në godinën B, në katin e parë dhe atë përdhes ku gjendet Biblioteka e FSHN. Kjo bibliotekë ka në dispozicion 2 salla studimi (Salla Fond i hapur i librit dhe Salla Fond i hapur i Periodikut); mjedis shërbimi i Fondit Kryesor; me një sipërfaqe të përgjithshme prej 678.75m<sup>2</sup>, 140 vende studimi dhe kompjutera për studentët dhe personelin (<b>Evidenca 1.28</b>).</p> <p>Stafi akademik, ndihmës akademik dhe studentët shrytëzojnë Bibliotekën Shkencore të Fakulteti i Shkencave të Natyrës. Biblioteka e Fakulteti i Shkencave të Natyrës, është ndër më të mëdhatë dhe më të rëndësishmet në Universitetin e Tiranës për nga madhësia e fondit dhe shumëllojshmëria e literaturës, numrit të përdoruesve dhe vendeve të studimit, cilësisë dhe llojeve të shërbimit (<b>Evidenca 1.28</b>).</p> <p>Në RVB theksohet se: Fondi i ofruar është i përbërë nga 80018 tituj. Prej tyre 36600 njësi janë libra e monografi shkencore (1158 në shqip, 35443 në gjuhë të huaj), 896 njësi disertacione (858 në shqip, 38 në gjuhë të huaj) dhe 24451 njësi revista e periodikë shkencorë (64 shqip dhe 24387 në gjuhë të huaj) (<b>Evidenca 1.28</b>).</p> <p>Biblioteka e Fakultetit të Shkencave të Natyrës ka dixhitalizuar katalogun bibliografik të bibliotekës dhe arkivit nëpërmjet softit Cobiss. Në bibliotekë janë angazhuar 4 punonjës, 3 staf të angazhuar në sigurimin e mbarëvajtjes së funksionimit të bibliotekës dhe 1 staf i Buletinit të Fakultetit të Shkencave të Natyrës.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mesimdhënis dhe mesimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të</p>	<p>Stafi akademik pohon se shfrytëzon libraritë on-line (<b>Evidenca 2.25</b>), për të qënë sa më “up date” me literaturën bashkëkohore. Studentët e FSHN/DKI nëpërmjet teknologjisë, mund të shkarkojnë materiale të ndryshme shkencore.</p> <p>Nga vizita e GVJ në IAL dhe nga takimi me punonjësit, konstatojmë që Biblioteka Shkencore e FSHN disponon koleksion periodikësh shkencorë</p>



<p>përafërta me programin e studimit.</p>	<p>në fusha të ndryshme, në shqip dhe në gjuhë të huaj, një pjesë e të cilëve janë siguruar përmes abonimit vjetor.</p> <p>Nga shqyrtimi i <b>evidences 3.19</b> vlerësojmë se Fakulteti i Shkencave të Natyrës është i regjistruar në 3 burime “online” të Konsorciumin Ndërkombëtar EIFL. Faqja web e FSHN ofron burimet “Online”: JSTOR, EDGAR, IOP, ASTM, MSP, si dhe librarinë Cobiss.</p> <p>Nëpërmjet rrjetit akademik shqiptar (RASH) dhe adresa email-i zyrtar, studentët dhe personeli akademik kanë akses për kërkimin dhe shkarkimin e literaturave të huaja dhe shqiptare në faqen <a href="https://ulibrary.rash.al/e">https://ulibrary.rash.al/e</a> (<b>Evidenca 3.22</b>).</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Në RVB theksohet se: Natyra specifike e PS Bachelor në “Kimi Industriale dhe Mjedisore” kërkon që orët laboratorike të zënë një peshë të konsiderueshme në Planin Mësimor të programin e studimit. Kjo reflektohet dhe në Planin Mësimor të PS të paraqitur në <b>evidencën 1.7</b>. Nga shqyrtimi i <b>evidencës 1.13.2</b> konstatohet që PS Bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore” shfrytëzon 24 mjedise laboratorike (me sipërfaqe totale 1184.8m<sup>2</sup>) të pozicionuara kryesisht në godinën A, por dhe në godinat B dhe C dhe që janë në varësi dhe të Departamenteve të tjera të FSHN.</p> <p>GVJ vizitoi këto mjedise dhe vëren që organizimi dhe ndarja e këtyre mjedisve është realizuar në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën e programit të studimit dhe moduleve përkatëse. Laboratorët janë pajisur me pajisje, në varësi të specifikave përkatëse (<b>Evidenca 1.13.1, Evidenca 1.13.2</b>).</p> <p>Në varësi të DKI janë 9 laboratore (unike pjesa e madhe e tyre) ku realizohen lëndët e karakterit profesional inxhinierik dhe teknologjik, si dhe ambiente të tjera pune me sipërfaqe totale 630m<sup>2</sup> (pjesën më të madhe e zënë labororet) (<b>Evidenca 1.13.1</b>). Për vetë natyrat specifike të laboratoreve DKI ka hartuar rregullore të posaçme të punës në to (<b>Evidenca 2.3, Evidenca 1.6</b>). Laboratorët që shfrytëzohen për realizimin e programit të studimit jashtë departamentit janë laboratore në varësi të departamentit të kimisë dhe ato të departamentit të fizikës:</p> <p>Sipas <b>evidencës 2.6</b> vlerësojmë që DKI ka 6 personel ndihmës-akademik me kohë të plotë të cilët mirëmbajnë pajisjet laboratorike, asistojnë pedagogun gjatë seancave laboratorike dhe janë në dispozicion të studentëve për realizimin e orëve laboratorike dhe temave të diplomave.</p> <p>Përveç ambienteve të laboratorëve, në dispozicion të studentëve janë edhe ambientet e bibliotekës (Godina B), si dhe akses i wi-fi free, të cilat përdoren gjerësisht prej studentëve për studim, punim dhe detyrave të kursit, temës së diplomës apo studimeve specifike.</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Në takimin që pati GVJ me stafin e DKI dhe me studentët e PS Bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore” ata pranuan që në kushtet e zhvillimit të mësimin “online”, komunikimi midis studentëve dhe personelit akademik është realizuar nëpërmjet platformës dixhitale Microsoft Team <a href="https://unitir.edu.al/?s=teams">https://unitir.edu.al/?s=teams</a>.</p> <p>Stafi i IT të Universitetit të Tiranës ka mundur dhe garantuar aksesin për personelin akademik dhe studentët, duke vënë në dispozicion të tyre manual të përdorimit të sistemit Microsoft Teams. Në <b>evidencën 3.23</b> eidentohet se personeli akademik dhe studentët e kanë përdorur komunikimin</p>



	elektronik duke krijuar mundësinë e kontaktimit të shpejtë si dhe lehtësuar aksesin e materialeve didaktike.		
<b>Kriteri 9.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.	Në UT/ FSHN gjithë personeli akademik, ndihmës akademik dhe studentët janë të pajisur me adresa email-i të dedikuar në nivel universiteti <a href="mailto:emer.mbiemer@unitir.edu.al">emer.mbiemer@unitir.edu.al</a> si dhe në nivel fakulteti <a href="mailto:emer.mbiemer@fshn.edu.al">emer.mbiemer@fshn.edu.al</a> . Komunikimi i brendshëm midis personelit akademik, si dhe ndërmjet personelit akademik dhe studentëve realizohet me anë të platformës dixhitale Microsoft Teams dhe nëpërmjet adresave zyrtare të email-it FSHN/ UT ( <b>Evidenca 3.20</b> ).		
<b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	<i>GVJ pasi shqyrtoi dokumentacionin e vënë në dispozicion (Evidenca 1.5, Evidenca 1.8.3) konkludoi që në programin e studimit të ciklit të parë Bachelor "Kimi Industriale dhe Mjedisore", përfundimi i studimeve realizohet nëpërmjet provimit të formimit.</i> Programi i provimit të formimit është gjithëpërfshirës, me tematika nga fushat kryesore, që mbulon programi i studimit ( <b>Evidenca 1.8.5, Evidenca 1.8.4</b> ), hartohet nga personeli akademik i njësisë bazë dhe miratohet nga Përgjegjësi i Departamentit dhe Dekani i Fakultetit ( <b>Evidenca 1.6</b> ). Ky program u vihet paraprakisht në dispozicion studentëve dhe në fund të semestrit të gjashtë organizohet dhe një javë konsultimi.		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

<b>Standardi III.4</b>	
<b>Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/ bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	Duke ju referuar strategjisë së zhvillimit të UT, shihet që organizimi i strukturave në nivel institucional synon përmirësimin e cilësisë të mësimdhënies dhe përvetësimit të ( <b>Evidenca 1.2</b> ). Në nivel institucional është ngritur dhe vepron Komisioni i Përhershëm për Sigurimin të Standardeve të Cilësisë (KPSSC). ( <b>Evidenca 1.1, Evidenca 3.6</b> ), i cili bashkëpunon dhe bashkërendon punën me njësitë e sigurimit të brendshëm të cilësisë në nivel njësie kryesore ( <b>Evidenca 1.1</b> ) dhe ofron ekspertizë në lidhje me proceset e sigurimit të cilësisë. Njësia/ Komisioni garanton monitorimin periodik të performancës të personelit akademik dhe aftësive të mësimdhënies së tij. Struktura ka në përbërjen e saj, 6 pedagogë (nga një përfaqësues të çdo njësie bazë të UT), një përfaqësues të Rektoratit (Struktura e Sigurimit të Cilësisë në Rektorat) dhe 3 studentë. ( <b>Evidenca 3.6, Evidenca 3.7</b> ). UT ka krijuar Sektorin e Sigurimit të Cilësisë ( <b>Evidenca 3.7</b> ) struktura ndihmës akademike që punon për zbatimin e politikave mbi cilësinë dhe që mbështet me veprimtarinë e saj KPSSC dhe NJSBC në njësitë kryesore. FSHN ka krijuar Degën e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK) ( <b>Evidenca 6.5</b> ), e cila bashkërendon veprimtarinë e vet me KPSSC-në. Me vendim të Senatit Akademik të UT ( <b>Evidenca 6.17</b> ),



	<p>është miratuar manuali i vlerësimit të performancës së personelit akademik (<b>Evidenca 6.18</b>). Universiteti i Tiranës ka adoptuar dhe zbaton një paketë aktesh për sigurimin e cilësisë (<b>Evidenca 6.1, Evidenca 6.2, Evidenca 6.3, Evidenca 6.4</b>).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/ bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>UT/ FSHN/ DKI janë përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe ndërgjegjësimin e personelit akademik dhe studentëve për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p> <p>Personelit akademik angazhohet në raportimet vjetore të analizës mësimore të Departamenteve (<b>Evidenca 3.12</b>) dhe FSHN (<b>Evidenca 1.28, Evidenca 6.10, Evidenca 6.11, Evidenca 6.13, Evidenca 6.14, Evidenca 6.15, Evidenca 6.16</b>); në rritjen e kualifikimit akademik të stafit (<b>Evidenca 3.12</b>); në trajnime periodike (<b>Evidenca 2.27</b>); merr pjesë aktive në mbledhjet periodike të departamentit (<b>Evidenca 3.24</b>) dhe në hartimin e kërkesave buxhetore (pajisje, reagentë, materiale për laboratorët). (<b>Evidenca 1.26</b>). Studentët janë në fokus të Strategjisë së Zhvillimit të UT. Opinioni i tyre si një burim shumë i rëndësishëm informacioni për rritjen e cilësisë të programeve mësimore, merret nëpërmjet: Pjesëmarrjes së studentëve në procesin e anketimit për çdo lëndë, çdo fund semestri (<b>Evidenca 1.1, Evidenca 6.10, Evidenca 6.11, Evidenca 6.12, Evidenca 6.13, Evidenca 6.15, Evidenca 6.16</b>), të organizuara nga DSBCK pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës (<b>Evidenca 1.1, Evidenca 1.15</b>). Pjesëmarrjen e studentëve në KPSSC (<b>Evidenca 3.7</b>). Në Statutin e UT (<b>Evidenca 1.1 dhe Evidenca 3.6</b>) dhe rregulloren e programit të studimit Bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore” (<b>Evidenca 1.6</b>) vlerësohet rëndësia e opinioneve të studentëve për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit akademik nëpërmjet vlerësimi periodik i formave të mësimdhënies. Në rregulloren e UT dhe rregulloren e PS (<b>Evidencat 1.5, Evidenca 1.6</b>) garantohet e drejta e studentit për ankimimin e rezultatit të vlerësimit të dijes. Për të siguruar vlerësimin e brendshëm të programeve të studimit (<b>Evidenca 1.1</b>), janë ngritur grupe të vlerësimit të brendshëm (GVB) (i cili harton dhe raportin e vlerësimit të brendshëm për akreditim), pjesë e të cilëve janë personeli akademik dhe studentët. (<b>Evidenca 3.25</b>).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Siç theksohet edhe në RVB: UT/FSHN/DKI mbështet zhvillimin e metodave të reja në mësimdhënie, me ndihmën e teknologjisë. (<b>Evidenca 3.1, Evidenca 3.1.1</b>). Specialistët e IT në UT/ FSHN. (<b>Evidenca 3.5</b>), gjatë periudhës së pandemisë mundësuan realizimin e mësimin online duke garantuar aksesin për personelin akademik dhe studentët në platformën dixhitale Microsoft Teams.</p> <p>Në funksion të cilësisë të programit të studimit është miratuar <i>Ngritja Qendres Virtuale të Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit në Universitetin e Tiranës</i> (<b>Evidenca 3.14</b>).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Nga dokumentacioni në dispozicion shihet që: UT harton plane masash në lidhje me kërkimin shkencor për kualifikimin dhe promovimin e stafit akademik (<b>Evidenca 3.26, Evidenca 3.27, Evidenca 3.28</b>). DKI bashkëpunon me strukturat përkatëse në rektorat për të lehtësuar kërkimin shkencor dhe aplikimin në projekte institucionale apo ndër-univesitare brenda apo jashtë vendit. (<b>Evidenca 3.1, Evidenca 3.1.1</b>).</p>



	<p>Një formë e përpjekjeve të stafit të departamentit për rritjen e kualifikimit të tyre është mobiliteti i stafit akademik në kuadër të marrëveshjeve me institucione arsimore, qendra kërkimi jashtë vendit dhe ri-integrimi i tyre në rradhët e personelit akademik për rritjen e kapaciteteve akademike dhe nivelit të profesionalizmit. <b>(Evidencat 2.27, Evidenca 1.33)</b>. Kjo u evidentua dhe në takimet që pati GVJ me Stafin akademik që jep mësim në PS. Nga dokumentat dhe RVB del që: gjatë vitit akademik 2019-2020, 1 anëtar i personelit akademik u promovua me gradën shkencore Doktor i Shkencave. <b>(Evidenca 2.19)</b>.</p> <p>UT/ FSHN Natyrës nxiti promovimin akademik të stafit të tij dhe mbështet kërkimin shkencor edhe nëpërmjet mbështetjes financiare <b>(Evidenca 3.12)</b> për botime dhe pjesëmarrje në konferenca.</p> <p>FSHN i ofron stafit akademik, për të botuar rezultatet e punës kërkimore shkencore, revistën periodike Buletini i Shkencave Natyrore <b>(Evidenca 4.14)</b>. DKI dokumenton se ka patur bashkëpunime shkencore dhe institucionale, projekte etj. <b>(Evidenca 1.28)</b> si më poshtë:</p> <p>Në kuadër të programit Erasmus+, DKI është përfshirë në projektin NETCHEM (ICT Networking for Overcoming Technical and Social Barriers in Instrumental Analytical Chemistry education), në kuadër të të cilit janë realizuar disa workshop-e me pjesëmarrjen edhe të studentëve <b>(Evidenca 1.31)</b>. Projekt NanoAlb Ignite Projects 2020-2021 1st “Call for projects related to COVID-19 and other emergent nanotechnology applications areas”, University of Tirana, Polytechnic University of Tirana, University of Tetova. “Nanocoating of cement-based surface with antiviral properties/ Mikro-mbështellja e sipërfaqeve të bazuara në çimento me veti "antivirale", Financuar nga Akademia e Shkencave <b>(Evidenca 1.32)</b>.</p> <p>PHAREM (2019-2021), INTERREG IPA Cross CBC Greece-Albania: “Developing and application of a system based on advanced oxidation processes for the treatment of hospital wastewaters in order to remove pharmaceutical compounds with high persistence in aquatic environment” <b>(Evidenca 1.32)</b>.</p> <p>Projekt në kuadër të shkollës së doktoraturës me Universitetin e Hohenheim-Gjermani: “Tailoring of the chemical profile of volatile organic compound (VOC) in a combined drying/extraction process of Salvia officinalis L” <b>(Evidenca 1.32)</b>.</p> <p>Në funksion të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor personeli akademik i Departamentit të Kimisë Industriale angazhohet me kohë të pjesshme jashtë Universitetit të Tiranës duke mundësuar dhe bashkëveprimet me Universitete të tjera duke shkëmbyer njëkohësisht dhe përvoja të dyanshme. <b>(Evidenca 3.29, Evidenca 3.29.1, Evidenca 3.29.2)</b>.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Nga shqyrtimi i <b>evidencave 1.28; 2.27 dhe 3.12</b> evidentohet promovimi i stafit akademik si edhe kryerja e kualifikimeve të sistematike, duke krijuar vazhdimësi dhe qëndrueshmëri në cilësinë e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja. UT, ka nënshkruar marrëveshje të bashkëpunimi në kuadër të programeve si Erasmus+, etj., të cilat konsistojnë në: shkëmbimin e eksperiencës akademike; realizimin e projekteve të përbashkëta kërkimore/ zhvillimore; kualifikime të</p>



	<p>pedagogëve; mobilitetin e stafit dhe studentëve në kuadër të programeve Erasmus; realizimin e praktikave, leksioneve të hapura, aplikim për projekte të përbashkëta, aktivitete. Në bashkëpunim me koordinatorin akademik të Erasmus+ në FSHN, stafi akademik përfiton nga këto marrëveshje për mobilitete të ndryshme.</p> <p>Në faqet zyrtare të UT vërehet se për periudhën 2019-2023 UT ka nënshkruar 42 marrëveshje, në kuadër të programit Erasmus+KA107, nëpërmjet të cilave UT ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me 100 universitete homologe jashtë vendit.</p> <p>Gjatë vizitave në ambjentet e IAL, GVJ vizitoi dhe Laboratorin e Inxhinierisë së Proceseve Kimike të ngritur pranë Departamentit të Kimisë Industriale në kuadër të “Projekteve të Infrastrukturës së Kërkimit Shkencor në kuadër të Paktit për Universitetin”, Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, e miratuar më Qershor 2019, një laborator dinjitoz i pajisur me pajisje bashkëkohore, në shërbim të stafit dhe studentëve. <i>(Evidenca 1.13, Evidenca 2.27).</i></p>								
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>RVB thekson se: për realizimin e procesit mësimor shfrytëzohen të gjitha burimet njerëzore të DKI/FSHN/UT si dhe vihen në dispozicion mjediset e departamentit dhe fakultetit. Për zbatimin orarit mësimor <b>(Evidenca 2.21)</b> dhe zhvillimin e procesit mësimor angazhohet personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik (mësimor–shkencor) i programit të studimit Bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore”, i cili ka detyra të mire përcaktuara në përshkrimin e punës <b>(Evidenca 1.1, Evidenca 1.5, Evidenca 1.25)</b>. Personeli akademik është përgjegjës për përgatitjen dhe organizimin e programit të studimit <b>(Evidenca 1.6)</b>, përditësimin e syllabuseve dhe zbatimin e tyre dhe bashkëpunon me stafin ndihmës akademik për veprimtari të ndryshme, si realizimin e orëve laboratorike, temave të diplomave, etj.</p>								
<p><b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>Nga takimi i GVJ me stafin e DKI u cilësua se ndër vite janë bërë përmirësime në kurrikula duke pasuruar programin mësimor me tema të reja bashkëkohore, këto si rrjedhojë ndër të tjera dhe të aplikimit dhe testimin të metodave të reja të mësimdhënies.</p> <p>Gjatë dy vite akademike (2019-2020, 2020-2021) personeli akademik përdori me sukses metodat bashkëkohore në mësimdhënie duke përdorur teknologjinë e informacionit (mësimi “online”), si metodë inovative. <b>(Evidenca 3.3, Evidenca 3.4, Evidenca 3.5)</b>.</p> <p>Rezultatet dhe pritshmëritë e mësimin “online” u pasqyruan në analizën e pyetësorëve të studentëve 743 <b>(Evidenca 6.15)</b> të organizuar nga Dega e Sigurimit të Cilësisë në bashkëpunim me Dekanatin.</p> <p>Nga takimi i GVJ me studentët ata vlerësuan komunikimin e mirë me pedagogët si dhe arritjen e njohjes dhe me punët praktike nga realizimi nga ana e stafit ndihmës akademik i videove të punëve laboratorike dhe paraqitja e tyre për studentët në platformat online.</p>								
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="598 1787 767 1861">Përmbushet plotësisht</th> <th data-bbox="767 1787 991 1861">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="991 1787 1209 1861">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1209 1787 1434 1861">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="598 1861 767 1910"></td> <td data-bbox="767 1861 991 1910"></td> <td data-bbox="991 1861 1209 1910"></td> <td data-bbox="1209 1861 1434 1910">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						



<b>Standardi III.5</b>	
<b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Nga intervistat me studentët rezultojnë se ata njoftohen që në momentin e parë që prezantohen me lëndën dhe pedagogët përgjegjës mbi ngarkesën javore dhe semestrale të saj, numrin e krediteve, shpërndarjen e të gjithë elementëve të programit të studimit dhe me mënyrën e vlerësimit. Mënyra e vlerësimit dhe ndarjes së pikëve për vlerësimet e sipër përmendura janë të shprehura në syllabusin e çdo moduli (<b>Evidenca 1.8.1</b>). Gjithashtu, këto elemente të mënyrës dhe kriterëve të testimit dhe vlerësimit të njohurive pasqyrohen edhe tek planet mësimore të çdo viti akademik (<b>Evidenca 1.7</b>). Kontrolli i dijeve për çdo modul bëhet nëpërmjet formave të ndryshme, si vlerësimi të punimit dhe prezantimit të detyrave të kursit, punëve në grup, kolegiumeve, pjesëmarrjes dhe aktivizimit në seminar dhe laborator. Ky vlerësim i vazhduar gjatë vitit plotësohet me vlerësimin në provimin përfundimtar.</p> <p>Sa më sipër janë të specifikuar në Rregulloren e Universitetit të Tiranës (<b>Evidenca 1.5</b>), si dhe në faqen zyrtare të Fakultetit të Shkencave të Natyrës, në Rregulloren e Departamentit të Kimisë Industriale (<b>Evidenca 1.3</b>) dhe në Rregulloren e Programit të Ciklit të Parë të Studimit Bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore” (<b>Evidenca 1.6</b>).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/ modulit.</p>	<p>Studentët konfirmojnë se njoftohen në fillim të semestrit nga pedagogu i lëndës për strukturën e lëndës, në bazë të syllabusit, ku përfshihen emërtimi i lëndës, kreditet, emrin e pedagogut që zhvillon lëndën, viti, semestri, ngarkesa në orë në auditor, njohuri dhe aftësi që i jep lënda, temat që do të trajtohen gjatë modulit, mënyra e vlerësimit të studentëve, në rastet kur lënda është e ndarë me module (<b>Evidenca 1.8.1</b>), të cilat mbulohen nga disa anëtarë të personelit akademik, si dhe në mënyrë të detajuar mbi metodologjinë e testimit, mënyrën e grumbullimit të pikëve brenda modulit, dhe shumën e pikëve të të gjitha moduleve deri në marrjen e vlerësimit final.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Nga dokumentat në dispozicion dhe nga RVB rezultojnë që: testimi dhe vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të studentëve të programit Bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore”, për të treguar nivelin e njohurive të fituara kryhet me provim me shkrim ose shkrim dhe me gojë, sipas përshkrimit në Syllabusin përkatës dhe planet mësimore (<b>Evidenca 1.8.1, Evidenca 1.7</b>). Format e vlerësimit të vazhduar kryhen nëpërmjet kolegiumeve, ose me anë të detyrës së kursit që studenti e ka përgatitur nga punë të pavarur individuale me mbështetjen e pedagogut. Studentët pohojnë se provimet me shkrim janë zhvilluar në formën e pyetjeve me alternativa ose pyetjeve me shpjegime dhe shtjellime. Në modulet me ushtrime tezat përmbajnë ushtrime sipas modeleve të zhvilluara në seminare. Stafit akademik i PS pohon se tezat e provimit përfundimtar zakonisht riformulohen çdo vit, nga titullarët e lëndëve dhe firmosen nga përgjegjësi i departamentit (<b>Evidencat 1.8.3, Evidenca 1.8.5</b>).</p>



Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6 Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.	Në syllabysset e çdo moduli ( <b>Evidenca 1.8.1</b> ) të hartuara sipas VKM 41/2018, ( <b>Tabela 14 ASCAL</b> ) cilësohet që testimi i dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe mbyllet me vlerësimin përfundimtar të studentit. Intervali i përqindjes të vlerësimit mund të ndryshojë për secilin komponent të kontrollit/vlerësimit, sipas specifikave të programeve të lëndëve ( <b>Evidenca 1.8.1, Evidenca 3.31 Tabela 15 ASCAL</b> ). Në kurrikulën e PS Bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore” përmbahen dhe lëndë me vlerësim të vazhduar. Në këto lëndë studenti testohet 2-3 herë gjatë semestrit dhe secili testim vlerësohet 30-50% të vlerësimit total ( <b>Evidenca 3.30</b> ). Vlerësimi i dijeve bëhet me sistemin e pikëve nga 0-100 (0- 100%) dhe rezultati përfundimtar konvertohet në notë. ( <b>Evidenca 1.5 nenet 45-49, Evidenca 1.6 nenet 27-28</b> ). <i>Në takimet që pati GVJ me stafin e DKI u theksua se përqindja e vlerësimit të mund të ndryshojë për secilin komponent të kontrollit/ vlerësimit dhe tendencat janë në rritjen e peshës së vlerësimit sidomos për laboratorët. Këto reflektohen dhe në përmirësimet deri në 20% që u bëhen programeve.</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Gjatë viteve akademike 2019-2020 dhe 2020-2021, UT vuri në zbatim sistemin elektronik MS-Teams për testimin dhe vlerësimin e studentëve, për përdorimin e të cilit stafi i IT hartoi manual të përdorimit për stafin dhe studentët si dhe u përpilua dhe rregullorja e provimeve online ( <b>Evidenca 3.3, Evidenca 3.4, Evidenca 3.5</b> ). Ky sistem garanto shpejtësi informimi e transparencë duke eliminuar forma të ndryshme abuzimi.
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	Në Rregulloren e Programit të studimit Bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore”, cilësohet se titullari i lëndës është përgjegjës për hartimin e tezës, ( <b>Evidenca 1.6 neni 27.i</b> ) vlerësimin dhe notën përfundimtare të studentit. Testimi dhe vlerësimi përfundimtar i njohurive të fituara gjatë procesit mësimor realizohet nga komisioni me të paktën dy pedagogë i caktuar nga Zv. Dekani për mësimin, ku njëri prej anëtarëve është titullar i lëndës ( <b>Evidenca 1.5 neni 48 dhe Evidenca 1.6 neni 30</b> ). Numri i pedagogëve që angazhohen në monitorimin e provimeve është në varësi të numrit të studentëve dhe sallave të nevojshme për zhvillimin e provimeve. Në bazë të Rregullores së UT, ( <b>Evidenca 1.5</b> ), tezat e provimeve përditësohen çdo vit ( <b>Evidenca 3.32</b> ). Elementet e tezës së provimit janë: Dega ku zhvillohet provimi, Viti, Emri i lëndës, Emri i titullarit të lëndës + firma, Emri i Përgjegjës të Departamentit + firma. Çdo pyetje duhet të jetë e shoqëruar me numrin e pikëve.
<b>Kriteri 4.</b> Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime	Në Rregulloren e DKI, ( <b>Evidenca 1.3 neni 23.d</b> ) theksohet se provimet me shkrim zhvillohen në fletë të sekretuara (anonim). Kjo gjë u pranua dhe nga studentët që qenë në takim me GVJ gjatë vizitave në IAL. Përgjegjësi

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 40




<p>me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p>i departamentit ngarkon personelin ndihmës akademik për sekretimin e testeve para fillimit të provimit, të cilat zbardhen pas korigjimit të testeve. Në kushtet e pandemisë, (<b>Evidenca 3.4</b>), gjatë viteve akademike 2019-2020 dhe 2020-2021 u aplikua testimi “online”, për të cilën UT hartoi rregulloren e posaçme dhe procesi rezultoi i lehtë në përdorim dhe në vlerësimin e studentëve duke garantuar njëkohësisht dhe transparencë (<b>Evidenca 3.2</b>).</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënimit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Nga takimi që grupi i GVJ pati me studentë të PS Bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore”, studentët u prononcuan se ata njihen pas vlerësimit të provimit, me pikët e çdo pyetje të tezës dhe në fund me pikët totale të vlerësimit si dhe me shënimet e bëra nga komisioni për çdo vlerësim. Këto të drejta të studentit janë të sanksionuara në Rregulloren e PS (<b>Evidenca 1.6 neni 30</b>). Rishikimi i vlerësimit të provimit është një e drejtë e studentit e cilësuar në rregulloren e UT dhe në rregulloren e Programit të studimit KIM (<b>Evidenca 1.5 neni 51, evidence 1.6 neni 32</b>). Sipas këtyre neneve studentët kanë të drejtë që pas shpalljes së rezultateve të provimeve, brenda 48 orëve mund të paraqitet para komisionit për të parë tezën dhe të sqarohet në lidhje me pikët, si dhe përgjigjet e sakta. Studentët e pranishëm në takimin me GVJ pranuan që e kishin ushtruar këtë të drejtë dhe kishin marrë zgjidhje.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.</p>	<p>Në Rregulloret e UT/DK/PS “Kimi Industriale dhe Mjedisore”, rregullorja e diplomimit dhe programi i provimit parashikohen rregullat për zhvillimin e provimit (<b>Evidenca 1.5; 1.3; 1.6; 1.8.3 dhe 1.8.5</b>). Siç përmendet në kriteret më sipër, gjatë vitit, pedagogu i lëndës kryhen kolegiume të ndërmjetme apo dhe detyra të kursi. Në rastet kur konstatohen kopjime apo plagjatura detyra e kursit nuk pranohet dhe studenti vlerësohet negativisht dhe nuk hyn në provimin e rradhës. Gjatë provimit përfundimtar, komisioni dhe personat e autorizuar për administrimin e sallës së provimit monitoron studentët për të shmatur kopjimet dhe në rastet kur studenti kapet duke kopjuar apo mashtruar me mjete jo të lejueshme, provimi i tij nuk vlerësohet. (<b>Evidenca 1.6</b>)</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Vlerësimi i dijeve dhe njohurive të fituara nga studentët bëhet duke u bazuar në rregulloren UT-së (<b>Evidenca 1.5</b>) dhe rregulloren e programit të studimit (<b>Evidenca 1.6</b>). Rezultatet e provimit u njoftohen studentëve nga komisioni në përfundim të provimit me gojë dhe për provimet me shkrim brenda 15 ditëve nga data e zhvillimit të provimit (<b>Evidenca 1.5</b>). Pas korigjimit të provimeve, procesverbalet dorëzohen në sekretarinë mësimore brenda 5 ditëve nga data e afishimit të rezultateve përfundimtare (<b>Evidenca 1.5, Evidenca 1.6</b>) duke marrë parasysh dhe kohën e nevojshme për ankimimin e studentëve. Vlerësimi i provimeve bëhet me pikë të cilat konvertohen në notë, sipas sistemit shqiptar të vlerësimit me dhjetë nota, nga 1-shi tek 10-ta. Notat nga pesë deri në dhjetë janë kaluese dhe 10-ta është vlerësimi maksimal. Vlerësimit të provimit i bashkëngjitet dhe vlerësimi i vazhduar për të vendosur vlerësimin përfundimtar. Zhvillimi i procesit mësimor “online” nëpërmjet platformës MS-Teams, mundësoi zhvillimin elektronik të provimeve duke siguruar garancinë për meritë dhe transparencë në vlerësimin e njohurive dhe dijeve të studentëve (<b>Evidenca 3.4</b>)</p>



<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Në Rregulloret e UT/DK/PS "Kimi Industriale dhe Mjedisore" (<b>Evidenca 1.5 neni 49, Evidenca 1.3 neni 23, Evidenca 1.6 neni 35</b>) garantohej të drejtat e studentit për t'u njohur me vlerësimin individualisht dhe kërkesën për rishikim të vlerësimit.</p> <p>Studentët e pranishëm në takimin me GVJ, pranuan se pas përfundimit të provimit dhe korrigjimit të tij, u jepën pikët e marra në provimin përfundimtar dhe vlerësimi, ose nëpërmjet postës elektronike ose në mënyrë verbale. Ata janë të njohur me faktin se: brenda 48 orëve nga marrja e vlerësimit, studenti ka të drejtë të sqarohet për çdo paqartësi ose të kundërshtojë rezultatin e provimit. Komisioni i provimit sqaron studentin në lidhje me vlerësimin e bërë, duke ballafaquar përgjigjet e dokumentuar të studentit me tezën e zgjidhur. Për sqarime të mëtejshme studenti mund t'i drejtohet me shkrim Përgjegjësit të Departamentit përkatës.</p> <p><i>Studentët e PS të pranishëm në takimin me GVJ gjatë vizitave monitoruese në IAL cilësuan që u ishte dhënë e drejta e ballafaqimit me tezën e provimit dhe kishin marrë përgjigje të argumentuara.</i></p>			
<p><b>Kriteri 9.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Nga shqyrtimi i rregullores së UT, GVJ konkludon që Studenti ka të drejtë të ankohet për shkelje të rregullave të zhvillimit të provimit. (<b>Evidenca 1.5 neni 50</b>). Sipas kësaj evidence, ankesa paraqitet me shkrim brenda 24 orëve nga data e zhvillimit të provimit, tek Përgjegjësi i Departamentit, i cili nëse verifikon shkelje të korrigjueshme, në bashkëpunim me komisionin e provimit, bëjnë korrigjimet e duhura. Nëse Përgjegjësi i Departamentit gjykon se e ka të pamundur të marrë vendim, e delegon ankesën tek dekanin, i cili pasi është njohur me të gjithë procedurën merr vendim. Nëse ai e gjen të drejtë ankesën e studentit, anulon provimin dhe merr vendim për rishikimin e provimit (<b>Evidenca 1.5 neni 50</b>).</p> <p>Ankimimin nga ana e studentëve për rezultatet e vlerësimit përfundimtar (<b>Evidenca 1.5 neni 51</b>) e shqyrton komisioni i provimit, që i jep dhe përgjigje studentit. Në rastet kur studenti nuk dakordëson, ai ka të drejtë të ankimojë këtë vlerësim me shkrim brenda 48 orëve tek Përgjegjësi i Departamentit. Në rastin, kur Përgjegjësi i Departamentit nuk gjen zgjidhje i drejtohet Dekanit të Fakultetit. Dekani, brenda 48 orësh nga marrja dijeni për ankesën nga përgjegjësi i departamentit, ngre një komision ad-hoc i cili bën verifikimin e pretendimeve të studentit. Me miratim të dekanit, komisioni përcakton vlerësimin. Procedura e ndjekur është transparente dhe e rregullt (<b>Evidenca 1.5 neni 51, Evidenca 1.6 neni 32</b>).</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Jo për</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi III.7</b>  <b>Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët,duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>





<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Në planin strategjik të zhvillimit të PS Bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore” (<b>Evidencë 1.4</b>) përshkruhen këto objektiva: Formim i specialistëve e teknologëve në fushën e kimisë industriale, Formim inxhinierësh të ardhshëm të industrisë kimike, Formim specialistësh me background të plotësuar në të gjithë aspektet e përgatitjes profesionale dhe social kulturore, Përmirësim të vazhdueshëm të programit për t’u përgjigjur gjithnjë e më mirë ndryshimeve dhe tendencave në kërkesat që parashtron zhvillimi ekonomik i vendit dhe më gjerë, Përmirësim të vazhdueshëm të standardit të mësimdhënies.</p> <p>Fokusi i personelit akademik dhe ndihmës akademik të DKI është formimi i studentëve dhe përshtatja e tyre me kërkesat e tregut të punës. Nga <b>evidenca 1.7</b> evidentohet se planet mësimore të PS përfshijnë lëndë të formimit bazë, lëndë karakterizuese njohuri integrale, plotësuese dhe përmbyllëse të tij (<b>Evidenca 2.2 ose Tabela 9 ASCAL</b>) të cilat synojnë në një formim të përgjithshëm të studentit si Kimist Industrial. Këto njohuri mundësojnë përfitimin e dijeve që i përgjigjen kërkesave të tregut të punës të paraqitur në Strategjinë e zhvillimit të programit dhe Rregulloren e Programit të Studimit (<b>Evidenca 1.4 dhe Evidenca 1.6</b>). PS Bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore” zhvillohet vazhdimisht në drejtim të përmirësimit të cilësisë së njohurive dhe aftësive të studentit; kjo duket në punë e bërë nga DKI në disa drejtime si: DKI përditëson vazhdimisht syllabysset e programit (<b>Evidenca 1.12</b>); në planin mësimor (<b>Evidenca 1.7</b>) orët e seancave laboratorike zenë një peshë të konsiderueshme në programin mësimor, seancat laboratorike janë të shtrira jo vetëm në disiplina bazë, por edhe në lëndë karakterizuese që zhvillojnë nga 2-3 orë laboratorike në çdo javë për gjatë vitit. Nga vizita monitoruese e GVJ në ambientet e laboratoreve të DKI u konstatua që laboratorët janë të pajisur me të gjitha aparaturat didaktike për zhvillim cilësor të seancave laboratorike (<b>Evidenca 1.13.1</b>) dhe gjatë viteve të fundit ishin bërë investime si në infrastrukture ashtu edhe në pajisje laboratorike (pajisje mësimore dhe shkencore).</p> <p>Numri i studentëve në një grup laborator është 10-15 (<b>Evidenca 1.14</b>) në përshtatshmëri me hapësirën dhe mundësinë e praktikimit dhe rritjen e aftësive analitike si një mundësi më shumë në tregun e punës.</p> <p>Detyrat e kursit (<b>Evidenca 3.17</b>), që u jepen studentëve gjatë zhvillimit të programeve lëndore garantojnë thellimin e njohurive, zhvillimin e aftësive profesionale dhe të veçanta të tyre si të menduarit analitik, për zgjidhjen e problemeve të ngjashme me prodhimin.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Në Planin Mësimor të PS përfshihet lënda e “Informatikës” që garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, dhe lënda “Gjuhë të huaj” që rrit aftësitë e studentëve në fushën e komunikimit (<b>Evidenca 1.7</b>). Të gjithë anëtarët DKI kanë patur eksperiencë afat shkurtër ose afat gjatë dhe zotërojnë aftësi të plota profesionale dhe gjuhësore për të zhvilluar lëndët e programit të studimit Bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore” në gjuhën angleze, kjo rezultoi nga shqyrtimi i CV-ve (<b>Evidenca 1.16</b>) dhe takimi me stafin akademik të PS. FSHN, në kuadër të bashkëpunimeve me projekte, ka filluar të aplikojë dhe module të edukimit në distancë, që rrisin</p>



	<p>potencialin e informimit të studentëve dhe nivelin e fleksibilitetit të programeve të studimit (<b>Evidenca 1.31</b>). Mobiliteti i studentëve është një formë për të zhvilluar aftësi të reja, rritja e mundësisë për punësim si dhe fitimi i eksperiencave internacionale duke mundësuar komunikimin dhe ndërveprimin në gjuhë dhe kultura të tjera.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.</p>	<p>Nga shqyrtimi i Syllabuseve të çdo lënde (<b>Evidenca 1.8.1</b>) vihet re se ato paraqesin aftësitë që fiton studenti dhe këto aftësi analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës si një shumatore e kontrollit të vazhduar. Në elementët e kontrollit të vazhduar përfshihen: diskutimi në seminare, angazhimi në praktikat laboratorike, kolekiumi, provimi i ndërmjetëm, detyra e kursit dhe provimi përfundimtar. Në mënyrë të veçantë, në përfundim të seancave laboratorike në përshtatshmëri me kërkesat e syllabuseve të çdo lënde të programit (<b>evidenca 1.8.1</b>) pedagogu analizon rezultatet dhe vlerëson (<b>evidenca 1.14</b>), aftësitë që ka fituar secili student sipas programit që ai ka ndjekur në laborator (<b>(Evidenca 1.7)</b>).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo lënde/ moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.</p>	<p>Sipas përgjegjëseve që ka personeli akademik në realizimin e programit lëndor, në fund të çdo moduli, pedagogu/ët i lëndës bën/ bëjnë përsëritje të të gjithë materialit, teorik dhe praktik, duke evidentuar çështjet më të rëndësishme (<b>Evidenca 3.40</b>). Ata orientojnë studentët në lidhje me provimin përfundimtar, mënyrën e organizimit të pyetjeve dhe informacione në lidhje me provimin final. Ky orientim bëhet edhe për provimin përmbyllës të diplomimit (<b>Evidenca 1.8.5</b>).</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i <b>evidencës 1.36 dhe evidencës 1.31</b> vlerësojmë se në ambientet e Fakultetit të Shkencave të Natyrës realizohen, herë pas herë, orë të hapura mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë, me tema specifike me interes për studentët dhe për publikun. Në këto orë ftohen profesorë të huaj ose të vendit që kanë akses me teknologjitë e reja inovative. Këtu mund të përmenden edhe trajnimet “online” mbi përdorimin e platformës dixhitale MS-Teams në kushtet e mësimit “online” të organizuara nga UT (<b>Evidenca 3.15</b>).</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Nga <b>evidenca 1.17</b> vërehet se stafit akademik që realizon programet e lëndëve të programit të studimit Bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore” është i mirëkualifikuar, në përshtatshmëri me kompetecat përkatëse dhe e aftë për të përcjellë tek studentët njohuri në mënyrë aplikative. DKI ka në strukturë laboratore shkencore, të cilët ndihmojnë në realizimin e seancave laboratorike (<b>Evidenca 3.17</b>) që ndihmojnë studentin të zhvillojë njohuritë e marra në leksione.</p> <p>Në çdo syllabus (<b>Evidenca 1.8.1</b>), mbi bazën e të cilit realizohet procesi mësimor, paraqiten rezultatet e të nxënit, të formuluar në formë kompetencash që studenti zhvillon deri në përfundim të programit lëndor.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/ çështjeve të caktuara.</p>	<p>Nga takimet e GVJ me Dekanin e FSHN dhe Përgjegjës të Departamentit, personeli akademik të DKI si dhe me studentët konstatoi që në këtë Departament kemi një frymë bashkëpunimi; për zgjidhjen e problematikave të caktuara ë lidhje me mbarëvajtjen e procesit mësimor. Format e përdorura për diskutimin dhe zgjidhjen e problemeve të ndryshme janë: Mbedhjet e Dekanatit, ku shqyrtohen për miratim analizat</p>



	<p>vjetore të mësimit dhe kërkimit si dhe problematika të tjera që lidhen me mbarëvajtjen e tyre (<b>Evidenca 3.33</b>); Mbledhjet e Departamentit, ku shqyrtohen dhe diskutohen problematika të ndryshme në lidhje me programet mësimore, raportet vjetore të mësimit dhe kërkimit, puna e grupeve mësimor-kërkimor, diskutohen çështje të organizimit të punës shkencore dhe mësimdhënies të të gjitha programeve të studimit në varësi të DKI, pyetësorët e studentëve dhe stafit akademik. Në programet mësimore përfshihen detyra dhe projekte kursi që nxisin studentët të punojnë në grup. Gjatë orëve të leksionit, seminareve dhe sidomos laboratorëve studentëve komunikojnë në mënyrë interaktive edhe për të rritur frymën e bashkëpunimit, në realizimin e detyrave të kursit, (<b>Evidenca 1.8.1, Evidenca 3.17, Evidenca 3.16</b>).</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.</p>	<p>Në politikat e zhvillimit të programeve të Departamentit të Kimisë Industriale (<b>Evidenca 1.4</b>) përfshihet nxitja e veprimtarisë kërkimore-shkencore të personelit akademik, përfshirjen e studentëve në këto veprimtari me qëllimin që ata fitojnë aftësi për kërkime. DKI nxit idetë inovative të studentëve, në lidhje me teknologjitë e reja të prodhimit të produkteve industriale, duke ideuar apo projektuar dhe inkurajon zhvillimin e këtyre ideve inovative, të cilat diskutohen në Grupin Mësimor-Kërkimor. Nga takimet që GVJ realizoi në IAL, u theksua se DKI nxit dhe mbështet studentët për të marrë pjesë në aktivitete të programit të studimit apo në programe mobiliteti <a href="https://unitir.edu.al/bursa-shkembimi-programi-erasmus/">https://unitir.edu.al/bursa-shkembimi-programi-erasmus/</a>, në konferenca apo seminare studentore.</p> <p><i>Studentë e pranishëm në takim pranuan që ishin të informuar për mundësi aplikimi për mobilitete madje një nga studentët e pranishëm kishte aplikuar dhe ishte pranuar për studime të metejshme në një nga universitetet Europiane.</i></p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.</p>	<p>Në statutin e UT (<b>Evidenca 1.1neni 136</b>) cilësohet mbështetja financiare e Këshillave Studentorë, veprimtaria e të cilëve në nivel fakulteti mbështetet dhe financohet nga buxheti i fakultetit. Në bazë të propozimeve dhe ideve të diskutuara dhe aprovuara nga UT/FSHN/DKI mbështet financiarisht dhe vë në dispozicion të punës kërkimore të studentëve, hapësirat dhe pajisje laboratorike (<b>Evidenca 1.13.1</b>).</p>
<p><b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Në kuadër të programeve si Erasmus+, Universiteti i Tiranës, ka realizuar nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me Universitete Europiane (<b>Evidenca 1.2</b>), etj, të cilat konsistojnë në: Shkëmbimin e eksperiencës akademike; Mobilitetin e stafit dhe studentëve në kuadër të programeve Erasmus. Për periudhën 2019-2023 UT ka nënshkruar 42 marrëveshje, në kuadër të programit Erasmus+KA, të listuara në faqen zyrtare të Universitetit të Tiranës. Nëpërmjet këtyre marrëveshjeve UT ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me 100 universitete homologe jashtë vendit. Anëtarë të Departamentit të Kimisë Industriale (<b>Evidenca 1.28</b>) janë të angazhuar në Njësinë e Nanoshkencës dhe Nanoteknologjisë Shqiptare (Nanoalb) të formuar Dhjetor të vitit 2019 në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave. Në kuadër të programit Erasmus+, Departamenti i Kimisë Industriale është përfshirë në</p>



	<p>projektin NETCHEM, ku janë realizuar disa workshop-e me pjesëmarrjen edhe të studentëve (<b>Evidenca 1.31</b>).</p> <p>Në kuadër të shkollës së doktoraturës Departamenti i Kimisë Industriale është i përfshirë në një projekt me Universitetin e Hohenheim Gjermani (<b>Evidenca 1.32</b>).</p> <p>DKI/FSHN (<b>Evidenca 1.28; Evidenca 1.33</b>) ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me disa kompani që ushtrojnë aktivitete brenda fushës që mbulon Departamenti i Kimisë Industriale, për të ndihmuar studentët të cilët kanë interes për trajnime ose internshipe. (<i>Theksojmë këtu që këto marrëveshje do mund të shfrytëzoheshin për praktika profesionale nëse ato do të përfshiheshin në program.</i>)</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi III.8</b>	
<b>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Sipas dokumentacionit në dispozicion rezulton se PS Bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore” mbyllet me provimin përfundimtar ( <b>Evidenca 1.7</b> ). FSHN dhe DKI, harton një procedurë të posaçme për provimin përfundimtar para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike ( <b>Evidenca 1.3, Evidenca 1.6, Evidenca 1.8.3</b> ). Stafit akademik pohon se ata informojnë studentët me programin e provimit të formimit që në fillim të semestrit të fundit ( <b>Evidenca 1.8.5</b> ). <i>Studentët pohojnë që për provimin final ju kanë vënë në dispozicion tema të lidhura me pjesën më formuese dhe profesionale të Programit të Studimit.</i>
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final të Programit të studimit Bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore”, bazohet në testimin e njohurive të marra gjatë tri viteve akademike. Ai përbëhet nga pedagogët e Programit të studimit brenda departamentit, përgjegjës të lëndëve që mbulon programi i provimit. Teza e provimit përmban pyetje nga lëndë të Programit të studimit Bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore”: Bazat e Industrisë Kimike; Lëndët e djegshme; Kimia Industriale I; Kimia Industriale II, Projektimi dhe Ekonomia e Proceseve Kimike I; Projektimi dhe Ekonomia e Proceseve Kimike II; Bazat e kontrollit dhe drejtimit të proceseve; Inxhinieria e reaksioneve kimike ( <b>Evidenca 1.8.5</b> ).
<b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha	Nga takimi me personelin akademik të PS dhe dokumentacioni vihet në dukje se programi orientues për provimin e diplomës publikohet elektronikisht në website e FSHN ( <b>Evidenca 1.8.5, Evidenca 3.34</b> ). Sa më sipër studentët pohojnë se ata orientohen dhe ndihmohen për seleksionimin e materialeve të provimit final, nga pedagogët e tyre duke ju vënë në dispozicion materiale, informacione shtesë kur është e



lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	nevojshme ( <b>Evidenca 1.8.3</b> ). Një tjetër ndihmesë e mirë për studentët është biblioteka dhe libraria e FSHN.
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.	Nga takimi me personelin akademik të PS dhe dokumentacioni i vënë në dispozicion nga GVB, vihet në dukje se programi orientues për provimin e diplomës publikohet elektronikisht në website e FSHN ( <b>Evidenca 1.8.5, Evidenca 3.34</b> ). Sa më sipër studentët pohojnë se ata orientohen dhe ndihmohen për seleksionimin e materialeve të provimit final, nga pedagogët e tyre duke ju vënë në dispozicion materiale, informacione shtesë kur është e nevojshme ( <b>Evidenca 1.8.3</b> ). Një tjetër ndihmesë e mirë për studentët është biblioteka dhe libraria e FSHN.
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	N/A
<b>Kriteri 6.</b> Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	N/A
<b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Komisioni i posaçëm i ngritur nga departamenti, në përfundim të provimit të formimit që organizohet me shkrim ose me gojë, vlerëson studentin me notë, sipas sistemit shqiptar të vlerësimit me 10-të nota, nga 1-shi tek 10-ta, ku 10-ta është vlerësimi maksimal. Notat nga pesë deri në dhjetë janë kaluese. Vlerësimi përfundimtar pasqyrohet në procesverbal, i cili firmoset nga të gjithë anëtarët e komisionit dhe depozitohet në sekretarinë mësimore ( <b>Evidenca 3.35</b> ).
<b>Kriteri 8.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Nga dokumentat në dispozicion vërehet se në përfundim të studimeve, kur studenti ka mbyllur edhe të gjitha detyrimet përkatëse në bazë të Programit të studimit që ai po ndjek, pajiset me diplomë Bachelor "Kimi Industriale dhe Mjedisore" të miratuar nga Ministria përgjegjëse për arsimin (MASR) dhe të firmosur nga Dekani dhe Rektori i Universitetit të Tiranës ( <b>Evidenca 1.1, Evidenca 1.5, Evidenca 1.6</b> ). Sipas rregulloreve të PS ( <b>Evidenca 1.1, Evidenca 1.8.4, Evidenca 1.8.3</b> ), formati i diplomës shoqërohet me suplementin e diplomës. Për studentët që kanë përfunduar studimet me të gjitha notat dhjeta, jepet Çertifikata "Medalje e Artë" dhe për studentët që gjatë studimeve, kanë marrë mbi 80% të notave 10 (dhjeta) dhe pjesën tjetër vetëm 9 (nënta), jepet Çertifikata "Student i Shkëlqyer" ( <b>Evidenca 1.1, Evidenca 1.5, Evidenca 1.6, Evidenca 3.36</b> ).
<b>Kriteri 9.</b> Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në	Studenti pajiset me diplomën dhe me suplementin e saj ( <b>Evidenca 1.1, Evidenca 1.6, Evidenca 1.1, Evidenca 1.8.4</b> ), bazuar në Statutin e Universitetit të Tiranës dhe Rregulloren e Programit të Studimit



dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore”. Po kështu, studenti në përfundim të studimeve, me kërkesën e tij gëzon të drejtën të pajiset me kopje të plotë zyrtare të Programit të Studimit. Kjo sipas afati kohor të përcaktuar në rregullore.			
<b>Kriteri 10.</b> Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.	Sipas Rregullores së UT-së ( <b>Evidenca 1.5</b> ), Institucioni ka për detyrë të mbajë në formë të shkruar dhe elektronike: regjistrin themeltar ( <b>Evidenca 3.37</b> ); regjistrin i arritjeve akademike ( <b>Evidenca 3.38</b> ); regjistrin e lëshimit të diplomave dhe çertifikatave ( <b>Evidenca 3.39</b> ). Këto dokumenta depozitohen në arkivat e shtetit, (sipas kuadrit ligjor në fuqi për arkivat), ndërsa kopja e njësuar me origjinalin ruhet për gjithë periudhën kohore të ekzistencës së institucionit të arsimit të lartë.			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës III</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				X



#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

<b>Standardi IV.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Sipas <b>Evidencave: 1.5 Neni 13, dhe 4.1 fq. 7 (jo 35)</b>, struktura përgjegjëse për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit të angazhuar në programet e studimit, në UT është Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme, Sektori i Burimeve Njerëzore në Rektorat. Ky sektor disponon një dosje të plotë për secilin prej anëtarëve të personelit akademik të brendshëm (<b>Evidenca 4.2 dhe Evidenca 4.2.1</b>).</p> <p>Në këtë dosje, siç u pa dhe verifikua nga takimi me punonjësen e drejtorisë së burimeve njerëzore gjatë vizitës në IAL gjenden këto dokumenta: Kërkesë për punësim; Jetëshkrimi (CV), Diplomë dhe listë notash, Dëshmi e mbrojtjes së gjuhëve të huaja; Çertifikata të ndryshme; Grada/Tituj ; Libreza e punës ; etj.</p> <p>DKI, çdo fillim viti akademik, mbështetur në Udhëzimin e <b>MASR Nr.29, dt.10.09.2018, i ndryshuar</b>, përcakton ngarkesën semestrale dhe vjetore të departamentit/ programit (<b>Evidenca 2.15</b>) si dhe ngarkesën individuale të çdo personeli akademik të angazhuar në mësimdhënien e programit “Bachelor në Kimi Industriale dhe Mjedisore” (PAE dhe PAK) (<b>Evidenca 2.7, Evidenca 2.19 aneks tab 4 ASCAL</b>).</p> <p>Informacioni i realizimit të ngarkesave dhe punës kërkimore shkencore të PAE përmbledhet në raportet vjetore të veprimtarisë së DKI (<b>Evidenca 3.12</b>). Gjithashtu, mbështetur në <b>Evidencën 1.16</b>, vleresojmë që secili anëtar i stafit akademik PAE përditëson periodikisht CV e tij.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>UT, bazuar në <b>nenet 64 dhe 66 të ligjit nr. 80/2015</b> dhe në Kodin e Punës dhe në Statusin e personelit akademik (<b>Evidenca 4.3</b>), ka përcaktuar në statutin (<b>Evidenca 1.1 neni 67, 68, 80</b>) dhe rregulloren e institucionit (<b>Evidenca 1.5 Kreu II, Neni 25, 26</b>), procedurat dhe kriteret e përgjithshme, për çdo kategori të personelit akademik.</p> <p>Rektorati i UT për të shmangur çdo formë pabarazie në përzgjedhjen e personelit ka hartuar dhe një manual “Mbi punësimin e personelit të Universitetit të Tiranës” (<b>Evidenca 1.25</b>).</p> <p>Sipas <b>evidencës 1.15</b>, Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme, sektori i Burimeve Njerëzore është njësi përgjegjëse që ndjek procedurat e plotësimit të strukturës, duke iu referuar numrit të përgjithshëm të personelit (<b>evidencave 4.30</b>), përfshirë dhe atë akademik.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton procedura e kriteret të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Universiteti i Tiranës e ka të përcaktuar në dokumentacionin bazë (Statut, Rregullore) rregullimin e veprimtarisë së institucionit, parimet, kriteret dhe procedurat e përgjithshme për punësimin e personelit të saj (<b>Evidenca 1.1 nenet 67-68, Evidenca 1.5 Kreu II, Neni 25, 26</b>).</p> <p>Në <b>evidencën 1.25</b> përcaktohen procedurat e posaçme të punësimit për personelin: - akademik me kohë të plotë, - ndihmë akademik me karakter mësimor, - ndihmës akademik me karakter administrativ në njësitë</p>



	<p>kryesore, - ndihmës akademik me karakter administrativ në Rektorat, - administrativ në njësitë kryesore, - dhe administrativ në Rektorat.</p> <p>Kriteret specifike për çdo vend të ri pune përcaktohen në njësinë bazë (<b>Evidenca 4.4</b>) duke u bazuar në veçantinë dhe karakterin e punës që duhet të mbulojë personeli i ri duke u bazuar në ngarkesën mësimore dhe propozohen nga Grupi Mësimor, që ka të nevojshëm angazhimin e pedagogut të ri, dhe pasi miratohen në Departament përcillen në Dekanat. Ky i fundit ia përcjell Rektorit (<b>Evidenca 1.1</b>).</p> <p>Më tej, kriteret për shpallje konkursit i dërgohen Agjensisë së Prokurimeve Publike e cila bën njoftimin publik në fletoren zyrtare <a href="https://www.app.gov.al/GetData/DownloadDoc?documentId=334fceb-f714-443a-90d9-75b124598b5f">https://www.app.gov.al/GetData/DownloadDoc?documentId=334fceb-f714-443a-90d9-75b124598b5f</a>. Njoftimi i Vendit të lirë të punës njoftohet edhe në website-in e FSHN, <a href="https://fshn.edu.al/notifications/njoftim-per-shpallje-te-fituesit-per-vendin-e-punes-per-personel-ndihmes-akademik-me-%20karakter-mesimor-laborant-ne-departamentin-e-kimise-industriale">https://fshn.edu.al/notifications/njoftim-per-shpallje-te-fituesit-per-vendin-e-punes-per-personel-ndihmes-akademik-me-%20karakter-mesimor-laborant-ne-departamentin-e-kimise-industriale</a> dhe përmban kriteret e përgjithshme dhe specifike të vendit të punës, dokumentacionin që aplikanti duhet të dorëzojë pranë Degës së Burimeve Njerëzore dhe afatet e aplikimit (<b>Evidenca 4.4</b> procedurë punësimi personel akademik). Edhe punësimi i personelit ndihmës akademik me karakter mësimor ndiqet procedura e parashikuar në manualin e punësimit, duke i bërë njoftimet në fletoren zyrtare të APP dhe faqen zyrtare web të FSHN (<b>Evidenca 4.4.3</b> procedurë punësimi personel ndihmës akademik).</p> <p>Për punësimin e personelit akademik me kontratë të përkohshme, çdo fillim viti akademik, pas planifikimit të ngarkesave, për nevoja të mbulimit të ngarkesës mësimore, kriteret e përgjithshme dhe specifike që duhet të plotësojnë kandidatët që do të aplikojnë përcillen në dekanat njoftimi bëhet në faqen zyrtare të FSHN (<b>Evidenca 4.4.1</b> procedurë punësimi PAK).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Për vlerësimin e kandidatëve aplikantë, Dekani i FSHN ngre komisionin ad-hoc (<b>Evidenca 1.5 Kreu II, Neni 25, 26; Evidenca 1.1/nene 67 pika 5.6</b>) i përbërë nga 5 anëtarë, që nuk duhet të kenë konflikt interesi. Një anëtar është përfaqësues i Rektorit (miratuar nga ky i fundit), dy anëtarë propozohen nga Departamenti dhe dy anëtar nga Dekani (<i>jo sipas RVB</i>) (<b>Evidenca 1.1 neni 67 pika 5.c dhe Evidenca 4.4</b>). Vlerësimi i kandidaturave përfshin dy faza të njëpasnjëshme, që janë vlerësimi i dosjes (përmbushja e kriterëve sipas pozicionit) dhe intervista. Vetëm kandidatët e kualifikuar nga faza e shqyrtimit të dosjes i nënshtrohen intervistës. Komisioni ad-hoc shpall kandidatin fitues dhe e publikon në faqen zyrtare të FSHN (<b>Evidenca 1.1 dhe Evidenca 4.4</b>).</p> <p>Pas ankimeve të mundshme komisioni ad-hoc i paraqet kandidatin fitues Rektorit të UT përmes drejtuesit të njësisë kryesore (<b>Evidenca 1.1</b>). Pasi Rektori nënshkruan kontratën e punës, me të fillon marrëdhënia e punës (<b>Evidencat 1.1 dhe 4.4</b>). Përzgjedhja e personelit akademik me kontratë të përkohshme PAK bëhet sipas <b>evidencës 4.4.1</b> (konform standardit). Komisioni i vlerësimit të dosjeve vendos për kandidatët fitues duke bashkërenduar punën dhe me fakultetet e tjera të UT. Pas konfirmimit nga Fakulteti kompetent, si edhe pas interpretimit të kriterëve</p>



	të tjera, FSHN vendos për kandidatët fitues. Më tej, lista emërore e fituesve, shoqëruar me informacionin lidhur me të dhënat në dosjen e tyre dhe ngarkesën që është planifikuar të mbulojnë, përcillet në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, në Rektorat dhe miratohen nga Rektori. Proçedura mbyllet me nënshkrimin e kontratës së punës nga kandidatët fitues (Evidenca 4.4.1).			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi IV.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	<p>Nga shqyrtimi i strategjisë së zhvillimit të UT (<b>Evidenca 1.2 pika 5 fq. 22-25 dhe faqja zyrtare e UT</b>), vlerësohet që UT synon vazhdimisht përmirësimin e kushteve të punës për personelin akademik dhe administrativ, si edhe përmirësimin e infrastrukturës për të mundësuar kushte të mira pune dhe realizimin e objektivave të institucionit në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. FSHN ka në dispozicion të stafit 4 godina të rikonstruara dhe të pajisura me infrastrukturë shumë të mirë mësimdhënëse. Duke konsideruar <b>Evidencën 1.13</b>, vërejmë që mjediset e ofruara janë: salla leksioni e seminari (35 salla me sipërfaqe 3907.4m<sup>2</sup>), laboratore (90 salla me sipërfaqe 3475.5m<sup>2</sup>), dhe salla interneti dhe biblioteke (5 salla me sipërfaqe 286m<sup>2</sup>). Ndër sallat e leksionit, 7 prej tyre (me sipërfaqe 1336.4m<sup>2</sup>) mund të përdoren edhe për aktivitete promovuese. Fakulteti ofron edhe mjedise për zhvillimin e praktikave lëndore apo profesionale si Kopështi Botanik dhe Muzeu i Shkencave të Natyrës (<b>evidenca 2.28 ose Tabela 16 ASCAL</b>).</p> <p>Mbështetur në <b>evidencat 1.13.1 dhe 1.13.2</b> si dhe nga vizita në ambjentet e IAL, GVJ konstatoi se stafi i DKI, që angazhohet në programin Bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore”, akomodohet në 6 mjedise të posaçme (me sipërfaqe të përgjithshme 157.8m<sup>2</sup>). Secili pedagog është i pajisur me tavolinën e vet të punës, kompjuter desktop personal të lidhur me rrjet interneti dhe printer-fotokopjen, si dhe çdo zyrë furnizohet me materiale konsumi sipas kërkesave të bëra përmes një zëri të veçantë në planbuxhetin vjetor (<b>Evidenca 4.5</b>). Këtij departamenti i përkasin dhe 8 mjedise laborator me sipërfaqe 349 m<sup>2</sup> të cilët shërbejnë për mësimdhënie dhe kërkim shkencor.</p> <p><i>Kujtojmë që në këto laboratore kryhen praktikat e lëndëve specifike të programit të studimit pasi në shërbim të PS bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore” janë dhe mjedise të departamentit të Kimisë apo mjedise të tjera të FSHN.</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që	Në <b>evidencën 1.1 (statuti i UT neni 4.pika 4)</b> theksohet se një nga objektivat strategjike të UT-së, është edhe nxitja e kualifikimit të vazhdueshëm profesional të personelit akademik. Kualifikimi i stafit



<p>mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>dhe mbështetja e tij në aktivitetin kërkimor shkencor shprehet edhe në Strategjinë e zhvillimit të UT-së 2018-2023 (<b>Evidenca 1.2</b>).</p> <p>Nga shqyrtimi i <b>Evidencës 3.12</b> (raportet vjetore të DKI 2018-2021) dhe <b>Evidencës 4.6</b> (procedura modalitetesh), si dhe nga takimi me stafin vlerësojmë se në sajë të bashkëpunimit ndërkombëtar stafi i Departamentit të Kimisë Industriale ka përfituar nga marrëveshja ERASMUS+, përmes programeve të mobilitetit në universitete partnere për mësimdhënie apo trajnim. UT/ FSHN shpall vazhdimisht thirrje për aplikim nga stafi në këto programe në faqen zyrtare të internetit (<b>Evidenca 4.7</b>). Personeli i DKI ka marrë pjesë në mënyrë të vazhdueshme edhe në aktivitete të tjera si projekte apo konferenca. Përmendim projektet - "ICT Networking for Overcoming Technical and Social Barriers in Instrumental Analytical Chemistry Education", Ref. No: 573885-EPP-1-2016-1-RS-EPPKA2-CBHE-JP (Acronym NETCHEM), 2016-2020; - "Developing and application of a system based on advanced oxidation processes for the treatment of hospital wastewaters in order to remove pharmaceutical compounds with high persistence in aquatic environment", PHAREM (2019-2021), INTERREG IPA Cross CBC Greece- Albania; - "Tailoring of the chemical profile of volatile organic compound (VOC) in a combined drying/extraction process of <i>Salvia officinalis</i> L.". Projekt në kuadër të shkollës së doktoraturës me Universitetin e Hohenheim-Gjermani.</p> <p>Nga takimet në IAL, si dhe nga shqyrtimi i statutit (<b>Evidenca 1.1</b>) si dhe <b>Evidencave 1.28; 4.5 dhe 4.8</b>, vlerësojmë që UT zbaton politika të mbështetjes financiare për pjesëmarrje në projekte kërkimore, konferenca shkencore e publikime në revista shkencore për secilin prej anëtarëve të stafit akademik. DKI ka marrëveshjeve kombëtare me universitete të tjera shtetërore, institute dhe industrinë (13 joto 14 të tilla) (<b>Evidenca 1.33, Evidenca 2.5 ose Tabela 5 ASCAL</b>).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Në statutin (<b>Evidenca 1.1</b>) sanksionohet se UT ka prioritet përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies me qëllim përgatitjen e një studenti interaktiv. Vendosja e rregulloreve (<b>Evidenca 3.4 ose faqja zyrtare e UT</b>) apo financimi i dedikuar, (për mundësimin e platformave online, laptop, videoprojektor, internet) dhe bashkëpunimet në programe evropiane si Erasmus+, shpreh faktin që UT/FSHN merr masa për konkretizimin e këtij qëllimi. Nga shqyrtimi i <b>evidencave 4.9; 3.13 dhe 3.13.1</b> si dhe nga vizitat në ambjentet e DKIM, vlerësojmë se UT/FSHN ka investuar vazhdimisht në infrastrukturë duke pajisur të gjitha sallat e leksioneve me videoprojektor dhe internet wireless si edhe personelin akademik me pajisje audio-vizive portabël. Për zgjidhjen e problematikës që solli pandemia, UT/FSHN ka përdorur platformat online të Google Classroom (<b>Evidenca 4.10</b>), dhe MS Teams. Nëpërmjet rregulloreve të posaçme (<b>Evidenca 3.5; 3.4 dhe 4.11</b>) ka ndihmuar personelin akademik dhe ndihmës akademik si dhe studentët për t'i shfrytëzuar sa më mirë këto platforma. Për të rritur efektshmërinë e përdorimit të metodave inovative, fakulteti ka ndërmarrë disa masa për informim dhe trajnim të stafit. Në kuadër të Erasmus+, projektit NETCHEM (<b>Evidenca 1.28 Raportet vjetore të FSHN</b>), është</p>



	mundësuar ngritja e një platforme online, e cila u jep mundësinë stafit dhe studentëve për përdorimin e burimeve të hapura të edukimit (Evidenca 1.31).		
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.	<p>DKI përbëhet nga 19 personel akademik me kohë të plotë dhe 6 personel ndihmës akademik mësimit-kërkimor <a href="https://fshn.edu.al/departments/departamenti-i-kimise-industriale/">https://fshn.edu.al/departments/departamenti-i-kimise-industriale/</a>. Ndër ta, 3 janë me titull Profesor Doktor, 5 me titull Profesor i Asociuar Doktor, 9 janë me gradë Doktor dhe 2 me Master Shkencor.</p> <p>Për realizimin cilësor të programit mësimit Bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore” janë përfshirë edhe personel akademik nga departamente të tjera të Fakultetit të Shkencave të Natyrës, Fakultetit të Gjuhëve të Huaja dhe Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporteve Universitare si dhe 13 pedagogë me kontratë të pjeshme PAK (Evidenca 2.15 tabelat e ngarkesës, si dhe Evidencat 1.19 dhe 19.1)</p> <p>Personeli akademik i DKI angazhohet vazhdimisht në pjesëmarrje në aktivitete të ndryshme (projekte, konferenca, botime artikujsh, librash mësimit, monografi). (Evidenca 1.28- analizat vjetore; Evidenca 1.16-CV e PAE; Evidenca 4.12 ose Tabela 19 e ASCAL, Evidenca 2.27 Aktiviteti Kërkimor shkencor DKI 2018-2021).</p> <p>Evidenca 1.15 (organigrama e FSHN) si dhe evidenca 2.7 (ose tabela 2 Aneks ASCAL) tregojnë se puna e personelit akademik, mbështetet mjaft edhe nga personeli ndihmës mësimit-kërkimor si edhe ai administrativ.</p>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

<b>Standardi IV.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/ëve të studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	<p>Sikurse është përshkruar me detaje në RVB dhe nga evidencat që po citojmë: FSHN e zhvillon mësimin në 4 godina me një sipërfaqe totale prej 13,223.64m<sup>2</sup> (Evidenca 1.13). Sipas evidencës Evidenca 1.21.1, rezulton se janë në dispozicion 5.3m<sup>2</sup> /student. Ndërkohë, sipërfaqja në dispozicion për numër studentësh që ndjekin aktualisht programin e studimit Bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore” është rreth 16.6m<sup>2</sup>/student [Evidenca 2.21 (orari 2021-2022); Evidenca 1.13 Infrastruktura FSHN].</p> <p>(<a href="https://api.fshn.edu.al/uploads/Bachelor_Kimi_Industriale_dhe_Mjedisore_V3_6ad0607255.pdf/">https://api.fshn.edu.al/uploads/Bachelor_Kimi_Industriale_dhe_Mjedisore_V3_6ad0607255.pdf/</a>)</p> <p><a href="https://api.fshn.edu.al/uploads/Bachelor_Kimi_Industriale_dhe_Mjedisore_V2_74b8a7e754.pdf/">https://api.fshn.edu.al/uploads/Bachelor_Kimi_Industriale_dhe_Mjedisore_V2_74b8a7e754.pdf/</a></p> <p><a href="https://api.fshn.edu.al/uploads/Bachelor_Kimi_Industriale_dhe_Mjedisore_V2_74b8a7e754.pdf/">https://api.fshn.edu.al/uploads/Bachelor_Kimi_Industriale_dhe_Mjedisore_V2_74b8a7e754.pdf/</a></p>



	<p>Kështu, meqë standardi i sipërfaqes në dispozicion të studentëve është 2.5 m<sup>2</sup>/student (sipas VKM Nr. 418, datë 10.5.2017) ky kriter përmbushet. Sipas Evidencës 1.13, godinat përbëhen nga mjedisë zyrash, salla leksioni dhe seminari, dhe salla laborator. Sallat e leksionit dhe seminareve kanë sipërfaqe respektivisht 2167.1m<sup>2</sup> dhe 404.4m<sup>2</sup> (totali 2571m<sup>2</sup>). Labororet kanë një sipërfaqe të përgjithshme prej 3475.5 m<sup>2</sup>. Nga shqyrtimi i Evidencës 1.13.2 të paraqitur nga GVB, vlerësojmë se Programi i Bachelor Kimi Industriale dhe Mjedisore shfrytëzon 24 mjedisë laborator (sipërfaqe totale 1184.8 m<sup>2</sup>) të pozicionuara kryesisht në godinën A, dhe një pjesë më e vogël në godinat B e C. Një pjesë e laboratoreve është në varësi të DKI dhe pjesa tjetër e Departamentit të Kimisë apo Fizikës. Organizimi dhe ndarja e këtyre mjedisëve është realizuar në varësi të numrit të studentëve (sallat e leksionit dhe seminareve me 48-150 poste ndërsa sallat e laboratoreve 15-16 poste), grupeve mësimore, në përputhje me natyrën e programit të studimit Bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore” dhe moduleve përkatëse. Nga Evidenca 1.13 dhe 1.21.1 vërehet se grupet mësimore të Bachelor Kimi Industriale dhe Mjedisore e kanë numrin e studentëve brenda kapacitetit të klasave ku janë caktuar të zhvillojnë veprimtarinë mësimore. Nga vizita e kryer në ambjentet e IAL dhe nga Evidencat 1.28, dhe 4.9 konstatojmë që mjedisët janë të pajisura me infrastrukturë të përshtatshme mësimdhënëse si dhe pajisje laboratorike specifike në përshtatje të programit mësimor, si dhe vazhdimisht bëhen investime në ta përmirësuar këtë infrastrukturë etj.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjedisët mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedisë të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Mbështetur në Evidencën 4.9 dhe nga vizita e GVJ në IAL, vlerësojmë se sallat e leksioneve për PS Bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore” janë të gjitha të pajisura me videoprojektorë statikë (godina A, B, D) që garantojnë realizimin e plotë të procesit mësimor teorik. Sipas Evidencave 3.13 dhe 3.13.1 vërehet se për të mundësuar standardin e nevojshëm gjatë seancave të seminareve, stafi i Departamentit të Kimisë Industriale është pajisur me pajisje elektronike portabël (videoprojektor dhe kompjuter). Nga vizita e GVJ në FSHN konstatojmë se të gjitha ambjentet e godinave të FSHN kanë mundësi për të aksesuar rrjet interneti wireless që mund të nevojitet për realizimin e procesit mësimor. Sipas evidencës 1.13.1 dhe nga vizita në ambjentet e DKI vlerësojmë që ky departament zotëron gjithashtu edhe një sallë kompjuterike me 25 poste, e cila vjen në ndihmë të studentëve diplomantë dhe përdoret edhe për realizimin e punëve laboratorike me karakter llogaritës inxhinierik. Në varësi të këtij departamenti gjendet dhe një sallë që shërben për printim, skanim dhe fotokopje të cilët janë në përdorim gjatë gjithë procesit mësimor nga personeli dhe studentët.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjedisët e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e</p>	<p>Duke shqyrtuar evidencat 1.13.2 dhe 3.13.2, si dhe nga vizita në ambjentet e IAL, konstatojmë se laboratorët që përdoren për realizimin e PS Bachelor Kimi Industriale dhe Mjedisore janë të pajisura me pajisjet, aparaturat, mjetet dhe reagentët e nevojshëm për realizimin e programit sipas specifikave të lëndëve në përshtatje me syllabus-et (Evidenca 1.8.1). Gjithashtu nga evidenca 1.13.2, dhe vizita e GVJ, vërehet se janë bërë investime vazhdimisht në këtë drejtim, laboratorët</p>



<p>praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>janë rikonstruktuar kohët e fundit duke u pajisur me infrastrukturë të re (bango, karrige, dollapë dhe sistem aspirimi) si dhe janë plotësuar me aparatura specifike të gjitha punët e laboratorit. Në kuadër të “Projekteve të Infrastrukturës së Kërkimit Shkencor në kuadër të Paktit për Universitetin”, Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, e miratuar më Qershor 2019 (<b>Evidenca 1.32</b> dhe vizita e GVJ në IAL), DKI ka fituar dhe ka realizuar pasurimin me pajisje modern të laboratorit të Inxhinierisë Kimike.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.</p>	<p>FSHN siguron në tërësi në dispozicion të mësimdhënies 8 laboratorë mirëfilli informatike, të pozicionuar në godinën B dhe C (<b>Evidenca 1.13</b>). Për sa i përket Departamentit të Kimisë Industriale, konstatohet që në Laboratorin mësimor i Inxhinierisë Kimike, studihet modelimi, simulimi dhe optimizimi i proceseve apo njërive operuese. Programet e instaluar në kompjutera janë Sistemet Operative Windows, Paketa Microsoft Office përfshirë edhe Microsoft Visio, Lingo, Aspen Plus, Hysys, dhe MATLAB (<b>Evidenca 1.13.2</b>) janë në përshtatshmëri me natyrën e lëndëve të PS “Kimi Industriale dhe Mjedisore”. Sipas <b>evidencave 1.28; 2.33 dhe 3.13.2</b> dhe nga vizitat në IAL konstatohet që të gjithë laboratorët e DKI janë të pajisur me mjetet didaktike të nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor dhe një personel ndihmës mësimor-kërkimor është përgjegjës për mirëmbajtjen e tyre.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.</p>	<p><i>Nga shqyrtimi i programit mësimor “Kimi Industriale dhe Mjedisore” dhe nga takimi me GVB dhe stafin e departamentit, GVJ konstaton që Departamenti i KI për diplomën Bachelor nuk ka të planifikuar praktikë profesionale. GVJ e sheh të arsyeshme ta rekomandojë mundësinë e një praktike profesionale, por stafi e argumenton mungesën e saj me faktin që rreth 70% e studentëve që mbarojnë Bachelorin “Kimi Industriale dhe Mjedisore” (<b>Evidenca 1.11, Evidenca 1.21.1</b>), zgjedhin të vazhdojnë studimet në një nga masterat e ofruar në departamentin e Kimisë Industriale.</i></p> <p>Pavarësisht nga kjo, DKI ka lidhur 13 marreveshje me institucione dhe firma private që mundësojnë praktika profesionale dhe intershipe për studentët (<b>Evidenca 1.33</b>). Nga <b>evidenca 1.13.2</b> dhe nga vizita në ambientet e DKI, GVJ vlerëson që DKI ka kapacitet e mjaftueshme për realizimin e veprimtarive të tjera praktike të parashikuara në program.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
			X	

**Standardi IV.4**

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke</p>	<p>Nga vizita në IAL dhe bazuar në <b>evidencën 1.13</b> konstatohet që FSHN vë në dispozicion të studentëve bibliotekën qendrore. Biblioteka ka ambiente të përshtatshme dhe të rikonstruktura, tre mjedise leximi</p>



<p>garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>(Fondi i Hapur i Librit, Fondi i Hapur i Periodikut dhe Fondi Kryesor i shërbimit me banak) me një sipërfaqe të përgjithshme prej 678.75m<sup>2</sup> (136 pozicione për lexuesit). Në ambjentet e bibliotekës stafi dhe studentët kanë mundësi të aksesojnë krahas literaturës së printuar, edhe informacione dhe materiale në formë elektronike nga burime online. Nga takimi me punonjësit e bibliotekës si dhe nga <b>evidencat 4.13.1 dhe 4.14</b> vërejmë që në bibliotekë janë angazhuar 4 punonjës, 3 staf të angazhuar në sigurimin e mbarëvajtjes së funksionimit të bibliotekës dhe 1 staf i buletinit të FSHN.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në rregulloren e bibliotekës (<b>Evidenca 4.13</b>), si dhe nga vizita e GVJ në ambjentet e saj, vlerësojmë se biblioteka e FSHN i shërben procesit mësimor, edukativ, formimit profesional dhe veprimtarisë shkencore të Fakultetit të Shkencave të Natyrës, UT, në të tre ciklet. Në <b>evidencën 4.13.1</b> e paraqitur nga GVB, vërehet se fondi i bibliotekës është i bollshëm prej 80018 tituj, (libra e monografi shkencore në shqip dhe në gjuhë të huaj; disertacione në shqip dhe në gjuhë të huaj si dhe revista e periodikë shkencorë shqip dhe në gjuhë të huaj). Gjatë vizitës në ambjentet e bibliotekës u konstatua prania e literaturës fizike të nevojshme për mbulimin programeve të studimit që ofron fakulteti, përfshirë edhe atë të Bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore”. Kjo paraqitet edhe në <b>evidencën 2.25</b> të paraqitur në RVB.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Në strategjinë e tij të zhvillimit (<b>Evidenca 1.2 fq 7 pika 1.2.15</b>), UT ka të përfshirë objektivin për sigurimin e aksesit në një bibliotekë universitare të huaj, fond librash me autorë të huaj dhe krijimin pranë çdo fakulteti të fondit të librave dixhitalë në gjuhë të huaj. Në kuadër të kësaj, nga takimi me punonjësit e bibliotekës si dhe nga shqyrtimi i <b>evidencës 4.13.1</b> të paraqitur nga GVB, u evidentua që dixhitalizimi i bibliotekës së FSHN është ende në process. UT ka finalizuar gjithashtu marrëveshje për qasje edhe në biblioteka të tjera digjitale si JSTOR, EDGAR, IOP, ASTM, MSP (<b>Evidenca 3.19 ose tabela aneks Tabela 17 ASCAL</b>). Aksesit në to mund të realizohet përmes faqes online të UT <a href="https://unitir.edu.al/biblioteka-online/">https://unitir.edu.al/biblioteka-online/</a> dhe FSHN <a href="https://fshn.edu.al/">https://fshn.edu.al/</a> duke shfrytëzuar adresën zyrtare të emailit të mundësuar nga Universiteti i Tiranës ku mund të gjendet edhe manuali i nevojshëm për shfrytëzimin e tyre (<b>Evidenca 3.22</b>). Biblioteka ekzistuese tashmë është pjesë e rrjetit të sistemit bibliotekar e informues COBISS (<a href="https://plus.al.cobiss.net/opac7/bib/search/">https://plus.al.cobiss.net/opac7/bib/search/</a>). Nga takimi me studentët vlerësojmë që studentët e FSHN/DKI kanë akses pa pagesë në bibliotekën on-line, ULIBRARY.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Nga vizita në bibliotekë u konstatua që në dispozicion të përdoruesve (stafit dhe studentëve) janë katër kompjutera, me akses në internet dhe burimet online, të vendosur në dy fondet e hapura. Kjo evidentohet dhe në <b>evidencën 4.13.1</b> të paraqitur nga GVB.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të</p>	<p>UT në përgjithësi dhe FSHN në veçanti, harton buxhet posaçërisht për blerjen e literaturës së nevojshme bashkëkohore, specifike për programet e studimit (<b>Evidenca 4.5</b>).</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423


Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 56



bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	Sipas <b>evidencës 4.15</b> vërejmë se çdo vit, kërkohet prej njësave bazë të përcjellin nevojat për pasurimin e literaturës në fondin e bibliotekës, duke e përditësuar fondin ekzistues me botime të kohës, në mbështetje të programit të studimit. Nga shqyrtimi i <b>evidencës 4.5</b> në lidhje me projekt-buxhetet për vitet 2018 -2022 për pasurimin e fondit të literaturës së nevojshme, konstatojmë se bibliotekës së FSHN gjatë kësaj periudhe iu shtuan libra me një fond prej përkatësisht: 2'300'000 lekë; 2'174'000 lekë; 1'500'000 lekë dhe për 2021 - 2022 është planifikuar një fond prej 3'012'000 lekë. <i>Stafi akademik e DKI kërkojnë më shumë investime për literaturë më bashkëkohore.</i>			
<b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Biblioteka ofron shërbimin e saj për studentët dhe pedagogët çdo ditë të javës, e hënë - e premte (me përjashtim të ditëve zyrtare të pushimit), në tre ambientet e studimit e shërbimit. Orari është e Hënë – e Enjte: 8:00-16:30, e Premte: 8:00-14:00. Por sipas nevojës së studentëve (gjatë sezoneve) punohet dhe me dy turne ( <b>Evidenca 4.13</b> , rregullorja e funksionimit të bibliotekës). Nga takimi me studentët u vu re se ata e shfrytëzojnë literaturën e bibliotekës kryesisht për lexim në ambientet e saj. <i>Pedagogët e DKI kërkojnë më shumë investime për literaturë më bashkëkohore.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>  X

<b>Standardi IV.5</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Sekretaria mësimore e FSHN është përgjegjëse për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave për studentët që ndjekin programin e studimit Bachelor Kimi Industriale dhe Mjedisore. Mbështetur në materialet e paraqitura nga RVB, dhe vërejtjet gjatë vizitave në IAL, vërehet që sekretaria mësimore e FSHN funksionon duke u bazuar në <b>LAL Nr. 80/2015</b> dhe Rregulloren e Universitetit të Tiranës ( <b>evidenca 1.5 nenet 42, 64 dhe 69</b> ). Bazuar në <b>evidencat 3.18 dhe 4.19</b> të paraqitura nga GVB, pjesë mbështetëse e menaxhimit të informacionit në UT/FSHN, është dhe infrastruktura IT-së. Mbështetur në rregulloren e funksionimit të sekretarisë mësimore për FSHN dhe nga vizita e GVJ në sekretarinë mësimore të IAL vlerësojmë që sekretaria mësimore mban: Regjistrin themeltar me të dhëna personale të studentëve ( <b>Evidenca 3.37</b> ), Regjistrin e notave me vlerësimet e marra gjatë ndjekjes së programit të studimit ( <b>Evidenca 3.38</b> ), Librin e diplomave me të dhëna mbi diplomën ose diplomat e marra bashkë me suplementin e diplomës ( <b>Evidenca 3.39</b> ), Regjistrin e studentëve që plotësohet në formë të shkruar dhe elektronike dhe mbahet në ruajtje të përhershme. Sekretaria mësimore kishte të arshivuara: procesverbalet e provimeve ( <b>Evidenca 3.35</b> ), dosjet





	<p>e transferimeve prej dhe në programin mësimor (<b>Evidenca 1.20</b>), dosjet e programeve/lëndëve të ekuivalentuara për kategoritë transferim dhe degë të dyta të studimit, dosjet e diplomimit, statistikat e studentëve frekuentues, statistikat e studentëve që e humbasin statusin e studentit, statistikat e studentëve që ç'rregjistrohen, etj. Sipas rregullores të UT (<b>Evidenca 1.5, neni 41</b>), regjistrimi i informacionit të zhvillimit të orës mësimore (leksione dhe seminare) nga pedagogët e DKI në programin Bachelor "Kimi Industriale dhe Mjedisore" bëhet përmes Regjistrimit personal të Pedagogut (<b>Evidenca 1.14</b>). Sipas <b>evidencës 4.17</b> të paraqitur nga GVB, për periudhën e zhvillimit të mësimin online, gjatë pandemisë së COVID-19, evidentimi i aktivitetit mësimor të studentit është kryer përmes raporteve të siguruar nga platforma TEAMS.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Menaxhimi i informacionit dhe dokumentacionit të pedagogëve në UT realizohet nga Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme, Sektori i Burimeve Njerëzore (<b>Evidenca 4.1</b>) dhe Dega e Burimeve Njerëzore pranë FSHN. (<b>Evidenca 1.15</b>). Dosjet personale të stafit akademik (me kohë të plotë dhe të pjesshme), ndihmës-akademik dhe administrativ përmbajnë të gjitha dokumentet e rëndësishme për punësimin në UT (<b>Evidenca 4.2 dhe Evidenca 4.2.1</b>). Nga takimi me punonjësen e Degës së Burimeve Njerëzore gjatë vizitës së GVJ në IAL rezultoi që stafi dorëzon dosjet në dy kopje, njëra prej të cilave arkivohet në FSHN, ndërsa tjetra në Rektoratin e UT.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>UT-ja dhe njësitë kryesore i ruajnë dhe përpunojnë të dhënat e studentëve dhe personelit, në përputhje me Statutin e UT, (<b>Evidenca 1.1 neni 124</b>), dhe Udhëzuesin e Privatësisë (<b>Evidenca 4.18</b>) si dhe legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. UT nuk i transmeton ato palëve të treta, me përjashtim të rasteve kur është dhënë pëlqimi i zotëruesit në mënyrë të shprehur për një gjë të tillë. UT i mbron të dhënat personale nëpërmjet përdorimit të teknikave të avancuara dhe moderne për të ruajtur bazat e të dhënave dhe sistemet e saj kompjuterike. Sipas <b>evidencave 4.19 dhe 3.20</b> të paraqitura nga GVB si dhe nga takimet me stafin dhe studentët vlerësohet që çdo përdorues mund të shfrytëzojë informacionin e vet në sistemi e-Student UT vetëm duke u identifikuar në mënyrë unike sipas të drejtave në sistem, nëpërmjet llogarive personale.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Bazuar në <b>evidencën 4.11</b> të paraqitur nga RVB, konstatohet se për menaxhimin e informacionit, FSHN ka integruar platformën Teams. Në këtë platformë janë regjistruar të gjithë studentët që ndjekin programin e studimit dhe janë hapur të gjitha lëndët pjesë e PS të KIM. Pedagogu përgjegjës i lëndës administraton profilin e lëndës për të: hedhur materiale didaktike; dhënë detyra kursi; për të bërë vlerësimin e vazhduar; për të realizuar anketa të ndryshme; për të bërë njoftime, si edhe për të komunikuar me studentët për probleme specifike që lidhen me mësimdhënien. Komunikimi student-njësi administrative fakulteti realizohet përmes faqes zyrtare web të UT <a href="https://unitir.edu.al/">https://unitir.edu.al/</a> dhe FSHN <a href="https://fshn.edu.al/">https://fshn.edu.al/</a>. Në këto faqe studenti informohet në lidhje me: Fakultetin në tërësi (historikun, departamentet, programet e studimit, kriteret e pranimit, legjislacionin dhe rregulloret), projektet e</p>



	<p>përfunduara apo në zhvillim nga stafi akademik, doktoraturat e mbrojtura në secilin departament, aktivitetin shkencor të departamenteve, specifika të vitit akademik (strukturën akademike, grupet mësimore, orarin mësimor, tarifat e studimit, formularin e vlerësimit të lëndës nga studenti), njoftime të ndryshme me tematikë administrative (afate rregjistrimi në provime, bursat e studimit, etj.) apo akademike (thirrje të hapura për aplikim për bursa shkëmbimi në kuadër të programeve Erasmus+, Mevlana, etj.). Nga <b>evidenca 3.20</b> e paraqitur në RVB, dhe nga takimi me studentët, GVJ evidenton që komunikimi individual për çështje specifike realizohet përmes adresës së emailit personal të ofruar nga Universiteti për gjithë personelin akademik apo administrativ dhe studentët e rregjistruar.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>FSHN garanton monitorimin në kohë reale të aktivitetit akademik dhe administrativ për gjithë stafin (akademik dhe administrativ) dhe studentët që ndjekin programet e studimit të ofruara nga IAL, nëpërmjet domain-eve të vendosur në dispozicion si: Llogaritë personale (adresat zyrtare të emailit) për gjithë personat e mësipërm, sistemin Teams, faqen zyrtare web të FSHN dhe UT, Sistemit e-Student UT. Ku përditësohet në mënyrë të vazhduar i gjithë informacioni i duhur në lidhje me aktivitetin akademik dhe administrativ të gjithë Fakulteti si psh: Baza ligjore <a href="https://fshn.edu.al/">https://fshn.edu.al/</a>, informacioni i aktivitetit vjetor akademik dhe shkencor për gjithë personelin akademik për secilin Departament (publikimi i projekteve <a href="https://fshn.edu.al/info/projekte/">https://fshn.edu.al/info/projekte/</a>), doktoratura që udhëheqin <a href="https://fshn.edu.al/info/doktoratura/">https://fshn.edu.al/info/doktoratura/</a>, jetëshkrimet <a href="https://fshn.edu.al/departments/departamenti-i-kimise-industriale/personel/dr-sonila-vito/">https://fshn.edu.al/departments/departamenti-i-kimise-industriale/personel/dr-sonila-vito/</a>, planet mësimore <a href="https://fshn.edu.al/departments/departamenti-i-kimise-industriale/programmes/kimi-industriale-e-mjedisore-bsc/">https://fshn.edu.al/departments/departamenti-i-kimise-industriale/programmes/kimi-industriale-e-mjedisore-bsc/</a>, orari mësimor për çdo pedagog <a href="http://37.139.119.36:81/orari/pedagog/">http://37.139.119.36:81/orari/pedagog/</a>, etj.), njoftime të ndryshme në lidhje me zhvillimin e aktiviteteve shkencore nga Departamentet apo Dekanati/Rektorati <a href="https://fshn.edu.al/Notifications/the-power-shkenca-e-te-dhenave-dhe-teknologjia/">https://fshn.edu.al/Notifications/the-power-shkenca-e-te-dhenave-dhe-teknologjia/</a> etj. Bazuar në <b>evidencën 4.11.1</b>, vlerësojmë se për njoftime dhe informacione me specifike, tek grupime të kufizuar personash edhe takime online, shfrytëzohet sistemi TEAMS. Nëpërmjet sistemit informatik e-Student UT (<b>Evidenca 4.19</b>) personeli akademik ka mundësi të menaxhojë provimet, të aksesojë dokumente të tipit procesverbale me rezultatet e studentëve sipas sezonit përkatës, etj. Nga <b>evidenca 4.19.1</b> dhe nga takimi me studentët vlerësojmë që studentët kanë mundësi të verifikojnë arritjet e tyre akademike në mënyrë konfidenciale.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Departamenti i Kimisë Industriale publikon Informacionet e programit të studimit Bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore”, personelit akademik dhe çdo aktivitet i mundshëm që realizon dhe përditësohen në tre platforma: website-in e UT <a href="https://unitir.edu.al/cikli-i-i-bachelor/">https://unitir.edu.al/cikli-i-i-bachelor/</a>, website-in e FSHN <a href="https://fshn.edu.al/info/cikli-i-i-e-bachelor/">https://fshn.edu.al/info/cikli-i-i-e-bachelor/</a>, facebook-un <a href="https://fshn.edu.al/info/cikli-i-i-e-bachelor/">https://fshn.edu.al/info/cikli-i-i-e-bachelor/</a> e instagamin</p>



	<p>e Kimisë Industriale  <a href="https://www.instagram.com/kimi_industriale_dhe_mjedisore/">https://www.instagram.com/kimi_industriale_dhe_mjedisore//</a>  Për momentin gjuha e përdorur është ajo amtare (Shqip).  Mbështetur në <b>evidencën 4.28</b>, dhe nga takimet me stafin dhe GVB, vlerësojmë që përditësimi i informacionit të publikuar në faqen e web të FSHN, që lidhet drejtpërsëdrejti me DKI realizohet nga një pedagog i Departamentit.  <i>GVJ rekomandon që faqja e informacioneve për programin e studimit Bachelor "Kimi Industriale dhe Mjedisore", të jetë dhe në gjuhën angleze.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Niveli i përmbushjes</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi IV.6</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Duke shqyrtuar <b>evidencën 4.32</b> të paraqitur nga GVB, vlerësojmë që në mbështetje të nevojave që ka Departamenti për sigurimin e mbarëvajtjes së procesit mësimor edhe të sasisë së burimeve financiare të institucionit, UT vlerëson koston e çdo programi studimi, përfshirë edhe atë Bachelor "Kimi Industriale dhe Mjedisore". Sipas <b>evidencës 4.20</b> , konstatojmë që DKI harton çdo vit plan buxhetin respektiv për mbarëvajtjen e PS dhe ia dërgon Dekanatit, në bazë të të cilit administratori i FSHN harton më tej plan buxhetin e përgjithshëm të Fakultetit. Plan buxheti miratohet më tej nga Bordi i Administrimit të UT ( <b>Evidenca 4.5</b> ). Nga <b>evidenca 4.21</b> , vërehet se UT miraton çdo vit tarifat e shkollimit për çdo cikël studimi, dhe kjo tarifë është në përputhje të plotë me <b>VKM nr. 638 dt 22.07.2015 e ndryshuar</b> .
<b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të	Nga shqyrtimi i <b>evidencës 4.22</b> , të paraqitur në RVB, konstatojmë që në buxhetin e institucionit të miratuar nga Bordi i Administrimit UT përmbahen: Miratimi i detajimit të kuotave të buxhetit të konsoliduar (grant mësimdhënie, të ardhura UT), Miratimi i detajimit të shpenzimeve operative me burim nga të ardhurat, Miratimi i detajimit të investimeve në burim nga të ardhurat, Miratimi i numrit të planifikuar të punonjësve, Miratimi i njësive shpenzuese. Aty përfshihen: financimi i burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit të studimit ( <b>Evidenca 4.23</b> ), shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, regjistrimin në revista të ndryshme shkencore, detyrimet financiare të trashëguara nga një vit më parë, financimin për shërbimet nga të tretë, financimi për mbështetje të kualifikimit të stafit akademik dhe rritjes së cilësisë së mësimdhënies (pjesëmarrje në trajnime, seminare, botim artikujsh shkencorë, shërbime transporti,



studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.	udhëtimi brenda dhe jashtë vendit për realizimin e praktikave, etj.) qeramarrje, etj.			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.	Nga faqja zyrtare e UT në lidhje me strukturën organizative konstatojmë se UT ka të ngritur Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm ( <a href="https://unitir.edu.al/struktura-organizative/">https://unitir.edu.al/struktura-organizative/</a> ). Nga <b>evidenca 4.29</b> e paraqitur nga GVB, vërehet se kjo strukturë, që është në varësi funksionale nga Bordi i Administrimit, kryen auditim të përvitshëm si dhe i raporton në mënyrë të drejtpërdrejtë Bordit të Administrimit, bazuar në legjislacionin në fuqi për auditimin e brendshëm publik. Sipas Statutit të UT ( <b>Evidenca 1.1 nenet 54-57</b> ) realizon një audit vjetor në mënyrë të pavarur për të dhënë siguri objektive dhe për të ofruar këshillim për menaxhimin, për të përmirësuar veprimtarinë e Universitetit të Tiranës. Nga shqyrtimi i <b>evidencës 4.24</b> të paraqitur nga GVB, vlerësojmë që Dega e Financës harton raporte vjetore të cilat përmbajnë një pasqyrë të hollësishme të burimeve financiare dhe ndarjen e tyre sipas buxhetit respektiv të secilës njësi kryesore. Gjithashtu UT/FSHN auditohet ndër vite nga auditi i Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sportit dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit.			
<b>Kriteri 4.</b> Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.	Sipas <b>edvidencës 4.24</b> vërejmë se UT i dokumenton raportet financiare në fund të çdo viti akademik në degën e arkivë-protokollit. Mbi bazën e këtyre raporteve vjetore, UT harton programet buxhetore afatmesëm dhe afatgjatë, të cilët miratohen nga Senati i Universitetit. ( <b>Evidenca 4.25 dhe faqja respektive e web</b> ). Në zbatim të Programit të Transparencës ( <b>Evidenca 4.31</b> ), këto raporte por edhe informacione të tjera pasqyrohen në <b>faqen zyrtare web të UT</b> .			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.	Nga shqyrtimi i <b>evidencës 4.22</b> të paraqitur në RVB, vërejmë që UT harton planbuxhetet e detajuara për çdo vit duke u mbështetur në të ardhurat të qëndrueshme duke garantuar qëndrueshmëri financiare të mjaftueshme për realizimin e objektivave dhe misionit të saj. Nga <b>evidenca 4.26 (ose tabela 18 ASCAL)</b> dhe nga takimet në IAL vlerësojmë që UT/FSHN përdor si burime financiare: Grantin e buxhetit të shtetit, Të ardhurat e veta (tarifat e regjistrimit, tarifat e shkollimit), Të ardhura nga grantet për kërkim dhe kontrata.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				X




## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>PS Bachelor në “Kimi Industriale e Mjedisore”, ofrohet në përputhje me <b>LAL (nenet 73-74)</b> dhe aktet e tjera nënligjore në fuqi si dhe aktet rregullatore të nxjerra nga UT [Statutin e Universitetit të Tiranës (<b>evidenca 1.1</b>) dhe në Rregulloren e Programit të Studimit (<b>evidenca 1.6</b>)]. Ky program, është i organizuar në sistemin ECTS (gjithsej 180 ECTS) dhe kohëzgjatja normale e tij është 3 vite akademike.</p> <p>Përzgjedhja e studentëve dhe regjistrimi i tyre bëhet pranë sekretarisë mësimore në përshtatshmëri me udhëzimet e përvitshme të MASR. (<b>Evidenca 5.1</b>).</p> <p>Nga shqyrtimi i <b>evidencave 1.1; 1.6 dhe 1.5</b>, konstatohet se studentit të këtij PS i garantohet mundësia që të ndërpresë studimet, të transferojë studimet nëpërmjet ekuivalentimit, si dhe të ndjekë programe të dyta. Duke shqyrtuar Rregulloren e Programit të Studimit (<b>Evidenca 1.6</b>) si dhe programin e lëndëve, vërejmë që studentët pasi kanë plotësuar detyrimet akademike të 3 viteve diplomohen me provim formimi. Sipas <b>evidencës 1.8.3</b> vërejmë se në përfundim të programit të ciklit të parë studentëve u lëshohet diploma “Bachelor në Kimi Industriale e Mjedisore”.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat, dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Duke marrë parasysh Statutin e UT (<b>evidenca 1.1 nenet 7; 78; 125 dhe 126</b>), vlerësojmë që PS i studimit Bachelor në Kimi Industriale e Mjedisore është hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në zbatim të lirisë akademike, të drejtave dhe detyrimeve të stafit dhe të studentëve. Nga takimet me studentët ata pranojnë që ndihen të trajtuar në mënyrë të drejtë e të barabartë nga DKI/FSHN: Studentët kanë llogaritë elektronike personale në FSHN/UT, <a href="mailto:emer.mbiemer@fshnstudent.info/">emer.mbiemer@fshnstudent.info/</a> : <a href="mailto:emer_mbiemer.fshnstudent@unitir.edu.al/">emer_mbiemer.fshnstudent@unitir.edu.al/</a> që u mundësojnë akses në platformën Microsoft Teams si dhe të informohen për rezultatet etj.</p> <p>Studentët e këtij PS kanë të drejtë të ndjekin leksione, seminare dhe të gjitha veprimtaritë e tjera mësimore, të organizuara në përputhje me statusin e tij, si dhe të përdorin mjedise në biblioteka, salla kompjuterash dhe shërbime të tjera që ofrohen për studentët nga UT/FSHN/DKI.</p> <p>Në statutin e UT (<b>evidenca 1.1</b>) dhe në Statutin e këshillit studentor (<b>evidenca 5.2</b>) sanksionohet e drejta e studentëve për t’u zgjedhur dhe për të zgjedhur përfaqësuesin e tyre për në Këshillat studentorë.</p> <p>Në përputhje me ligjin për arsimin e lartë dhe Statutin e Universitetit studentët zgjedhin përfaqësuesin e tyre në Senatin akademik (<b>Evidenca 5.3</b>). Studentët në takim pranuan që i ushtronin këto të drejta, madje në takim kishte dhe anëtar të këshillit studentor.</p> <p>Në ambjentet e FSHN ishte e dallueshme zyra e Këshillit Studentor të fakultetit në një godinë njëkatëshe bashkë me zyrën e IT.</p>



	<p>Nga evidenca 1.29 evidentohet përfaqësimi i studentëve të UT në Këshillin e Etikës. Në <b>evidencën 1.30</b>, të paraqitur nga GVB, evidenohet fakti që në nivel institucional UT ka ngritur Komisionin për Mbarëvajtjen e Veprimtarisë dhe Marrëdhënieve me Studentët ku 3 anëtarë të këtij komisioni janë të zgjedhur nga radhët e studentëve aktiv.</p> <p>Në <b>evidencën 1.35</b> paraqiten pjesmarrje të studentëve të UT/FSHN në aktivitete shkencore. Studentët gjithashtu kanë të drejtë të marrin pjesë në aktivitete sociale që organizon UT/FSHN në bashkëpunim me këshillin studentor (<b>Evidenca 5.4</b>). Nga <b>evidencat 1.1 dhe 5.5</b> si dhe nga takimi që patëm me studentët e PS Bachelor Kimi Industriale dhe Mjedisore, GVJ konstaton se studentët e këtij programi studimi kanë përfituar të drejtën për bursa, si dhe dhe përjashtim apo reduktim nga tarifa e studimit, sipas kriterëve të vendosura nga ministria e Arsimit.</p> <p>Studentët kanë të drejtë: Të aplikojnë dhe pajisen me kartë studenti me anë të së cilës përfitojnë disa shërbime me çmim të reduktuar apo falas (<b>Evidenca 5.6</b>),</p> <p>Të aplikojnë për bursa Erasmus apo bursa të tjera mobiliteti [Studentët nga DKI të pranishëm në takim pranuan që ishin të informuar, kishin nga ata dhe që kishin fituar mabilitete],</p> <p>Të strehohen në konviktet e UT-së (Bashkisë Tiranë). Studentë pranuan që kishin marrë pjesë në anketat që realizohen nga zyra e NJSBC apo edhe të departamentit, duke shprehur opinionin për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit akademik.</p> <p>Nga takimi me studentët u evidentua fakti që ata kishin mundësi të merrnin çdo informacion të nevojshëm nga faqja elektronike e FSHN dhe nga kujdestari Akademik (<b>Evidenca 1.23, Evidenca 1.1</b>). Në FSHN studentët kanë të drejtë të këshillohet me psikologun (<b>Evidenca 5.7</b>), një mundësi që studentët e pranishëm pranuan që e kishin shfrytëzuar sidomos për të minimizuar stresin gjatë sezoneve të provimeve. Siç vërehet dhe në <b>evidencën 1.1 dhe 5.28</b>, si dhe nga takimi me studentët gjatë vizitës në IAL, vlerësojmë që studentët e FSHN/ DKI kanë të drejtë të marrin pjesë në aktivitetet sportive brenda dhe jashtë Universitetit.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Objektivat e këtij programi janë të qarta, të ndërtuara në përputhje me objektivat institucionale të përcaktuara në rregulloren e UT, (<b>Evidenca 1.5</b>). Studentët e këtij programi, gjatë ciklit të parë të studimit pajisen me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale në fushën e teknologjise kimike dhe mbrojtjes së mjedisit në përputhje me kërkesat e tregut të punës, dhe synohen të zgjerohen në programet e ciklit të dytë Master.</p> <p>Bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë, në Rregulloren e UT-së (<b>Evidenca 1.5</b>) dhe atë të programit të studimit Bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore” (<b>Evidenca 1.6</b>), përcaktohen qartë kriteret, procedurat e pranimit, transferimit, vlerësimit dhe diplomimit. Ato janë të qarta, të kuptueshme dhe të aksesueshme për publikun në faqen zyrtare të FSHN, në nënfaqet përkatëse. Studentët kanë dhe burime të tjera informimi ku përfshihen postera, broshura (<b>Evidenca 5.9</b>), faqet në rrjete sociale si facebook apo Instagram të programit të studimit KIM.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti</p>	<p>Përzgjedhja e kandidatëve për PS Bachelor në Kimi Industriale dhe Mjedisore, bëhet përmes aplikimit nga ana e kandidatëve të interesuar në</p>





<p>akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>web të RASH, sipas procedurave dhe afateve të vendosura nga MASR dhe brënda afatit të përcaktuar. Aplikimi për programin, renditja e studentëve, regjistrimet bëhen përmes procedurave të paraqitura në <b>(Evidenca 5.1; 5.10; 5.10.1 dhe 5.10.2)</b> dhe janë në përputhje me aktet e nxjerra, për çdo vit, nga MASR për këtë qëllim.</p>		
<p><b>Kriteri 5.</b> Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Në përputhje me <b>Ligjin Nr. 80/2015</b>, neni 25, pika 8 dhe <b>neni 74, VKM 436</b>, datë 03.06.2020 (<b>Evidenca 5.11</b>) si dhe Udhëzimit të përvitshëm të MASR si dhe Maturës Shtetërore, Departamenti Kimisë Industriale përcakton kriteret e përgjithshme dhe specifike për pranimin e kandidatëve. Nga shqyrtimi i <b>evidencës 1.22</b> vërejmë që DKI harton kriteret specifike për pranimin e studentëve në PS, duke u bazuar në peshën e lëndëve bërthamë dhe me zgjedhje, kritere të përshtatshme për programin e studimit KIM. Në zbatim të statutit të UT (<b>Evidenca 1.1</b>), DKI brenda datës 10 dhjetor të vitit paraardhës kalendarik, propozon kuotat për çdo vit akademik. Siç konstatohet nga <b>evidenca 1.21</b> parashikohen edhe kuota për studentë të trojeve dhe të huaj, për studentë që transferojnë studimet, për degë të dyta, persona me aftësi të kufizuara, minoritete etj. Kuotat, kriteret e pranimit dhe të përzgjedhjes së aplikantëve janë në përdhatshmëri me <b>VKM Nr. 418, datë 10.5.2017</b>, dhe përcaktohen në funksion të:</p> <p>a) Kapaciteteve fizike në dispozicion të programit të studimit; (<b>Evidenca 1.13, Evidenca 1.13.1, Evidenca 1.13.2</b>),</p> <p>b) kapaciteteve njerëzore (<b>Evidenca 1.17, Evidenca 1.16</b>); stafit pedagogjik dhe atij mbështetës, raporti i pedagogëve të brendshëm me ata të jashtëm, dhe niveli i kualifikimit shkencor të stafit akademik,</p> <p>c) zotërimit të mjeteve didaktike dhe burimeve të literaturës në funksion të metodave të mësimdhënies (<b>Evidenca 2.25</b>).</p> <p>Kuotat e propozuara nga DKI pasi miratohen nga dekani i FSHN dhe më tej në Senatin Akademik të UT, përcillen në MASR dhe publikohen në portalin <a href="https://ualbania.al/">https://ualbania.al/</a>.</p>		
<p><b>Kriteri 6.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>UT përpara fillimit të vitit akademik shpall kalendarin e ditëve të informimit për maurantët (<a href="https://unitir.edu.al/ditet-e-informimit-per-nxenesit-maurante-ne-universitetin-e-tiranes/">https://unitir.edu.al/ditet-e-informimit-per-nxenesit-maurante-ne-universitetin-e-tiranes/</a>). Në kuadër të informimit të kandidatëve për studentë DKI organizon takime të hapura ku përfaqësues akademik të departamentit zhvillojnë me maurantët në shkolla të mesme të vendit përfaqësues të stafit akademik, ndihmës-akademik dhe punonjës administrate duke vënë në dispozicion të drejtorive arsimore rajonale materiale dhe broshura (<b>Evidenca 5.9</b>) informuese programin e studimit, organizmin e institucionit, të drejtat dhe detyrat e studentit, jetën studentore etj. Gjatë pandemisë ky informim është kryer online (<b>Evidenca 5.12</b>). Kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të programit të studimit gjenden edhe në website-in e FSHN-së: (<a href="https://fshn.edu.al/info/kritere/">https://fshn.edu.al/info/kritere/</a>).</p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>



<b>Standardi V.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Në <b>evidencat 1.5; 1.6 dhe 1.8.3</b> janë të mirëpërcaktuara procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin, përkatësisht: a) numri i krediteve që i duhet një student të kalojë nga njëri vit akademik në tjetrin (<b>Evidenca 1.6</b>), b) Detyrimet për marrjen e diplomës (<b>Evidenca 1.6</b>), c) Diplomimin (<b>Evidenca 1.8.3</b>). Në websitet e FSHN-së (<b>Evidenca 1.23</b>) studentët gjejnë informacion të hollësishëm për PS si: Planin mësimor të të tre viteve (<b>Evidenca 1.7</b>), Syllabuset (<b>Evidenca 1.8.1</b>), Vlerësimi me notë sipas pikëve të marra. (<b>Evidenca 1.8.1</b>), Sezonet e provimeve: periudhat dhe kriteret (<b>Evidenca 2.17 dhe Evidenca 1.6</b>).</p> <p>Në çdo fillim viti akademik organizohet “Java e orientimit” me sesione orientuese për studentët ku titullarët e lëndëve dhe kujdestari akademik, sqarojnë më gjerësisht studentët për programin që do të ndjekin, strukturën dhe përmbajtjen e tij, të drejtat dhe detyrimet, praktikën mësimore, diplomimin, etj.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Në Statutin e UT-së (<b>Evidenca 1.1 nenet 108,109 fq 64</b>) dhe në rregulloren e programit të studimit Bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore” (<b>Evidenca 1.6</b>) janë të përcaktuara kriteret dhe procedurat në lidhje me njohjen e kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme, Transferimit të studimeve dhe Ndjekjes së programeve të dyta. Në zbatim të afateve të përcaktuara në <b>Udhëzimin 26, datë 30.07.2018 të MASR</b>, për shqyrtimin e kërkesave të aplikantëve, dekani fakultetit ngre komisionin <i>ad-hoc</i> i cili jep vlerësimin përfundimtar për ekuivalentimet e dosjeve dhe transferimet e aplikantëve (<b>Evidenca 1.27</b>).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Nga takimi që patëm me studentët e DKI, ata pranojnë se informohen rregullisht madje që në ditët e para nga stafi në lidhje me kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive, informacioni i cili gjendet mjaft i detajuar në syllabuset, tematikat e lëndëve, literatura që do përdoret, kërkesat e pedagogut, rregullat e integritetit akademik. Këto informacione gjenden edhe në syllabuset e lëndëve (<b>Evidenca 1.8.1</b>) të cilat janë të shpallura dhe në faqet zyrtare të FSHN/ DKI.</p> <p>Njohuritë e përfuara nga studenti kontrollohen dhe vlerësohen me pikë përmes një kombinimi të vlerësimit të vazhduar gjatë semestrit dhe dhe vlerësimit përfundimtar në provime që zhvillohen sipas afateve të përcaktuara në kalendarin akademik (<b>Evidenca 2.17</b>) duke zbatuar integritetin akademik (<b>Evidenca 1.6</b>). Studentët marrin informacione të vazhdueshme nga pedagogu i lëndës, mbi Vlerësimet e zhvilluara gjatë semestrit si: frekuentimi, vlerësimi në provimet e ndërmjetme, vlerësimi i aktivizimit në seminare, detyra kursi mbahen në regjistrin e pedagogut (<b>evidence 1.5 pjesa 4 neni 41 rregullorja e UT</b>). (<b>Evidenca 1.15 e</b></p>



	<p>shënuar nga GVB ska vend) (evidenca 1.14 paraqet modelin e regjistrit të pedagogut).</p> <p>Në rregulloren e PS (Evidenca 1.6 nenet 32-34) dhe rregulloren e UT të rishikuar (Evidenca 1.5 nenet 50 dhe 51) janë të sanksionuara të drejtat e studentëve për ankimim të procedurave dhe rishikim të provimeve. Studenti ka të drejtë të njihet me pikët totale të vlerësimit në tezë, si dhe me pikët në çdo rubrikë, si dhe të drejtën e ankimimit brenda 48 orëve nga shpallja e rezultateve. Në takimin me studentët e programit të studimit Bachelor në KIM, studentët pranuan se pedagogët i njoftojnë për çdo vlerësim gjatë semesrit. Ata pranuan që u është dhënë mundësia të rishikojnë provimet, dhe në raste të veçanta kanë ushtruar dhe të drejtën e ankimimit. Studentët pranuan që pedagogët dhe drejtuesit e departamentit janë treguar korrekt në vlerësimet e provimeve dhe në konsiderimin e ankimimeve. Nga takimi në sekretarinë mësimore GVJ konstatoi që vlerësimet e vazhduara dokumentoheshin të ndara nga procesverbalet e provimeve dhe mendojmë që do ishte më mirë që vlerësimi i vazhduar të përfshihej në të njëjtin proces verbal me atë të provimit përfundimtar.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p><i>Në kurrikulën e Programit të Studimit Bachelor në Kimi Industriale dhe mjedisore nuk parashikohet punimi i diplomës (Evidenca 1.8.2) dhe (Tabela 9 ASCAL). Në fund studimet kurorëzohen me provim diplome i cili vlerësohet me 4 kredite. Në evidencën 1.8.5 paraqitet programi i provimit të diplomës me të cilën studentët pajisen dhe me anë të cilit ata orientohen me lëndët profesionale dhe tematikat ku bazohet hartimi i tezës së provimit të diplomës.</i></p> <p>Në rregulloren e DKI (Evidenca 1.6 nenet 38 dhe 39) dhe në rregulloren e diplomimit (Evidenca 1.8.3) janë të sqaruara rregullat dhe procedurat e diplomimit të studentëve me të cilat DKI i informon paraprakisht studentët.</p> <p><i>Nga shqyrtimi i Statutit të UT (Evidenca 1.1 neni 89 pika 3) cilësohet që studentët e UT sipas kriterëve të vendosura për notën mesatare mund të diplomohen me provim të përgjithshëm përfundimtar ose me punim diplome. Mundësia e punimit të diplomës nga studentët e ciklit të parë jepet dhe në Rregulloren e UT (Evidenca 1.5 neni 60).</i></p> <p><i>Ndërkohë në rregulloren e programit të studimit Bachelor "Kimi Industriale dhe Mjedisore" (evidenca 1.6 neni 39 pika a), cilësohet që studentët e këtij Programi Studimi mund të diplomohen vetëm me provim të përgjithshëm. GVJ rekomandon të rishikohet rregullorja e PS Bachelor "Kimi Industriale dhe mjedisore" në përputhje të plotë me statutin e UT, dhe për tu dhënë mundësinë studentëve të ekselencës që të kenë mundësinë e punimit të temave të diplomës. Kjo kërkon të shoqërohet dhe me rregullimet e tjera përkatëse.</i></p> <p><i>Në takimet me stafin e IAL u diskutua dhe për mungesën e një punimit të diplomës për studentë me rezultate të larta, ku nga ana e tyre argumentohej me faktin e një kohe të reduktuar, meqë semestri i gjashtë është planifikuar i plotë në auditor.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë</p>	<p>UT në bashkëpunim me Drejtorinë Arsimore, përmes Drejtorisë së Edukimit të Ciklit I dhe II, Sektorit të Këshillimit dhe Karrierës, Alumni-</p>



<p>periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>t dhe me njësitë bazë/kryesore të UT-së, përpara fillimit të çdo viti akademik (para plotësimit të formularëve të aplikimit të maturantëve) organizon ditë të hapura për publikun Info Day, (<a href="https://unitir.edu.al/ditet-e-informimit-per-nxenesit-maturante-ne-universitetin-e-tiranes/">https://unitir.edu.al/ditet-e-informimit-per-nxenesit-maturante-ne-universitetin-e-tiranes/</a>). Gjatë ditëve të hapura, pedagogë dhe studentë të FSHN/DKI takojnë gjimnazistë dhe prindër të interesuar për të vazhduar studimet në programet mësimore të FSHN/DKI dhe i informojnë (<b>Evidenca 5.12</b>) ata mbi natyrën dhe kërkesat e programeve të studimit, mundësitë e shkollimit dhe punësimit në këto programe. UT/FSHN dhe DKI hartojnë broshura të posaçme (<b>Evidenca 5.9, Evidenca 5.9.1</b>), që përmbajnë informacion i detajuar për çdo program studimi në përgjithësi si dhe për PS Bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore” dhe i shpërndajnë këto broshura gjatë takimeve me maturantët.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

<p><b>Standardi V.3</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve dhe mundësitë e punësimit</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p>	<p>Nëpërmjet programit të PS (<b>Evidenca 1.7</b>) dhe syllabuseve të lëndëve (<b>Evidenca 1.8.1</b>), të hartuara sipas tipit të <b>Tabelës 14 ASCAL</b>, studentët informohen mbi planin mësimor, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit Bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore” lëndët/ modulet që zhvillohen, detyrimet semestrale dhe vjetore, kohëzgjatjen e programit të studimit, diplomimin. Këto informacione studenti i merr nëpërmjet: faqes zyrtare të FSHN/ DKI, takimeve kujdestar-student si dhe nga komunikimet me personelin akademik. Që në fillim të studimeve studenti njihet me Rregulloren e PS Bachelor në Kimi Industriale dhe Mjedisore (<b>Evidenca 1.6</b>), ku janë të shprehura ndër të tjera dhe informacionet e për kohëzgjatjen, detyrimet dhe kushtet e diplomimit. Në çdo fillim semestri pedagogët e lëndëve, mbështetur në syllabuset e lëndës (<b>Evidenca 1.8.1</b>), informojnë studentët në lidhje me lëndët/ modulet, kreditet, ngarkesën mësimore, frekuentimin, vlerësimin, tematikat, literaturën bazë apo dhe atë të rekomanduar. Gjatë takimit të GVJ me studentët, këta të fundit konfirmuan se i kanë marrë rregullisht informacionet për lëndët përkatëse.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për modulet,</p>	<p>Në Statutin e UT (<b>evidenca 1.1 neni 127</b>) cilësohet që IAL vë në dispozicion të informimit të studentëve një personel akademik në cilësinë e kujdestarit akademik. Kjo evidentohet dhe në <b>evidencën 1.23</b>, të paraqitur nga GVB. Në takimin që GVJ pati me studentët, gjatë vizitës në IAL konstatoi që studentët kontaktonin me kujdestarin e akademik i cili orientonte vazhdimisht përgjatë gjithë ciklit të studimit.</p>



<p>lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Siç evidentohet nga <b>evidenca 4.16 (kreu III neni 6)</b> një rol të veçantë në informimin e studentëve të ciklit të parë luan dhe Sekretaria Mësimore. Sekretaria mësimore ndjek, informon dhe mbështet çdo student që nga regjistrimi deri në diplomim, nëpërmjet pajisjes së tyre me çdo vërtetim akademik të nevojshëm, si listë notash apo suplement të diplomës (<b>Evidenca 1.8.4</b>).</p> <p>FSHN ka në strukturën e vet Degën e IT-së e cila mundëson mirëfunksionimin e website të FSHN/ DKI-së, nëpërmjet informacioneve të përditësuara me njoftime <a href="https://fshn.edu.al/notifications/">https://fshn.edu.al/notifications/</a> : për zhvillimin dhe mbarëvajtjen e procesit mësimor si orari mësimor (<b>Evidenca 2.21</b>), orari i sezonit të provimeve (<b>Evidenca 5.13</b>), aplikime për bursa brenda dhe jashtë vendit (<b>Evidenca 5.14 dhe Evidenca 5.15</b>), aktivitete shkencore (<b>Evidenca 1.38</b>) dhe sociale që zhvillohen brënda apo jashtë institucionit (<b>Evidenca 5.28</b>).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>	<p>Në organigramën e FSHN funksionon dhe Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK) (<b>Evidenca 1.15</b>). Kjo njësi ndihmon studentët, ajo organizon takime të hapura për këshillimin e karrierës (<a href="https://fshn.edu.al/notifications/leksioni-hapur-me-teme-keshillimi-i-karrieres/">https://fshn.edu.al/notifications/leksioni-hapur-me-teme-keshillimi-i-karrieres/</a>), në hartimin e CV model, si dhe orienton dhe këshillon mbi intervistat e punësimit (<b>Evidenca 6.22</b>).</p> <p>Në kuadër të akreditimit të parë institucional (<b>Evidenca 1.9.1</b>) UT ka realizuar studimin e tregut të punës (<b>Evidenca 1.10</b>).</p> <p>Në <b>evidencën 1.10</b> (studimi i tregut të punës për vitet 2014-2017) tregohet që studentët që diplomohen në FSHN kanë një shkallë punësimi mbi 50%. Punësimin e të diplomuarve rezulton 43% në sektorin privat dhe 22% në sektorin shtetëror (<b>Evidenca 1.10</b>).</p> <p>Në <b>evidencën 1.11</b> jepet një model pyetësori i hartuar në nivel departamenti, në lidhje me punësimin e studentëve. Nga rezultatet e pyetësorëve (<b>Evidenca 1.11.1</b>), një pjesë e vogël e studentëve që mbarojnë bachelorin punësohen meqë pjesa më e madhe e tyre vazhdojnë studimet në master në departamentin e kimisë industriale, dhe 24% e studentëve që vazhdojnë studimet Master janë të punësuar me kohë të plotë ose të pjesshme kryesisht në sektorin privat.</p> <p>Nga shqyrtimi i <b>evidencave 1.16; 1, 19.1 dhe 1.18 (CV të personelit)</b>, vërejmë që DKI është në vetvete një burim punësimi i studentëve të tij përkatësisht si personel akademik efektiv, personel akademik i jashtëm, personel ndihmës akademik. Për informimin e studentëve mbi mundësitë dhe perspektivën e degës “Kimi Industriale dhe Mjedisore” në vendin tonë, DKI organizon takime të hapura me studentët e PS (<b>Evidenca 1.36</b>). FSHN/ DKI ka nëshkruar marrëveshje me institucione të ndryshme me institucione shtetërore apo me firma të ndryshme private (<b>Evidenca 1.33</b>), të cilat krahas mbështetjes për realizimin e procesit mësimor, shërbejnë si pika të mundshme për punësimin e studentëve që përfundojnë studimet në programet e studimit që ofron ky departament.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë</p>	<p>Që në fillim të studimeve, studentëve u vihet në dispozicion gjithë informacionin e nevojshëm për institucionin dhe infrastrukturën e</p>



dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	FSHN-së ( <b>Evidenca 1.13</b> ). Në çdo fillim viti akademik studentët njihen me orarin mësimor ( <b>Evidenca 2.21</b> ) dhe strukturën akademike për vitin akademik përkatës ( <b>Evidenca 2.17</b> ) dhe para çdo sezoni provimesh ato njihen me grafikun e provimeve ( <b>Evidenca 5.13</b> ).			
<b>Kriteri 5</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.	Në websitet e FSHN-së studentët mund të informohen dhe përditësohen mbi tarifatat e studimit, listës së notave, çertifikatës së notave, vërtetimit të studentit, programit të studimit shqip dhe anglisht. Në rregulloren e sekretarisë mësimore ( <b>Evidenca 4.16</b> ) përcaktohet mbështetja e studentëve nga sekretaria me regjistrimin e tyre në sezonet e provimeve dhe informimin mbi ecurinë dhe detyrimet e tyre akademike. Një suport të mirë për studentët jep dega e IT e FSHN. Sistemi i menaxhimit të informacionit funksionon në bazë të rregullores për "Funksionimin e sistemit informatik të UT" datë 31.03.20141205 ( <b>Evidenca 3.18</b> ). Për shkak të pandemisë gjatë 2 viteve të fundit mësimi u krye në distancë. UT/FSHN përdorën platformën në Microsoft Teams, ku sistemi i IT hartoi udhëzues të posaçëm për orientimin e studentëve dhe pedagogëve për përdorimin e saj ( <b>Evidenca 3.3 dhe Evidenca 3.4</b> ). Kjo platformë përpos zhvillimit të procesit mësimor, shërbeu si një burim komunikimi midis pedagogëve dhe studentëve në lidhje me procesin mësimor pasi institucioni mundësoi pajisjen me adresa të gjithë studentëve ( <b>Evidenca 3.5 dhe Evidenca 3.20</b> ). Njoftimet e rëndësishme mbi organizimin dhe zhvillimin e procesit mësimor afishohen në faqen elektronike të fakultetit ( <a href="https://fshn.edu.al/notifications/">https://fshn.edu.al/notifications/</a> ).			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Plot përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi V.4

**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.	Në tabelen 23 ASCAL ( <b>evidenca 5.17</b> ) paraqiten të dhënat për numrin e studentëve të diplomuar në PS "Bachelor "Kimi Industriale dhe Mjedisore" përkatësisht: 60 për vitin 2018-2019, 72 për vitin 2019-2021 41 për vitin në 2020-2021. Sekretaria mësimore e FSHN-së mban dhe disponon të dhëna për dosjet e diplomimit: verifikimin e plotësisht të kushteve për diplomim, proces-verbalet e vlerësimit në provimin e diplomës, listat e të diplomuarve të përcjellë në Rektorat për miratim, fotokopjet e diplomave të tërhequra.



	<p>Të gjithë këto dokumenta, janë origjinale, dhe ruhen në Sekretarinë mësimore, në zbatim të ligjit të mbrojtjes së të dhënave personale dhe “Udhëzuesit mbi privatësinë në Universitetin e Tiranës” (<b>Evidencat 5.18 dhe 4.18</b>). Në bazë të këtij dokumentacioni original lëshohen tërë vërtetimet e kërkuara nga studentët, administrata e UT dhe MASR.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Gjatë vizitës në IAL vizituam dhe ambientet e Sekretarisë Mësimore. Sekretaria mësimore kishte të arshivuar: dosjet e regjistrimit të studentëve, me dokumentacion sipas udhëzimeve të përvitshme të MASR (<b>Evidenca 5.1</b>), dosjet e transferimeve prej dhe në programin mësimor (<b>Evidenca 5.19, Evidenca 1.20.1</b>), statistikat e studentëve që ç’regjistrohen (<b>Evidenca 1.28</b>). Në këto evidenca (<b>Evidenca 5.19, Evidenca 1.20.1</b>) vërehet se për tri vitet akademike 2018-2019; 2019-2020; dhe 2020-2021, në programin e studimit Bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore” nuk ka asnjë rast transferimi. Numri i studentëve të regjistruar në regjistrin themeltar, në programin Bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore” është në përshtatshmëri me numrat e paraqitur në <b>Tabelën 21 ASCAL Evidenca 5.19</b> përkatësisht: 100 për 2018-2019; 98 për 2019-2020; dhe 52 për vitin akademik 2020-2021.</p> <p><i>Nga GVJ u konstatuan 3 studentë të pamatrikulluar dhe u kërkuar arsyetim dhe dokumentacion shtesë në lidhje me komunikimet përkatëse me QSHA për këto raste. Nga dokumentacioni i paraqitur nga sekretaria me kërkesën e GVJ, vërehet që njëri nga studentët është çrregjistruar (paraqitet dokumenti i çrregjistrimit). Dy studentët e tjerë nuk kanë frekuentuar dhe nuk kanë pika kontakti.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>Sekretaria mësimore krahas regjistrimit themeltar të studentëve (<b>Evidenca 3.37</b>) arshivon dhe regjistrin e arritjeve akademike (<b>Evidenca 3.38</b>) të cilat plotësohen në bazë të procesverbaleve me rezultatet e testeve të njohurive të studentëve (<b>Evidenca 3.35</b>). Institucioni harton raporte vjetore për ecurinë e studentëve duke mbajtur statistika mbi studentët e shkëlqyer dhe kalueshmërinë. (<b>Evidenca 1.28 fq 30-31; viti 2018-2019</b>).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Të dhënat për ecurinë akademike të studentëve mbahen dhe ruhen korrektësisht nga Sekretaria Mësimore e FSHN.</p> <p>Të dhënat statistikore mbi procesin mësimor të studentëve, të përmendura me lart, menaxhohen nëpërmjet sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit (<b>Evidenca 4.18</b>), janë të sigurta, respektojnë ligjin e mbrojtjes së të dhënave personale (<b>Evidenca 5.18</b>), si edhe garantohet siguria e tyre përmes platformave mbrojtëse (firewall, etj). Në sekretarinë mësimore ruhen dhe procesverbalet e provimeve (<b>Evidenca 3.35</b>) dhe riprovimeve të firmosura nga pedagogët e lëndës dhe janë në dispozicion të studentëve dhe pedagogëve për transparencë sa herë që është e nevojshme, si dhe shërbejnë si dokumente zyrtare nga të cilët derivohet plotësimi i vlerësimeve akademike të studentit në regjistrin e sekretarisë.</p> <p>Sistemi i menaxhimit të informacionit mbështet edhe përmes Sistemit E-Student, ku studentët me anë të adresës së tyre të emailit</p>



<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>informohen në kohë reale për vlerësimet e tyre akademike (<b>Evidenca 4.19</b>).</p> <p>Institucioni harton raporte vjetore vlerësimi me të gjithë elementet përbërës të tij në zbatim të <b>Udhëzimit të MASR VKM NR. 41, DATË 24.1.2018 (Evidenca 2.1)</b> dhe vendimeve të SA (<b>Evidenca 5.16</b>).</p> <p>Në raportet vjetore të vlerësimit (<b>Evidenca 1.28/ raporti vjetor për vitin 2019-2020 fq 127 dhe raporti vjetor 2020-2021 fq 115</b>) jepet ndër të tjera informacion për ecurinë vjetore të studentëve nëpërmjet treguesve të mëposhtëm: a) studentëve të shkëlqyer b) % e studentëve të diplomuarve, c) % e kalueshmërisë. Në <b>evidencën 6.14</b> paraqiten anketa që janë bërë për pedagogët në lidhje me analizën që ata japin për rezultatet e studentëve në lëndët e tyre, duke dhënë ndryshime të syllabusit duke shfrytëzuar hapësirën me 20% që u jep ligji <b>LIGJ Nr. 80-2015</b> kreu IV neni 35/9 (<b>Evidenca 2.30</b>). Këto ndryshime janë në funksion edhe të ndryshimit të metodologjisë së vlerësimit për t'i nxitur studentët të jenë më aktiv përgjatë gjithë ciklit të mbulimit të lëndës/ modulit.</p> <p>Edhe nga takimet që patëm me stafin dhe GVB u vu në dukje që ka një tendencë në rritje të vlerësimeve të vazhduara të studentëve sidomos në lidhje me pikët në laboratore.</p> <p>Një ndër treguesit e cilësisë së mësimdhënies në analizë është edhe mesatarja e shkollës së mesme tek të regjistruarit në program që është një mesatare relativisht mesatare:</p> <p>për vitin 2018-2019 është 7.77;  për vitin 2019-2020 është 8.11  për vitin 2019-2020 është 7.94. mbi 7.7  për vitet 2018-2021</p> <p>(<b>Tabela 21 ASCAL, evidenca 5.19 evidencat 5.29</b>), kalueshmëria dhe cilësia e vlerësimit sipas lëndëve.</p> <p>Në FSHN vepron dhe zyra e Karrierës/ Alumnit (sipas organigramës DBSCK) (<b>evidenca 1.15</b>) si strukturë përgjegjëse për kontaktet me studentët e diplomuar për të mbledhur informacion për cilësinë e punësimit të tyre në funksion të diplomës që ata kanë marrë.</p> <p>DBSCK harton pyetësor për studentët e diplomuar (<b>Evidenca 6.12; Evidenca 6.13</b>) ku mbledh statistika mbi vetëvlerësimin e studentëve në lidhje me: a) njohuritë në programin e studimit. b) aftësitë komunikuese c) aftësitë ndërpersonale d) aftësitë menaxhuese.</p> <p>Në pyetësorë studentët komentojnë dhe bejnë sygjerimet e tyre për përmirësimin e kurrikulës si dhe japin informacion nëse ofertat për punë lidhen me profesionin.</p> <p>Bazuar në raportin e zyrës së karrierës referuar anketave të diplomuarve DKI harton planin e masave (<b>Evidenca 6.9</b>) për t'iu përgjigjur dhe përshtatur sygjerimeve të diplomantëve. <i>Vërehet një rënie e numrit të studentëve të regjistruar në PS bachelor në "Kimi Industriale dhe Mjedisore" (nga 100 në 2018-2019 në 52 në 2020-2021, Tabela 21 ASCAL), si dhe atyre të diplomuar në vite (nga 60</i></p>
---	--



	në 2018-2019 në 41 në 2020-2021, (Tabela 23 ASCAL; evidenca 5.17).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Mbështetur në Statuti e UT (evidenca 1.1 neni 125 pika 1 dhe 2), studentët e Universitetit të Tiranës kanë të drejtë të marrin pjesë në proceset e vendimmarrjes, në përputhje me përcaktimet e bëra në ligjin për arsimin e lartë. Studentët përfaqësohen në senatin e Universitetit dhe në 4 komisione si më poshtë : Senatin Akademik të UT, 4 anëtarë të SA janë studentë të UT (Evidenca 5.3), Komisionin e mbarëvajtjes së veprimtarisë dhe marrëdhënieve me studentët ku janë 3 anëtarë përfaqësues të studentëve (Evidenca 1.30), Komisioni i përhershëm për sigurimin e standardeve të cilësisë ka 3 anëtarë përfaqësues të studentëve. (Evidenca 1.1 neni 41; Tabela 24 ASCAL), Komisionin e përhershëm të kurrikulës ku ka 2 anëtarë përfaqësues të studentëve (Evidenca 1.1 neni 42), Këshilli i etikës ka 2 anëtarë përfaqësues të studentëve (Evidenca 1.1 neni 43).</p> <p>Nga vizitat e GVJ u konstatua se në ambjentet e FSHN kishte ambjent të dedikuar për Këshillin Studentor të fakultetit dhe nga bisedat me studentët këto këshilla ishin funksionale.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Nga evidencat 5.21; 5.22 dhe 5.23 evidentohet se studentët e UT/FSHN kanë krijuar këshillat studentore në nivel institucioni dhe njësie kryesore përmes një procesi zgjedhor të administruar nga KIZS (Komisioni Institucional Zgjedhor i Studentëve), komision i ngritur bazuar në vetëkandidim të studentëve.</p> <p>Këshillat e studentëve kanë mandat 2-vjeçar dhe anëtarët e tyre zgjidhen nga votat e të gjithë studentëve të njësisë kryesore. Rregullat në lidhje me procesin e votimit përcaktohen në rregulloren përkatëse dhe miratohen në Senatin Akademik (Evidenca 5.24).</p> <p>Në evidencën 5.20 paraqitet se si në grupin për vlerësimin e brendshëm të programit të studimit dhe në vlerësimin për akreditimin e vetë institucionit ka dhe përfaqësues të studentëve dhe kjo tregon për përfshirjen e studentëve në proceset e vetëvlerësimit institucional.</p> <p>Nga ana tjetër vetë Grupi i Vlerësimit të Brendshëm të PS ka një anëtar nga rradhët e studentëve. Evidencat 6.10; 6.11 dhe 6.15 tregojnë që zëri i studentëve të UT/FSHN/DKI dhe të vetë programit Bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore” mund të transmetohet edhe nëpërmjet pyetësorëve që u adresohen atyre në lidhje me vlerësimin e procesit mësimor dhe proceseve të tjera akademike.</p>



	<p>Së fundmi UT/ FSHN ka hapur dhe portalin “Vlerëso Pedagogun” ku studentët mund të shprehin vlerësimin e tyre (<a href="https://vleresopedagogun.al/">https://vleresopedagogun.al/</a>).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore” ka një kohëzgjatje prej 3 vitesh akademike, në gjashtë semestra, me 15 javë mësimore semestri, përveç semestrit të VI që ka 14 javë mësimore. (<b>Evidenca 1.6, Evidenca 1.8, Evidenca 2.35</b>)</p> <p>Ngarkesa mësimore hartohet në përputhje me specifikimet që bëhen në <b>VKM.41 datë 24.01.2018</b> dhe ndryshimet ose shtesa që janë bërë në të (<b>Evidenca 2.1</b>).</p> <p>Këtu përfshihen: 1. Specifikime për termat: a) Diploma b) Lëndë c) Laborator d) Seminar e) Modul f) Praktikë g) Provim i përgjithshëm</p> <p>2. Elementët që përbëjnë strukturën e programeve të studimit, të ofruara nga IAL-të si: a) Kreditet ECTS b) Plan mësimor c) Syllabus d) Diploma e) Suplementi</p> <p>3. Orët e mësimimit për kredite dhe orët individuale të mësimimit për secilën lëndë të pasqyruara dhe në sylabuset përkatëse të lëndëve. (<b>Evidenca 1.8.1</b>).</p> <p>Nga shqyrtii i <b>evidencës 2.21</b> vërehet që orari mësimor i këtij programi studimi hartohet duke pasur gjithmonë në fokus një shpërndarje uniforme të ngarkesës mësimore përgjatë javës mësimore dhe në përshatshmëri me <b>VKM.41 datë 24.01.2018</b> (me një numër orësh në auditor jo më shumë se 25 në javë).</p> <p>Në Statutin e UT (<b>evidenca 1.1</b>) dhe në Rregulloren e Universitetit të Tiranës (<b>evidenca 1.5</b>), është parashikuar njohja e studimeve të mëparshme përmes transferimit të krediteve të përfutura në një IAL tjetër. Në <b>evidencën 1.20</b> paraqiten procedura të ndjekura nga FSHN për njohjen e transferimit të krediteve për programe të ndryshme të fakultetit (jo të PS Bachelor në Kimi Industriale dhe Mjedisore).</p> <p>Në <b>Tabelën 21 ASCAL</b> vërehet që për vitet 2018-2021 në PS Bachelor në Kimi Industriale dhe Mjedisore nuk kemi asnjë transferim studentësh, kjo lidhet dhe me faktin që ky program studimi është unik në vend.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimin të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Në statutin UT (<b>Evidenca 1.1</b>) sanksionohet përfshirja e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimin të programit të studimit nëpërmjet përfaqësimit të tyre në Komisionet e UT-së. (<b>Evidenca 1.29, shih dhe kriterin 1 të standardit V.5</b>).</p> <p>Siç konstatohet nga <b>evidenca 1.23</b> studentët kanë një pedagog që ka funksionin e kujdestarit të tyre akademik i cili ndër të tjera ka për mision përçimin e çdo problemi të studentëve tek autoritetet përkatëse, sipas kompetencës së tyre.</p> <p>Nga takimi me studentët ata pranuan që problemet dhe sygjërimet e studentëve në lidhje me programin e studimit ata i prezantojnë nëpërmjet kujdestarit akademik si dhe Këshillit të studentëve dhe përfaqësuesve të tyre në Senatin Akademik, si Organ legjitim i zgjedhur nga votat e studentëve, mund ti adresojë senatit akademik dhe komisionit të vlerësimit të kurikulave, të vetëvlerësimit dhe të etikës reflektimet. Studentët pranuan që kishin marrë pjesë në plotësimin e</p>



	pyetësorë që zhvillohen nga DSBCK (online ose dhe fizikisht, <b>Evidenca 6.10, Evidenca 6.11, Evidenca 6.12</b> ) si edhe nga vetë departamenti duke shprehur vlerësimet dhe sugjerimet e tyre në lidhje me Programin e Studimit. DKI i diskuton rezultatet e këtyre pyetësorëve në raportimeve vjetore dhe harton planin e masave për përmirësimin e treguesve të cilësisë ( <b>Evidenca 6.9</b> ).								
<b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/ pedagogut përgjegjës.	Duke shqyrtuar <b>evidencën 1.5 (nenet 50 dhe 51)</b> dhe <b>evidencën 1.6</b> , përkatësisht rregulloren e UT dhe Rregulloren e Programit të Studimit Bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore” si dhe nga takimi me studentët thëmi se: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Studenti ka të drejtë të ankohet për procedurën e zhvillimit të provimit.</li> <li>• Studenti ka të drejtë të ankohet për rezultatin përfundimtar të provimit.</li> </ul> Studentët e pranishëm në takim me GVJ pranuan që tezat e provimit janë përgjithësisht të hartuar me pyetje të të gjithë niveleve dhe ata njihen drejtpërdrejt me vlerësimet. Studentë pranuan që e kanë ushtruar të drejtën e ankimimit dhe kanë marrë zgjidhje dhe mirëkuptim nga Përgjegjësi i Departamentit dhe nga stafi si dhe nga Dekanati.								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<b>Standardi V.6</b>	
<b>Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	DKI bashkëpunon me sekretarinë mësimore, kujdestarët akademikë ( <b>evidencat 1.1 dhe 1.23</b> ), degën e IT, zyrën e financës (shërbimi i bursave) për informimin e studentëve mbi PS, përmbajtjen dhe organizimin e tij, kohëzgjatjen e studimeve dhe afatin e përfundimit, akreditimin si dhe Degën e Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës DSBCK ( <b>evidenca 1.15</b> ) që orienton studentët për mundësitë për punësim pas diplomimit, kalendarin akademik, fillimin dhe mbarimin e vitit akademik, pushimet/festat zyrtare, sezonet e provimeve, etj.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Në faqen zyrtare të web për FSHN/ DKI studentët marri gjithë informacionet e nevojshme në lidhje me: <ol style="list-style-type: none"> <li>Strukturën akademike;</li> <li>Guidën e Fakultetit;</li> <li>Orarin mësimor;</li> <li>Pedagogët e departamentit;</li> <li>Programin mësimor;</li> <li>Syllabuset;</li> <li>Këshillin studentor;</li> <li>Adresat e tyre në FSHN për kontakt me personelin akademik.</li> </ol> 2. Sekretaria mësimore dhe sektori i IT mbështet studentët në përditësimin e shërbimeve akademike që nga regjistrimi deri në diplomim ( <b>Evidenca 4.16</b> ).



	<p>3. Kujdestari për marrëdhëniet me studentët (<b>Evidenca 1.23</b>) orienton në mënyrë intensive studentët e sapo regjistruar të vitit të parë për të gjitha njësitë e informimit dhe shërbimit të tyre, të drejtat dhe detyrimet e tyre dhe çdo informacion specifik të nevojshëm për përfshirjen sa më të shpejtë në jetën e tyre studentore.</p> <p>Këshilli studentor FSHN organizon aktivitete informuese për studentët e viteve të para në lidhje me funksionimin e Fakultetit dhe degëve të studimit (<a href="https://fshn.edu.al/notifications/aktivitet-nga-keshilli-studentor-me-teme-sesioni-informues-per-studentet-viteve-te-para-ne-fshn-se">https://fshn.edu.al/notifications/aktivitet-nga-keshilli-studentor-me-teme-sesioni-informues-per-studentet-viteve-te-para-ne-fshn-se</a>).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/ njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Nga Organigrama e FSHN (<b>evidenca 1.15</b>) vërehet se në FSHN është ngritur Degën e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK) e cila mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, i informon dhe orienton në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale, përgatitjen e studentëve për intervista pune, shkrimin e CV model, letër motivimi si dhe këshillim për orientim më të mirë në karrierën e tyre. <a href="https://api.fshn.edu.al/uploads/Leksion_i_Hapur_15_04_2022_42657_d3f0d.pdf">https://api.fshn.edu.al/uploads/Leksion_i_Hapur_15_04_2022_42657_d3f0d.pdf</a>.</p> <p>Për të ndihmuar studentët në një përfaqëse më të mirë ndaj tregut të punës si dhe për mundësi punësimit dhe internship UT/ FSHN organizon Panairt e Karrierës (<b>evidenca 5.25</b>), ku marrin pjesë, subjekte publike dhe kompani private, të cilat u ofrojnë studentëve pozicionet e tyre vakante. UT synon të përfshijë studentët në periudha shkëmbimi në univesitetet partnere të BE duke ndihmuar formimin e tyre dhe aftësimin më tej në tregun e punës (<a href="https://unitir.edu.al/java-europes-ne-universitetin-e-tiranes-2019/">https://unitir.edu.al/java-europes-ne-universitetin-e-tiranes-2019/</a>).</p> <p>Departamenti i Kimisë Industriale ruan kontaktet me studentët e diplomuar duke i informuar dhe ftuar në konferenca apo aktivitete shkencore që vetë departamenti organizon apo është pjesëmarrës (<b>Evidenca 1.37</b>).</p> <p>Në ndihmë të studentëve të FSHN është dhe psikologjia (<a href="https://fshn.edu.al/info/zyra-e-psiokologut/">https://fshn.edu.al/info/zyra-e-psiokologut/</a>) e cila ofron konsulta dhe këshilla studentëve në funksion të përmirësimit të arritjeve akademike, përshtatjes së jetës universitare, menaxhimit të emocioneve dhe përballimit të sfidave. Studentët në takim pranuan që kishin mundësi për shërbimin e psikologut dhe madje e kishin shfrytëzuar sidomos për këshillim për përballimin e stresit gjatë sezoneve të provimeve.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Zyra e karrierës/ Alumni (<b>Evidenca 5.31</b>) sipas Organigramës së FSHN (<b>evidenca 1.15</b>) DSBCK, mban kontakte të herëpashershme me të diplomuarit për të përditësuar të dhënat e tyre, si dhe për të ndjekur cilësinë e punësimit të tyre (<b>Evidencat 5.26 dhe 5.27</b>).</p> <p>DSBCK organizon aktivitete (<b>Evidenca 5.32</b>) ku anëtarët e rrjetit japin informacione, këshilla karriere dhe mbështetje në formimin profesional të studentëve aktual.</p> <p>Kjo doli në pah edhe nga takimi me përfaqësuesen e DSBCK gjatë vizitës në IAL.</p>



Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht



## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Duke vlerësuar Strategjinë e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës 2018-2023, UT është angazhuar për sigurimin e cilësisë në të gjitha fushat e veprimtarisë së tij (<b>evidenca 1.2</b>). Mbështetur në Statutin e Universitetit të Tiranës (<b>evidenca 1.1</b>) janë ngritur strukturat për Sigurimin e Cilësisë. Për të arritur këtë qëllim, Senati Akademik i UT ka miratuar Manualin e Sigurimit të Cilësisë, si dhe procedurat për zbatimin e tij (Rregulloren e Sigurimit të Cilësisë dhe Paketën e Instrumentave të Cilësisë) (<b>evidencat 6.1; 6.2; 6.3 dhe 6.4</b>).</p> <p>Nga shqyrtimi i <b>evidencës 1.30 dhe Tabela 24, ASCAL</b>, vërehet se UT ka ngritur gjithashtu strukturat në nivel institucioni, si Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë (KPSSC), Komisionin e Kurrikulës etj si dhe Njesitë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) (<b>evidenca 1.1</b>), në Njesitë Kryesore (FSHN) DSBCK (<b>evidenca 1.15</b>). Sipas vendimit Nr. 39 të Bordit të Administrimit, dt. 04.04.2018, “Për miratimin e buxhetit për vitin 2018”, pika 2, “Miratimi i strukturave për Njesitë e UT-së (<b>evidenca 6.5</b>), Fakulteti i Shkencave të Natyrës (FSHN) ka ngritur DSBCK, e cila luan rolin e Njesisë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë në nivel Njësie Kryesore. Nga takimi me përfaqësuesen e DSBCK, nga <b>evidenca 1.1 neni 140, fq. 73-74 dhe evidenca 6.7</b>, si dhe faqja e web të FSHN vlerësohet se kjo degë, në bashkëpunim me zyrën e Zv. Dekanit për kurrikulat e Ciklit të Parë dhe Ciklit të Dytë të Studimeve, organizon pyetësonin studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi dhe harton raportet përkatëse.</p> <p>Në nivel institucioni, UT ka ngritur gjithashtu Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë (KPSSC) dhe Komisionin e Kurrikulës etj. (<b>Evidenca 1.29, Evidenca 3.7</b>), funksionet dhe detyrat e të cilave sanksionohen në Statutin e UT (<b>evidenca 1.1</b>).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>UT ka ngritur strukturën përgjegjëse të ngarkuar nga Senati Akademik për garantimin e standardeve të cilësisë të institucionit dhe programeve të studimit KPSSC. Ky komision përbëhet nga 11 anëtarë, 8 anëtarë personel akademik dhe 3 anëtarë studentë. FSHN përfaqësohet në këtë komision nga 1 anëtar personel akademik (<b>evidenca 1.29</b>). Sipas (<a href="https://unitir.edu.al/struktura-organizative/">https://unitir.edu.al/struktura-organizative/</a>) dhe referuar <b>Tabelës 24 ASCAL</b>, UT ka krijuar Sektorin e Sigurimit të Cilësisë (<b>Evidenca 3.7</b>), që punon për zbatimin e politikave mbi cilësinë dhe që mbështet me veprimtarinë e saj KPSSC dhe NJSBC në njesitë kryesore.</p>



	<p>Nga <b>evidenca 1.15</b> (Organigrama e FSHN) për të siguruar dhe garantuar mbikëqyrjen dhe vlerësimin e brendshëm në FSHN, bazuar në vendimin Nr. 39 të Bordit të Administrimit dt. 04.04.20181368 (<b>evidenca 6.5</b>), është ngritur Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK). DSBCK dhe ka autonomi operative, ka akses në të gjitha të dhënat e Njësisë Kryesore, është në varësi të Dekanit të FSHN dhe aktualisht operon me dy punonjës me kohë të plotë, një kryetar dhe një specialist (<b>Tabela 24 ASCAL, evidenca 3.7</b>).</p> <p>Veprimtaria e DSBCK bazohet në <b>evidencat 6.1; 6.2; 6.3 dhe 6.4</b>.</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Në dt. 27.10 2018 (<b>evidencat 1.9 dhe 1.9.1</b>), në përmbushje të detyrimeve ligjore (<b>LAL Nr. 80/ 2015 Neni 104</b>), Universiteti i Tiranës i është nënshtruar procesit të akreditimit periodik institucional të UT-së, që ka rezultuar me vlerësimin përfundimtar pozitiv dhe akreditimin institucional me kohëzgjatje prej 4 vitesh akademike.</p> <p>Në zbatim të vendimit të Senatit Akademik Nr. 26, dt. 21.10.2020 (<b>evidenca 6.6</b>), UT planifikon përgatitjen e raportit vjetor mësimit-kërkimor analizën e programeve të studimit dhe kurrikulave dhe përmirësimin e tyre në masën 20%, përdorimin e dokumentacionit të unifikuar të instrumentave të vlerësimit dhe të sigurimit të cilësisë etj. Sipas <b>evidencës 6.6.1</b> konstatojmë që UT ka hartuar dhe plan veprimin 4 vjeçar (2021-2024) për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Për të mundur vlerësimin e brendshëm, DSBCK në FSHN, bazuar në tipet e pyetësorëve të ofruara nga paketa e instrumentave (<b>Evidenca 6.4</b>), fton studentët në mënyrë periodike të plotësojnë pyetësorët/formularët. Në <b>evidencën 6.7</b> paraqitet ftesa e bërë studentëve për plotësimin e formularit të vlerësimit të lëndëve të programit. DKI harton gjithashtu, analizat vjetore të reflektuar në <b>evidencën 3.12</b> (vitet 2018-2021), ku ndër të tjera në to përfshihen dhe analizat e tipeve të pyetësorëve të realizuar gjatë vitit akademik bashkë me konkluzionet përkatëse.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>Sipas <b>evidencës 1.1</b>, në Statutin e Universitetit të Tiranës, kreu <b>X, nenet 138-141</b>, janë përshkruar qartë procedurat e posaçme për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve që ofrohen. Gjithashtu UT ka hartuar Rregulloren e Sigurimit të Cilësisë, ku janë përcaktuar procedurat, afatet, instrumentat dhe burimet për sigurimin e brendshëm të cilësisë (<b>evidenca 6.3</b>).</p> <p>Në kuadër të përmirësimit të cilësisë DKI, harton pyetësorë periodikë dhe realizon në mënyrë të përvitshme analizat vjetore të punës së tij (<b>evidenca 3.12</b>), duke e bërë praktikë pune vlerësimin e cilësisë në nivel Njësie Bazë.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbyhet pjesërisht</p>	<p>Përmbyhet kryesisht</p>	<p>Përmbyhet plotësisht</p>	<p><b>X</b></p>



<b>Standardi VI.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.	Nga <b>evidencat 1.29 dhe 3.7</b> vlerësojmë se strukturat e posaçme për monitorimin dhe mbështetjen e programeve mësimorë në nivel institucioni (UT) janë Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë (KPSSC) dhe Komisioni Përhershëm i Kurrikulës. Për të siguruar dhe garantuar sigurimin e cilësisë të programeve të studimit të ciklit të parë në nivel Fakulteti është ngritur Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK) ( <b>Evidencat 1.15 dhe 6.5</b> ). Në kuadër të monitorimit, shqyrtimit, mbikëqyrjes dhe rishikimit të programeve të studimit të ciklit të parë, DKI bashkërendon punën me Zv/ dekanët dhe përpilojnë Raportet Vjetore të Njesisë Kryesore ( <b>evidenca 1.28</b> raportet vjetore për vitet 2018-2021) të hartuara në bazë të analizave vjetore të Njesive Bazë ( <b>evidenca 3.12</b> ).
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.	FSHN/ DKI shqyrton programet e studimit nëpërmjet raporteve vjetore të veprimtarisë institucionale të UT ( <b>evidencat 5.20 dhe 6.6</b> ) si dhe raportet vjetore të fakultetit/ departamentit ( <b>evidencat 1.28 dhe 3.12</b> ) të cilat analizojnë procesin mësimor me të gjithë komponentët e tij dhe analizat e kërkimit shkencor. Departamenti i Kimisë Industriale (mbështetur në legjislacionet në fuqi) ka ndjekur procedura standarde për ndryshime në programin e studimit Bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore” ( <b>evidencat 2.29; 2.30; 2.31 dhe 2.32</b> ). FSHN/ DKI organizon në fund të çdo semestri dhe para sezonit të provimeve, plotësimin i pyetësorit studentor për cilësinë e mësimdhënies, për lëndët e çdo programi studimi dhe në përfundim të tij hartohet dhe zbatohet një plan masash, për përmirësimin e mëtejshëm të programeve mësimore ( <b>evidencat 6.8 dhe 6.9</b> ).
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.	DBSCK në bashkëpunim me Dekanatin realizon pyetësorët e përvitshëm, të cilët janë të parashikuar dhe njëhsuar në paketën e instrumentave ( <b>Evidenca 6.4</b> ). Në FSHN realizohen këto pyetësorë: Në përfundim të çdo semestri; pyetësori “Vlerësimi i lëndës nga studentët” ( <b>evidenca 6.4</b> ), i aksesueshëm, nëpërmjet faqes zyrtare të web të FSHN, vetëm nga studentët që kanë llogari elektronike aktive të FSHN. Gjatë sezonit të diplomimit në muajin Korrik realizohen dy pyetësorë: Pyetësori i parë, “Vlerësimi i studentëve që diplomohen” ( <b>evidenca 6.4</b> ), në lidhje me cilësinë e programeve të studimit dhe pyetësori i dytë “Raport i studentëve” ( <b>evidenca 6.4</b> ), ku studentët e diplomuar të japin përshtypjet/ vlerësimin e tyre në lidhje me cilësinë e arsimit në FSHN/ UT. Në përfundim të çdo semestri, parashikohet pyetësori “Raport i vetëvlerësimit të lëndës nga pedagogu” ( <b>evidenca 6.4</b> ), ku secili anëtar i personelit akademik bën një vetvlerësim/analizë të lëndëve ku janë titullarë, bazuar në përqindjen e kalueshmërisë të studentëve dhe shpërndarjes së notave në përqindje.



	<p>Pyetësorët e realizuar paraqiten si: Statistika në nivel programi studimi (<b>evidenca 6.10</b>), Statistika në nivel lëndësh për programet e studimit (<b>evidenca 6.11</b>), Raport mbi pyetësorin: “Vlerësim i studentëve që diplomohen” (<b>evidenca 6.12</b>). Pyetësorët janë shpërndarë tek studentët fizikisht (hardcopy) dhe materialet janë të depozituara pranë zyrës DSBCK. Raport i vetëvlerësimit të lëndës nga pedagogu (<b>evidenca 6.14</b>). Raport mbi pyetësorin: “Për vlerësimin e mësimdhënies “online””, (<b>evidenca 6.15</b>). Raporti i vlerësimit të lëndëve nga studentët, (<b>evidenca 6.19</b>). Senati Akademik të UT me Vendimim Nr.51, dt. 23.12.2020 ka miratuar Manualin e Cilësisë, Rregulloren e Sigurimit të Cilësisë në UT, si dhe Paketën e Instrumentave (<b>evidenca 6.1</b>) të cilat bëjnë të mundur unifikimin dhe standardizimin e pyetësorëve. Të gjitha këto shërbejnë si instrumente të rëndësishëm për FSHN/ DKI për përmirësimin e mëtejshëm të veprimtarisë akademike dhe programeve mësimore, aty ku shihet e arsyeshme.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Çdo fund viti akademik, Departamenti i Kimisë Industriale harton analizat vjetore (<b>Evidencat 3.12</b>), të cilat përdoren më tej për raportet vjetore në nivel fakulteti (<b>Evidenca 1.28</b>).</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.</p>	<p>Analizat vjetore në nivel departamenti (<b>Evidenca 3.12</b>) dhe raportet vjetore në nivel fakulteti (<b>Evidenca 1.28</b>) përmbajnë vlerësimin e mbarëvajtjes së programeve të studimeve, me elementët matës të mëposhtëm: Numri i studentëve të regjistruar për çdo vit akademik, Numri i studentëve të diplomuar për çdo vit akademik, Studentë të shkëlqyer, Studentë të çregjistruar, Plotësimi i standarteve të stafit akademik/ artikuj të botuar, pjesëmarrjet në konferenca, projekte etj. Sponsorizimet për konferencat dhe artikujt, Përmirësimi i standarteve të ambienteve/ didaktikës laboratorike (përmirësimi i strukturës laboratorike), Përqindja e kalueshmërinë dhe përqindja e të diplomuarve, Ngarkesa mësimore e personelit akademik, Konkluzionet e pyetësorëve të studentëve të cilat hartohen në raporte analitike të detajuara nga DSBCK, të cilat përfshijnë rezultatet e pritshme dhe ato të vlerësimit si dhe adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë të programeve. Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës bën të njohura raportet e saj vjetore duke i bërë publike në faqen elektronike të FSHN. Përmirësimin të cilësisë së programeve, në UT/FSHN u shërben dhe Manuali i Vlerësimit të Performancës të Personelit Akademik (<b>Evidencat 6.17 dhe 6.18</b>), si dhe Rregullorja “Mbi vlerësimin e performancës në punë të personelit ndihmës akademik dhe administrativ në Universitetin e Tiranës” e miratuar në parim me Vendim të Rektoratit Nr. 3, datë 24.01.202 (<b>Evidenca 6.19</b>).</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p>X</p>



<b>Standardi VI.3</b>	
<b>Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>Pjesë e vlerësimit të brendshëm të programit të studimit “Bachelor” “Kimi Industriale dhe Mjedisore ” janë: Analizat vjetore të hartuara në nivel Departamenti (<b>Evidenca 3.12</b>), dhe raportet vjetore në nivel Fakulteti (<b>Evidenca 1.28</b>), të cilat më tej përdoren për raportet vjetore në nivel universiteti.</p> <p>Raportet/ analizat e përvitshme të pyetësorëve (<b>Evidencat 6.10; 6.11; 6.11.1; 6.12; 6.13; 6.14 dhe 6.15</b>), të hartuara dhe realizuara nga Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe e Karrierës.</p> <p>Raportet vjetore të DSBCK. (<b>faqe zyrtare web FSHN</b>).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Raporti i Vetvlerësimit institucional, i realizuar në kuadër të akreditimit të parë të UT në vitin 2018 ka shërbyer si një burim i rëndësishëm informacioni për Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë (KPSSC), Komisionin e Kurrikulës dhe strukturat e tjera të institucionit që angazhohen në përmirësimin e cilësisë.</p> <p>Në funksion të përmirësimit të cilësisë së programeve të studimit, UT ka miratuar: Manualin e Sigurimit të Cilësisë, si dhe procedurat për zbatimin e saj (<b>Evidencat 6.1, 6.2, 6.3, 6.4</b>).</p> <p>Manualin e Vlerësimit të Performancës të Personelit Akademik (<b>Evidencat 6.17 dhe 6.18</b>).</p> <p>Miratimi në përparim i Rregullores “Mbi vlerësimin e performancës në punë të personelit ndihmës akademik dhe administrativ në Universitetin e Tiranës” (<b>Evidenca 6.19</b>)</p> <p>Krijimin e DSBCK (<b>evidenca 6.5</b> dhe <a href="https://fshn.edu.al/Info/dega-e-sigurimit-te-brendshem-te-cilesise-dhe-karrieres/">https://fshn.edu.al/Info/dega-e-sigurimit-te-brendshem-te-cilesise-dhe-karrieres/</a>) si njësi operative në funksion të sigurimit të brendshëm të cilësisë.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndër-institucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>FSHN/ DKI, në kuadër të realizimit, mbarëvajtjes dhe cilësisë së programeve të studimit, përdorin këto metoda të drejtpërdrejta për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies: Departamenti i Kimisë Industriale çdo vit harton Raportet dhe Analizat Vjetore (<b>Evidenca 3.12</b>) të cilat vlerësojnë mbarëvajtjen e PS, në gjithë elementët matës si tek <b>kriteri 5 i standartit 6.2</b>, të cilat raportohen më tej në raportet vjetore të FSHN (<b>evidenca 1.28</b>), Dekanati kryen kontrollin mbi zhvillimin e procesit mësimor (<b>Evidencat 3.10</b>), DSBCK realizon pyetësorët e përvitshëm dhe harton analizat përkatëse (<b>Evidencat 6.10; 6.11; 6.12; 6.13; 6.14; dhe 6.15</b>), DSBCK harton raportet vjetore mbi vlerësimin e cilësisë, (<b>Evidencat 6.20 dhe 6.21</b>) dhe i bën ato publike në web. Përgjegjësit e Departamenteve, në bashkëpunim me Titullarët e Grup-Lëndëve (<b>Evidenca 2.13</b>) mbikqyrin dhe monitorojnë respektimin e programeve të mësimdhënies, kërkimeve shkencore dhe veprimtarive të tjera të zhvillimit të programit, Performanca e stafit akademik (<b>Evidencat 3.11</b>). Në raport e paraqitur nga GVB cilësohet “Çdo vit</p>



	<p>akademik realizohen ndryshimet në masën 20% të planeve mësimorë” të dokumentuar në <b>evidencat 2.29: 2.30 dhe 2.31</b>.</p> <p>Nga takimi që patëm me GVB dhe me stafin e DK arritëm në konkluzionin që ndryshimet deri në masën 20% bëhen kur shihet e nevojshme nga vlerësimet e pyetësorëve; vlerësimet e kërkesave të tregut; nga nevoja për të përfshirë në programe arritje të reja në disiplinat përkatëse si dhe në kuadër të modernizimit për t’iu afruar programeve të ngjashme ndërkombëtare, duke marrë në konsideratë dhe përvojën e stafit gjatë kualifikimeve jashtë vendit.</p> <p>Nga shqyrtimi i <b>evidencës 2.31</b> vërehet që ndryshimet e bëra konsistojnë në ndryshimin e emërtimeve të lëndëve për të përshtatur më mirë programin e lëndës me emërtimin, ndryshime në raportet midis seminareve dhe laboratoreve.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>FSHN/ DKI në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metodat dhe instrumentet të tërthorta vlerësimi me anë të pyetësorëve si më poshtë.</p> <p>Pyetësori “Vlerësimi i studentëve që diplomohen” (<b>Evidenca 6.12</b>, gjatë sezonit të diplomimit muaj Korrik).</p> <p>Studimi i Tregut në nivel institucional (UT) (<b>Evidenca 1.10</b>, të anketuarit nga të gjithë fakultetit duke përfshirë dhe studentët e FSHN/DKI).</p> <p>Hartimi i një raporti të hollësishëm mbi tregun e punës për studentët e diplomuar në UT, përfshirë edhe studentët e FSHN.</p> <p>FSHN ka hartuar pyetësor për gjurmimin e studentëve pas diplomimit (<b>Evidenca 5.26</b>) me anë të të cilëve studentët evidentojnë vështirësitë e punësimit, përfshirë me programin e studimit, format e punësimit, nevojën për trainime pas universitare për t’u përshtatur më mirë në tregun e punës, etj. (<b>Evidenca 5.27</b>).</p> <p>Studimin e tregut të punës nga DKI (<b>Evidenca 1.11.1</b>) duke tërhequr në këtë mënyrë mendimin e studentëve të diplomuar.</p> <p>Realizimi i pyetësorit në fund të çdo semestri “Raport i vetëvlerësimit të lëndës nga pedagogu” (<b>Evidenca 6.4 dhe 6.14</b>), ku personeli akademik jep më tej mendimin e tij kritik për lëndët dhe ndryshimet në përputhje me standardet dhe kërkesat e ASCAL.</p> <p>Sipas Rregullores “Mbi vlerësimin e performancës në punë të personelit ndihmës akademik dhe administrativ në Universitetin e Tiranës” (<b>Evidenca 6.19</b>), personeli ndihmës akademik dhe administrativ në UT përfshihet në procesin e vlerësimit të programit.</p> <p><i>Pavarësisht nga puna e bërë deri tani duhet me shumë vëmendje në lidhje me studimin e tregut për punësimin e studentëve që mbarojnë bachelorin sepse evidencat kanë më shumë informacione për ata që mbarojnë edhe masterin në DKI.</i></p> <p><i>Duhet që një pjesë e punësimeve të jenë nëpërmjet zyrës së karrierës në saj të marrëveshjeve me të interesuar dhe panireve të karrierës.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	



**Standardi VI.4**

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Në <b>nenin 7 pika 3</b> të Statutit të UT (<b>Evidenca 1.1</b>) theksohet se, bazuar në lirinë akademike, autonominë financiare dhe organizative, UT lidh marrëveshje me persona juridikë, publikë dhe privatë, vendas ose të huaj, për zhvillimin e veprimtarive mësimdhënëse, kërkimore shkencore, kualifikuese, inovative, duke mundësuar kështu përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p> <p>Edhe në strategjinë e zhvillimit të UT për periudhën 2018-2024 fq 4 (<b>Evidenca 1.2</b>) theksohet që UT, për sigurimin e cilësisë për programet që ofron, do t'i kushtojë rëndësi marrëveshjeve të bashkunitimit me IAL të vendit dhe të huaja.</p> <p>Në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë <b>kreu X, nenet 138-141 të statutit të UT (Evidenca 1.1)</b>, përshkruhen qartë procedurat e posaçme për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve që ofrohen. Në Rregulloren e Sigurimit të Cilësisë të UT (<b>Evidenca 6.3</b>) janë përcaktuar procedurat, afatet instrumentat dhe burimet për sigurimin e brendshëm të cilësisë.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palët të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Bazuar në <b>evidencën 1.29</b> studentët janë të angazhuar në sigurimin e brendshëm të cilësisë nëpërmjet përfaqësimit në: Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë, me 3 anëtarë (<b>evidenca 3.7 ose Tabela 24 ASCAL</b>), mbështetur në <b>nenin 41</b>, statuti i UT, (<b>Evidenca 1.1</b>), Komisioni i Përhershëm i Kurrikulës, me 2 anëtarë, përfaqësues të studentëve (<b>neni 42, statuti i UT, evidenca 1.1</b>). Gjithashtu studentët angazhohen në vlerësimin e programeve akademike si dhe në vlerësimin institucional si pjesë e Grupeve të Vlerësimit të Brendshëm (<b>Evidencat 3.25 dhe 5.20</b>).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Njësia Kryesore, FSHN ka përfaqësuesit e saj në Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë (KPSSC) dhe Komisionin e Përhershëm të Kurrikulës (<b>Evidenca 1.29, Evidenca 3.7 ose Tabela 24 ASCAL</b>) dhe në Komisionin e Promovimit Akademik (<b>Evidenca 1.29</b>). Në nivel Njesie Kryesore, për të siguruar dhe garantuar sigurimin e cilësisë së programeve të studimit të ciklit të parë dhe të dytë, është ngritur (DSBCK) (<b>Evidencat 1.15 dhe 6.5</b>) e cila luan funksionin e Njesisë të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel fakulteti. Studentët e FSHN/ DKI janë të përfshirë në procesin e sigurimit të cilësisë së programit mësimor nëpërmjet: Anketimeve periodike nga DSBCK, Marrjes së mendimeve dhe propozimeve nga Këshilli Studentor, Takimeve me Kujdestarët e programit.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj</p>	<p>Nga takimi me studentët dhe Rregullorja e DSBCK (<b>Evidenca 6.21</b>), vlerësimi i cilësisë së programit të studimit, realizohet nga studentët e çdo kursi në mënyrë anonime duke ruajtur konfidencialitetin e tyre dhe duke respektuar lirinë dhe etikën akademike si dhe <b>Ligji Nr. 9887 datë</b></p>



diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	<b>10.03.2008</b> , ndryshuar me <b>ligjin Nr. 48/ 2012</b> “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.			
<b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe përshtatjen e vazhdueshme me kërkesat e tregut e punës, nëpërmjet ndarjes së eksperiencave midis bashkëpunëtorëve, ekspertëve të jashtëm dhe Alumni, UT/ FSHN organizon Panairët e Karrierës ( <b>Evidenca 5.25</b> ). Në këto panairë marrin pjesë subjekte publike dhe kompani private të cilat i ofrojnë studentëve pozicionet e tyre vakante dhe japin ekspertizën dhe mendimet e tyre në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj. Në bashkëpunim me Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme si dhe me delegacionin e Bashkimit Europian në Shqipëri UT ka realizuar aktivitetin “Java e Europës në Universitetin e Tiranës” ( <b>Evidenca 5.25</b> ), duke synuar përfshirjen e studentëve në periudha shkëmbimi në univesitetet partnere të BE duke ndihmuar aftësimin më tej në tregun e punës si dhe fitimin e eksperiencave në funksion edhe të përmirësimit të programeve mësimore.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>X</b>

<b>Standardi VI.5</b>	
<b>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Në faqet zyrtare të web (në nënfaqet përkatëse), në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, UT/FSHN bën transparente dhe publike, për studentët dhe të gjithë të interesuarit, politikën, strategjinë, organizimin dhe veprimtaritë për të gjitha programet e studimit. Në këtë kontekst, UT ka krijuar programin e transparencës, i cili është publik në linkun <a href="https://unitir.edu.al/programi-i-transparencës-2//">https://unitir.edu.al/programi-i-transparencës-2//</a> . UT/ FSHN ofron transparencë dhe publikon nëpërmjet postimit në faqen elektronike zyrtare të fakultetit/ universitetit: Analizën e Pyetësorëve, Statutin e UT, Rregulloren UT, Vendime të Senatit Akademik, Vendime të Bordit të Administrimit, aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë, etj. Krahas botimeve në faqet zyrtare përkatëse të UT/ FSHN të gjitha materialet u bëhen me dije departamenteve përmes shkresave zyrtare.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Nga UT/ FSHN/DKI, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave <b>Nr. 531, dt. 11.09.2018</b> , “Për Miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”, janë përpiluar raportet e analizës së pyetësorëve të studentëve për cilësinë e mësimdhënies ( <b>Evidencat 6.13; 6.14; 6.15; 6.16; 6.17; 6.18 dhe 6.19</b> ). Informacioni i publikuar në raporte, respekton lirinë dhe etikën akademike si dhe <b>Ligjin Nr.9887 dt. 10.03.2008</b> , ndryshuar me <b>ligjin Nr. 48/2012</b> “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.



<p><b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Bazuar në rezultatet e vlerësimit të pyetësorëve (<b>Evidencat 6.8 dhe 6.12</b>) vërehet se Departamenti i Kimisë Industriale ka hartuar planin e masave (<b>Evidenca 6.9</b>) për të gjithë tipet e pyetësorëve të realizuar dhe ka adresuar dobësitë apo mangësitë e evidentuara në raportet analitike duke synuar përmirësimin e mangësive dhe dobësive të evidentuara .</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Në strategjinë e zhvillimit të UT (<b>Evidenca 1.2</b>), theksohet se një prej objektivave të tij është përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së programeve të studimit. Në Planin e Masave të hartuar nga DKI (<b>Evidencat 6.8 dhe 6.9</b>), parashikohen rishikimi dhe përmirësimi i syllabuseve dhe planeve mësimore, shtimi i aktiviteteve ekstrakurrikulare, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në programin e studimit. Nga takimet në IAL u theksua rritja e peshës së vlerësimit të laboratrive në vlerësimin e studentëve gjatë vitit, si një përpjekje për rritjen e cilësive profesionale të studentëve të PS Bachelor në Kimi Industriale dhe mjedisore.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Mbështetur në <b>evidencën 6.21</b> dhe në informacionet e faqes zyrtare të DSBCK <a href="https://fshn.edu.al/info/dega-e-sigurimit-te-brendshem-te-cilesise-dhe-karrieres-vleresojme-qe-fshn/dsbck">https://fshn.edu.al/info/dega-e-sigurimit-te-brendshem-te-cilesise-dhe-karrieres-vleresojme-qe-fshn/dsbck</a>, në bashkëpunim me Këshillin Studentor, organizon aktivitete dhe leksione të hapura, informuese me personelin akademik si dhe me studentët, me qëllim ndërgjegjësimin e studentëve mbi rëndësinë e pjesëmarrjes së tyre në procesin e përmirësimit të cilësisë së programeve të studimit.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>		<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b></p>		<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>
---	--	-------------------------------------	------------------------------------	---



**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore” të Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti i Tiranës”.**

**Pikat e forta dhe afirmime:**

1. Programi i studimit Bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore”, në nivel kombëtar është një program unik. Ai ka një eksperiencë shumë vjeçare dhe është i strukturuar në përshtatshmëri me tregun e sotëm të punës.
2. Departamenti i Kimisë industriale përbëhet nga një staf me kualifikim të lartë dhe me një përfaqësim të mirë të brezave, që garanton vijimësinë e cilësisë së programit. Një pjesë e stafit janë specializuar në institucione prestigjioze të huaja.
3. Departamenti i Kimisë Industriale është i pajisur me infrastrukturë laboratorike të përmirësuar dhe në sajë të pjesëmarrjes së departamentit/ fakultetit në projekte kërkimore– shkencore ka arritur ti pajisë labororet me aparatura bashkëkohore të cilat do tu shërbejnë stafit dhe studentëve për përparimin e tyre në fushën e shkencës së Kimisë Industriale.
4. DK/ FSHN ka marrëveshje me institucione publike dhe private për realizimin e internshipeve nga studentët dhe për mundësinë e punësimit të tyre pas përfundimit të studimeve.

**Pika të dobta:**

1. Mungesa e Praktikës Profesionale për studentët e PS Bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore” (**Standardi I.5, kriteri 4**).
2. Programi i studimit nuk plotëson vlerësimet në kredite për tipologjitë E dhe D të lëndëve, në përmbushjen e kërkesave të VKM 41, dt. 24.01.2018 (**Standardi II.3, kriteri 2**).
3. Numri në rënie i studentëve kërkon një promovim më të mirë të programit në mënyrë që të ruhet cilësia e studentëve që regjistrohen në PS Bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore” (**Standardi V.4, kriteri 5**).
4. Konstatohet mospërputhje midis Statutit të UT dhe Rregullores së Programit të studimit bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore” për sa i përket mënyrës së përmbylljes së studimeve vetëm me provim përfundimtar (**Standardi V.2 kriteri 4**).
5. Një studim më i thelluar i tregut të punës dhe gjurmimi i punësimit të studentëve pas mbarimit të studimeve Bachelor, për të mundësuar punësimin e tyre në përshtatshmëri me diplomën (**Standardi VI.3, kriteri 4**).

**Rekomandime:**

1. Duhet të rishikohen vlerësimet në kredite për tipologjitë e lëndëve deri në përmbushjen e kërkesave të VKM 41. dt. 24.01.2018.
2. Përmirësimi i kurrikulave duke marrë parasysh dhe mundësinë e përfshirjes së praktikës profesionale për programin Bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore”.



3. Nxitja e stafit për promovim, duke u dhënë mundësinë e marrjes të titujve nëpërmjet udhëheqjeve të doktoraturave, duke u përfshirë në Projekte Bashkëpunimi Ndërkombëtare.
4. Departamenti i Kimisë Industriale, duhet të rishikojë rregulloren e PS Bachelor “Kimi Industriale dhe mjedisore” në përputhje të plotë me statutin e UT, për tu dhënë mundësinë studentëve të ekselencës që të kenë mundësinë e punimit të temave të diplomës, si një pikënisje e një pune të ardhshme shkencore. Kjo kërkon të shoqërohet dhe me rregullimet e tjera përkatëse.
5. Institucioni duhet të rrisë mobilitetin e studentëve, me qëllim ndërkombëtarizimin e programit të studimit.
6. DKI duhet të promovojë më mirë PS Bachelor “Kimi Industriale dhe Mjedisore” në mënyrë që të ruhet numri dhe cilësia e studentëve që regjistrohen në PS.
7. DKI duhet të mbështesë më shumë studentët pas mbarimit të studimeve Bachelor, për të mundësuar punësimin e tyre në përshtatshmëri me diplomën.



**Conclusions of the Evaluation of the study program of the first cycle Bachelor "Industrial and Environmental Chemistry" of the Institution of Higher Education "University of Tirana".**

**Strengths and Affirmations:**


1. The Bachelor study program "Industrial and Environmental Chemistry", at the national level, is a unique program. He has many years of experience and is structured in accordance with today's labor market.
2. The Department of Industrial Chemistry consists of a highly qualified staff with a good representation of generations, which guarantees the continuation of the quality of the program. Some of the staff have specialized in prestigious foreign institutions.
3. The Department of Industrial Chemistry (DICH) is equipped with improved laboratory infrastructure and thanks to the participation of the department/faculty in research-scientific projects, it has managed to equip the laboratories with modern equipment that will serve the staff and students for their progress in the field of the science of Industrial Chemistry.
4. DICH/Faculty of Natural Sciences (FNS) has agreements with public and private institutions for the realization of internships by students and for the possibility of their employment after completing their studies.

**Weak points:**

1. Lack of Professional Practice for students of Study Program (SP) Bachelor "Industrial and Environmental Chemistry" (Standard I.5, criterion 4).
2. The study program does not meet the evaluations in credits for typologies E and D of subjects, in fulfilling the requirements of CMD 41, dt. 24.01.2018 (Standard II.3, criterion 2).
3. The decreasing number of students requires a better promotion of the program in order to maintain the quality of students enrolled in the SP Bachelor "Industrial and Environmental Chemistry" (Standard V.4, criterion 5).
4. There is a discrepancy between the UT Statute and the Regulations of the "Industrial and Environmental Chemistry" bachelor study program in terms of the way of completing the studies only with a final exam (Standard V.2 criterion 4).
5. A more in-depth study of the labor market and tracking the employment of students after completing their Bachelor studies, to enable their employment in accordance with the degree (Standard VI.3, criterion 4).


**Recommendations:**

1. Credit evaluations for subject typologies must be reviewed until the requirements of CMD 41. dt. 24.01.2018.
2. Improving the curricula taking into account the possibility of including the Professional Practice for SP Bachelor "Industrial and Environmental Chemistry".





3. Encouraging the staff for promotion, giving them the opportunity to obtain titles through the management of doctorates, being involved in International Cooperation Projects.
4. The Department of Industrial Chemistry should review the regulation of the Bachelor's Degree "Industrial and Environmental Chemistry" in full accordance with the UT statute, to give the opportunity to excellence students to have the opportunity to work on the subjects of the degree, as a starting point of a future scientific work. This needs to be accompanied by other relevant regulations.
5. The institution should increase the mobility of students, in order to internationalize the study program.
6. The Department of Industrial Chemistry should better promote the SP Bachelor "Industrial and Environmental Chemistry" in order to maintain the number and quality of students who enroll on it.
7. The Department of Industrial Chemistry should support more students after completing their Bachelor's studies, to enable their employment in accordance with the degree.





**Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Përbushen plotësisht	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X